Bashkia Shkodër
Biblioteka “Marin Barleti”

Gegnia

e përkohshme kulturore-artistike

2 - 2016
Vjeti I i botimit,
Shkodër

Gegnia
E përkohshme kulturore-artistike

2 -2016
Vjeti I i botimit,
Shkodër

Redaksia: Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Lisandri Kola
Botohet nën kujdesin e bashkisë Shkodër dhe bibliotekës "Marin Barleti"

Adresa e redaksisë: Biblioteka "Marin Barleti", Shkodër
E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al
info@bibliotekashkoder.com

Shënim:
Pikëpamjet e artikullshkruesave nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.

- ***editorial***

- ***albanoloigji***
  Kastriot MARKU *Injac Zamputti - themeluesi i diplomatikës dhe i shkollës historiografike shqiptare* 5

- ***kritikë & studime letrare***
  Gëzim PUKA *"Valë mbi valë" e Atë A. Harapit – kur arti i fjalës është më i vërtetë se ngjarjet referenciale* 8
  Hans-Joachim LANKSCH *Gjuha dhe poetika e Martin Camajt* x
  Aristea KOLA *Korpusi i soneteve të Arshi Pipës* x
  Çezarin TOMA *Giuseppe Schirò e Luigi Pirandello: un'amicizia fraterna* *x*
  Xhahid BUSHATI *Refleksione rreth krijimtarisë së shkrimtarit Teufik Gjyli në gjininë e përrallës* *x*

- ***dossier / Gasper Pali***
  Lisandri KOLA *Gasper Pali, antipodi i vëllazënve* *x*
  Vjollca OSJA *"Prendimi i andrrimeve", Gasper Pali* *x*
  Italia KOKA (MENCACCI)*: Ju rrëfej Gasper Palin* *x*
  Gasper PALI *Poezi* 14

- ***letërsi / poetë bashkëkohorë***
  Martin CAMAJ **x**
  Zef ZORBA **x**
  Frederik RRESHPJA **x**
  Primo SHLLAKU **x**
  Ridvan DIBRA **x**
  Gazmend KRASNIQI **x**
  Luljeta LLESHANAKU **x**
  Arben PRENDI **x**
  Entela TABAKU SÖRMAN **x**
  Ledia DUSHI x

- ***histori***
  Gjovalin ÇUNI *Kontribut për datën e saktë të themelimit të bibliotekës kombëtare...* x

Nush GURAKUQI *Mbi krijimin e Bibliotekës Shtetnore* *x*
Helidon SOKOLI *Mozaiku i shek. III-IV, zbuluar* **n**ë *Shkod*ër *dhe ekspozimi i tij* x

▪ ***letërkëmbim***
Nexhmi Bushati *Prej letërkëmbimit të Hamdi Bushatit me Kristo Frashërin* *x*
Nikoll Gazulli *Prej letërkëmbimit të dom Nikoll Gazulli me prof. Norbert Joklin* x

▪ ***ese & memoaristikë***
Arshi PIPA *Si vdiq Vinçenc Prendushi* **x**
Giorgio AGAMBEN *Mbi vështirësitë e leximit* x
Entela TABAKU SÖRMAN *Përsiatjet e një poeteje mbi konstruktin e munguar në shqipen standard* *x*

▪ ***recension***
Arben PRENDI *"Premtimi i përmbushun" me autor Gjon Sinishtën, pasqyrë e kalvarit të popullit shqiptar nën diktaturën komuniste* *x*

▪ ***promemorie***
Ortografija e gjuhës shqipe *x*

Ta mbajmë të gjallë kujtesën tonë kulturore

Të gjithë e kena për detyrë me e lartësue Shkodrën tonë përpara vetes së saj, përpara së kaluemes dhe pse jo edhe përpara botës. Nëse jetojmë në një realitet të vështirë shpesh herë edhe paradoksal shkaktue prej rrethanave të ndryshme, e vetmja mënyrë me e ngritë Shkodrën ashtë të mendojmë dhe t'i shërbejmë fisnikisht asaj. E ardhmja e saj ashtë në duert e njerëzve vullnetmirë që dëshirojnë të bajnë diçka me jetën e tyne. Nuk mjafton me qenë i lindun në Shkodër me u quejtë shkodranë, nuk mjafton tash me "rrahë gjoksin" me atë çka asht ba në të kaluemen, pa i dhanë asgja as të kaluemes as të tashmes.

Na ka pëlqye shpesh me thanë se Shkodra ka qenë dhe ashtë "djepi i kulturës". E gjitha kjo i detyrohet energjisë me të cilat breznitë që kaluen dhe fatkeqsisht po kalojnë, i dhanë asaj, por, në ditët tona gjithnjë e ma tepër po rrezikohen të humbasin apo të bastardohen vlerat e bazueme në "qytetnimin e punës", vlera të krijueme në shekuj nga shkencëtarë, shkrimtarë, artistë, kangëtarë, kompozitorë, gazetarë e sa e sa të tjerë. Humbja e këtyne vlerave do të bante që Shkodra të mbetej një trup pa shpirt, pa kokë.

Në një qytet me traditë kulturore dhe histori të lashtë ekziston mundësia e hulumtimit dhe rifunksionalizimit të saj, shenjë qytetnimi e integrimi në jetën bashkëkohore. Ashtë gja e bukur dhe e vlefshme të nxirren vlerat e vërteta në dritë, të nxirren të fshehtat e sa e sa breznive të kalueme si dhe të atyne që kanë mbetë prej breznive. Çdo punim sado i parëndësishëm në vetvete, në dobi të kujtesës kulturore, meriton të merrret në konsideratë dhe t'i nënshtrohet një studimi të kujdesshëm.

Në ditët e sotme, në një botë komplekse, ku edhe kultura asht e infektueme prej etheve të fitimit, janë shtue shumë botimet e gjinive të ndryshme, të firmave të reja që po përpiqen të shtojnë pasuritë kulturore të qytetit, por në të njajtën kohë vërehet edhe fenomeni i harresës jo vetëm i autorëve të traditës, por edhe i autorëve që në heshtje punuen dhe punojnë, mbasi të shuem apo të shtymë në moshë, përgjithësisht e kanë krye veprën e tyre "diturake", pa pasë mundësi që punimet e tyre të njihen mirë. Punimet e tyne, së bashku me ato të autorëve të traditës, formojnë kujtesën kulturore e cila nuk ka me funksionue normalisht pa këtë njohje.

Ku ndodhet dhe çka duhet me ba me ringjallë kujtesën kulturore të kombit?

Fushat e veprimit janë të shumta, por po veçojmë disa syresh:

Ribotimi i librave të traditës që dikur janë botue në kopje të pakta, por sot mungojnë në qarkullim, libra që gjenden në bibliotekat e qytetit tonë, të qyteteve të tjera, pse jo dhe jashtë shtetit. Padyshim ribotimi i këtyre librave duhet t'i nënshtrohet një pune të specializueme. Theksojmë se duhen ba edhe botime ekonomike në atë mënyrë që secili të mundet me i ba ato pjesë të bibliotekës personale. Shtëpitë botuese duhet me pasë parasysh edhe një publik që nuk asht në gjendje me ble botime luksoze, e për ironi ky asht publiku masiv por edhe ai i specializuem.

Botimi në formën e veprave të plota apo dhe përshtatja në antologji e veprave të autorve të traditës të shpërndame në fletoret e ndryshme të kohës, për të cilat deri më tash nuk ka fare ose ka shumë pak përkujdesje. I një randësie të veçantë ashtë edhe "gjurmimi" i të ashtuquejtunve "shkrimtarë pa vepra", që, ndonëse pa libra të mirëfilltë, kanë dhanë një kontribut mjaft të çmueshëm në kulturën tonë qytetare dhe kombëtare. Nuk duhet lanë mbas dore asgja, as botimet e letërkëmbimeve, ditareve, shënimeve personale e të tjera, që gjithnjë paraqesin interes për lexuesit sepse ndërtojnë kujtesën kulturore të kombit.

Punë me vlerë ashtë edhe botimi i veprave që ende flenë nëpër sirtare. Gjatë viteve të diktaturës mendjet e kthjellta, të talentueme dhe të apasionueme të qytetit kanë prodhue "gjamat e dëshpërimit", që ende mbesin të tilla për sa kohë që këta autorë nuk i kanë mundësitë financiare me jetue e jo ma me shpenzue për botimin e veprave të tyne. E keqja ashtë se shumë prej këtyne autorve po shuhen ngadalë në qetësinë dhe thjeshtësinë e intelektualëve pa e mbërritë ditën e botimit të veprës për të cilën kanë shkri tanë jetën, pa kërkue asnji shpërblim. Kur vepra e tyne asht cilësore ajo përban vlerë kombëtare e duhet të merret në mbrojtje, qoftë edhe tue e botue. Faqet e revistës "Gegnia" janë të hapuna për botime të pjesshme të këtyne veprave.

Lind pyetja sa punime janë?

Flitet se janë shumë, por askush nuk e di saktësisht, e kjo edhe për shkak të mungesës së inventarizimit të trashigimisë kulturore, proces i vështirë me u realizue mbasi një pjesë e kësaj pasurie ndodhet e shpërndame nëpër trashëgimtarët e familjeve shkodrane, apo nëpër qoshe të arkivave të shtetit krejt jashtë vëmendjes, të harrueme.

Pjesa që trajtuem ka të bajnë me kulturën shpirtnore, por tepër e randsishme ashtë edhe trashëgimia e kulturës materiale. Si gjithmonë, nuk mjaftojnë as nuk mungojnë idetë, ato duhen materializue dhe për

këtë duhen fonde, të cilat në kohë mund të jenë të rikthyeshme, tue pasë parasysh etjen dhe kureshtjen e publikut për vlerat e sipërmenduna.

U mbetet detyrë jo vetëm institucioneve shtetnore, por edhe atyne private, veçanërisht, shtëpive botuese, shoqatave e fondacioneve, bizneseve që veprojnë në qytet, por edhe jashtë, të ndihmojnë në publikimin e punëve me vlerë që ende nuk e kanë pa dritën e botimit. Të mos harrojmë se "mecenët" (mbrojtësit dhe përkrahësit e kulturës) kanë lindë dhe kanë punue për lavdinë e qyteteve të tyne, qysh në kohën e Romës së Vjetër.

Të mos harrojmë, sa qytetnime do të ishin zhdukë në qoftë se nuk do të kishin lanë mbas dëshmitë e shkrueme të kujtesës së tyne kulturore e kjo mund të ndodhin edhe tek ne.

Redaksia

Kastriot MARKU

INJAC ZAMPUTTI - THEMUESI I DIPLOMATIKËS DHE I SHKOLLËS HISTORIOGRAFIKE SHQIPTARE

Historiani dhe studiuesi i shquar Injac Zamputti,[1] lindi në Shkodër më 12 shkurt të vitit 1910. Gjyshi i Injaci Zamputtit quhej Giuseppe Zamputti. Ai ishte mjek në profesion dhe iku nga Italia në vitin 1870 (mbas humbjes së shtetit të Papës në Porta Pia). Fillimisht u vendos si mjek bashkie në Kavajë, ku edhe u martua me Luigjian, nga familja e njohur raguziane Raçiç. Më pas u transferua në Durrës dhe vitet e fundit u vendos në Shkodër, ku edhe vdiq në vitin 1900. I ati i Injacit Romolo, ka lindur në Durrës në vitin 1876. Punoi si nëpunës poste pranë Konsullatës Italiane në Shkodër. Më pas u martua me Nine Temalin, e vejë me një vajzë, familja e së cilës kishte zbritur nga malet (nga Temali i Malësisë së Dukagjinit). Nga martesa e tyre patën tre fëmijë: dy vajza dhe një djalë (Injaci), i cili ishte i fundit në radhë. Romolo vdiq në mënyrë aksidentale në vitin 1911 duke e lënë Injacin jetim në moshën 1 vjeçare, së bashku me tre motrat. E ëma, Nine, i rriti fëmijët me shumë mundime. Injaci fillimisht studioi në *Kolegjën Saveriane* të Etërve Jezuitë në Shkodër, ku edhe dallua për rezultate shumë të mira në mësime dhe mbi të gjitha për një sjellje shumë korrekte. Etërit jezuitë të mbërritur në Shkodër në prillin e vitit 1841 kishin krijuar një qendër të rëndësishme, arsimore, kulturore, artistike dhe shkencore duke filluar me ngritjen në

Injac Zamputi

1 Mbiemri i saktë i Injac Zamputtit-t në të gjithë regjistrat e gjendjes civile shkruhet me dy *t*: Zamputti, por që nga Injaci dhe familjarët e tij u përdor me një –t, gjatë viteve të diktaturës, për arsye të kuptueshme si një mënyrë "për të hequr dorë" nga origjina e tij italiane, e cila nga regjimi i asaj kohe shihej me dyshim.

vitin 1859 të *Seminarit Papnuer Shqiptar.* Më 1871 ata themeluan në Shkodër shtypshkronjën: *Typographia Immaculatae Conceptionis B.M.V*, e njohur si Shtypshkronja "Zoja e Paperlyeme", enti botues i parë në Shqipërinë e asaj kohe nën sundimin osman, e cila për periudhën 1870 – 1945 ka të regjistruara një numër rekord botimesh prej 725 titujsh. Në tetor të vitit 1878 jezuitët hapen *Kolegjën Saveriane* dhe në mars të vitit 1891, filluan botimin e revistës *Elçija e Zemers t' Jezu Krishtit* (1891-1913), revista e parë kjo në gjuhën shqipe brenda territorit shqiptar, e cila më vonë merr emrin *Lajmëtari i Zemers T' Jezu Krishtit* (1914-1944), e që u pasua në vitin 1914 me shtojcën historiko-shkencore *Përparimi* (1914-1916). Më 9 dhjetor 1928, me nismën e një grupi të ish-nxënësve të këtij Kolegji të drejtuar nga Etërit Jezuitë dhe posaçërisht nga At Zef Valentini, u themelua Shoqata e intelektualëve shkodranë L.E.K.A. (Lidhje – Edukatë – Kulturë – Argtim), e cila do të kishte si moto programore *Concordia parve res crescunt/Sendet e vogla rriten prej bashkimit* dhe që do të shërbente për të lidhur më ngushtë mjedisin katolik shkodran me Kolegjën Saveriane dhe me veprimtarinë e saj pedagogjike, artistike e kulturore. Në muajin prill të vitit pasardhës doli revista kulturore *Leka* (1929-1944), kjo e fundit si nismë pas festimeve me rastin e 50-vjetorit të hapjes së *Kolegjës Saveriane*, organi i shoqatës së sipërpërmendur, e cila ishte vijim natyral i *Elçisë*, më pas *Lajmëtarit*, dhe veçanërisht vijim i shtojcës *Përparimi* që doli në periudhën 1914-1916, e që u pasua nga *Kalendarit i vjetës* (1912-1927). Në vitin 1937, me nismën e një grupi studiuesish nën kryesinë e Dom Ndre Mjedës u themelua *Akademia Albanologjike Saverjane* (Academia Albanologicae Xaveriana).[2] Në mjediset të tilla arsimore, kulturore e shkencore të jezuitëve, u rrit dhe u edukua Injac Zamputti. Fillimisht mori pjesë në mjaft shfaqje teatrale si nxënës, më pas si mësues dhe si drejtues i tyre. Në shfaqjet muzikore dhe teatrale, traditë kjo e shkollave të asaj kohe në qytetin e Shkodrës, ai ishte mjaft aktiv duke marrë pjesë në pjesën më të madhe të aktiviteteve kulturore, artistike e sportive, bile do shënuar se si amator mori pjesë edhe si violinist pjestar i orkestrës. Qe veprimtar i rregullt i Shoqërisë kulturore *Bogdani*, në të cilën ai kishte marrë pjesë në mjaft prej shfaqjeve të saj, sikurse ishin melodramat e Dom Ndre Zadejës. Profesorët e atyshëm të Kolegjës, bazuar në paraqitjen e nxënësit të tyre vendosën që në vitin 1931, ta mbajnë aty si mësues të gjuhës dhe letërsisë shqipe. Në moshën 21 vjeçare Zamputti do të ishte

2 *Statuti i Akademis Albanologjike Saverjane /Academiae Albanologicae Xaverianae Statuta*. Shkodër, Shtypshkroja "Zoja e Paperlyeme", 1937. 4 f.

kështu koleg me Dom Ndre Mjedjen dhe Atë Zef (Giuseppe) Valentinin S. J, një privilegj që pak kush mund ta kishte në atë kohë. I gjendur ndërmjet këtyre dy personaliteteve më në zë të Akademisë Albanologjike Saveriane, pa lënë mënjanë as At Fulvio Cordignano-n S.J., Zamputti përfitoi jashtëzakonisht shumë prej tyre, gjë e cila u reflektua në formimin e tij solid, i cili prodhoi më pas një punë të cilësuar shkencore gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit të XX në sudimet albanologjike. Injac Zamputti shkrimet e para i botoi në revistën *Leka*, por edhe në disa organe të tjera të shtypit të kohës si *Cirka, Kumbona e së diellës, Lajmëtari i Zemers T' Jezu Krishtit, Shkëndija*, kryesisht artikuj kulturorë, letrarë e gjuhësorë, reçensione e kritikë letrare për autorë të tillë si Fulvio Cordignano, Gjergj Fishta, Zef Skiroi, Arshi Pipa, Zef Harapi etj., por edhe poezi, novela, e përkthime etj., duke përdorur, përveç emrit të tij edhe dymbëdhjetë pseudonime të ndryshme të tillë si: *Ales, Notarios, Pol-iglota, Rosea, Sila, Sirena, Stal, Z= i Zeta (j), R.N.* Modës së asaj kohe të botimit me pseudonim iu shmangën kryesisht kritikat letrare. Në vitin 1937 martohet me Rozën, një vajzë nga familja shkodrane Prela, e cila ishte ngushëllimi më i bukur i mundshëm i jetës familjare, me të cilën pati 6 fëmijë; 5 vajza dhe një djalë. **Për dashurinë e thellë që ai kultivoi ndaj familjes, dashuri të cilën ai konsideronte si gjënë më të shtrenjtë, nuk kurseu as atëherë kur vështirësitë jo të pakta që pati në jetë iu bënë "ferrë". Sikurse do e shohim më pas ai mundi të dalë prej andej pa i cënuar virtytet e tij morale, të cilat shumëkush në kohën e tij me apo pa dëshirë i la mënjanë**. Studimet e larta i kreu në universitetin e Triestes në Itali ku edhe doktorohet në Shkencat Politike me tezën e laurës me temën: "700-a Veneciane dhe Shqipëria Turke", e cila do të bëhej në mënyrë të tërthortë mbështetje e punës që do të kryente gjatë gjithë jetës në rrethana krejt të tjera, nën një regjim politik ku shkencat politike ishin gjëja e fundit që hynin në punë, në mos prishnin punë. Në vitin 1937 botoi në revistën *Leka* melodramën *Damiani Himarjot*, e cila u botua më vete më 1944.[3] Në vitin 1940 botoi tek Shtypshkroja "Zoja e Papërlyeme" librin e parë me novela *Zemra Njerëzish*[4] dhe më 1944 librin e dytë me tregime e novela *Atje nën hijen e Rozafës*, botuar nga Ismail Mal Osmani.[5] Në gjashtë vitet e fundit

3 ZAMPUTI, Injac. *Damiani himariot*. Dramë lyrike, Paperlyemja, Shkodër, 1944, 79 f.

4 ZAMPUTI, Injac. *Zemra njerëzish*. Novela. Shtypshkroja « Zoja e Papërlyeme », Shkodër, 1940. 119 f.

5 *Atjèe, nën hijen e Rozafës*. Ismail Mal'Osmani, Tiranë 1944, 110 f.

të punës pranë Kolegjit Saverian, falë fatit që pati të kishte koleg At Giuseppe Valentinin, pranë të cilit ishte asistent dhe njëkohësisht sekretar i *Akademisë Saveriane*, ai njohu dhe përvetësoi bazat metodologjike rigoroze prej "jezuiti", të punës albanologjike, kryesisht praktikës arkivore dokumentare, e cila do t'i shërbente më pas si pikënisja e duhur për studimet e mëvonshme rreth historisë së popullit shqiptar. Në vitin 1945, menjëherë pas luftës së dytë botërore, punon si drejtues i Shtëpisë së Kulturës në Shkodër, ndërsa në vitet 1946-1948 e transferojnë me punë në Gjirokastër, larg familjes, ku jep lëndën e letërsisë në Liceun e atij qyteti. Në vitet '50 e fillimin e viteve '60, shkruan letërsi: tri drama, një melodramë, dy tregime të gjata, një poemë për luftën e Himarës të vitit 1481, por nuk e lejojnë të botojë, ndaj edhe detyrohet të heqë dorë nga letërsia e t'i kushtohet vetëm historisë e paleografisë. Filloi punë në sektorin e historisë së mesjetës pranë *Institutit të Shkencave* (më pas *Instituti i Historisë*). Në vitin 1953, pas shumë ecejakesh, arriti të transferojë në Tiranë edhe familjen. Në *Institutin e Historisë* Zamputti punoi për rreth 40 vjet me radhë duke transkriptuar, përkthyer dhe komentuar mijëra dokumente të rëndësishme për historinë e Shqipërisë falë njohjes shumë të mirë të latinishtes dhe italishtes së mesjetare, paleografisë dhe arkivistikës, çfarë do të thotë se përkthimi i dha atij mundësinë të bëjë edhe mjaft studime në fushën e historisë, gjuhësisë dhe arkeologjisë etj. Botimi i dokumenteve për historinë e Shqipërisë nuk ishte një punë e lehtë, sepse pjesa më e madhe e këtyre dokumenteve nuk gjendeshin në Shqipëri, për arsye se një pjesë e pakët e tyre gjendeshin në arkivat historike vendase[6] të cilat ishin shkatërruar përgjatë pushtimeve të shumta, kryesisht atij osman e më pas me hyrjen e regjimit komunist, ndaj në këto kushte, mbetej që ato të siguroheshin përmes një udhe tjetër; nga arkivat e vendeve të huaja, italiane, spanjolle, dalmatine si Venecia, Vatikan, Padovë, Milano, Barcelonë, Raguzë, Dubrovnik etj. Për gjendjen e materialeve dokumentare në Arkivin e Propagandës Fide lidhur me Shqipërinë, Zamputti i kishte nxjerrë njoftimet nga studiues dhe albanologë të ndryshëm si : Daniele Farlati, Mario Roques, Fulvio Cordignano, Cirillo Carolevskij, Nilo Borgia, Jovan Radonič etj. Gjatë viteve 50-të, (nuk kemi mundur t'a verifikojmë se në ç'mënyrë), por është fakt se u sollën një sasi e

6 ZAMPUTI, Injac. "Gjendja e materialeve dokumentare dhe burime të reja vendase p*ër* Historinë e Shqipnis*ë*." *Buletin i Shkencave Shoq*ërore. Tiranë, 1955, nr. 3, f. 122-130.

konsiderueshme dokumentesh të mikrofilmuara nga *Arkivi i Propagandës Fide*, të cilat profesori nisi t'i transkriptonte, përkthente dhe komentonte e botonte fillimisht në *Buletinin e Universitetit Shtetëror të Tiranës* (Seria e Shkencave Shoqërore), sikurse bëri me relacionin e Frang Bardhit mbi Zadrimën (1956),[7] dhe relacionin e të njëjtit relator mbi Pukën (1958),[8] relacionin e Pjetër Budit dërguar kardinalit Gozzadino (1958),[9] **për t'i botuar ata më pas në serinë dyvëllimshe me titull :** *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII.* Vëll. I. (1610-1634). Tiranë 1963. Vëll. II. (1634-1650). Tiranë 1965. Duke pasur parasysh faktin se për Zamputtin mundësia e lëvizjes për të prekur me dorë dokumentacionin burimor nga arkivat e huaja ishte e pamundur, si një mentar largpamës dhe largvajtës njëkohësisht, ai nisi ashtu vetmitar projektin vetjak afatgjatë për përgatitjen e studiuesve të rinj në këtë disiplinë, në mënyrë që ata kurdo që të krijohej mundësia, të ishin në gjendje për të bërë kërkime në arkivat e huaja, në mënyrë që të vilnin e të sillnin prej andej dokumentet e duhura. Puna e tij paraprake përgatitore qe në të vërtetë një shkollë joinstitucionale, e cila për fat të mirë nuk është se shkoi dëm e gjitha sepse Injac Zamputti sikurse e thamë, nuk duhej dhe nuk u lejua asnjëherë të dilte jashtë Shqipërisë, as për të realizuar kërkimin e dokumenteve dhe as për të marrë pjesë në simpoziume apo konferenca shkencore ndërkombëtare, ku ai ftohej nga historianët dhe shkencëtarët e huaj në cilësinë e autoritetit kompetent të padiskutueshëm. Origjina e tij italiane, shkollimi dhe formimi i tij në Kolegjin Saverian të Etërve Jezuitë, kontaktet që kishte pasur para hyrjes së regjimit komunist me At Giuseppe Valentinin, Fulvio Cordignano-n dhe kolegët e tyre të cilë cilësoheshin si fashistë dhe kriminelë, ishin tre elementë të mjaftueshëm që Zamputti të konsiderohej nga regjimi diktatorial si një element i dyshimtë me hijëzim reaksionar që do të thoshte se paraqiste një potencial të mundshëm për rrezikshmëri shoqërore e për rrjedhojë ai duhej të mbahej i izoluar dhë nën mbikëqyrje konstante. Kësaj i shtohej edhe refuzimi i tij këmbëngulës që i

7 ZAMPUTI, Injac. "Të dhana të reja mbi gjendjen ekonomike dhe shoqnore të shekullit XVII. Relacioni i Frang Bardhit mbi Zadrim*ën dhe* regjesti i 72 dokumentave të rij". *Buletin i Shkencave Shoq*ërore, Tiranë, 1956, nr. 2, f. 157-198.

8 ZAMPUTI, Injac. "Mbi disa materiale të reja dokumentare të shek. XVII. Relacioni i Frang Bardhit mbi Pukën". *Buletin i Shkencave Shoq*ërore, Tiranë. 1958, nr. 3, f. 170-215.

9 ZAMPUTI, Injac. "Relacioni i Pjetër Budit drejtue kardinalit Gozzadino me 1621". *Buletin i Shkencave Shoq*ërore. Tiranë, 1958, nr. 2, f. 79-92.

kishte bërë presionit të policisë sekrete (Sigurimit) për të bashkëpunuar me të.[10] Në vitet 1967-1968, kur revolucioni kulturor kinez iu vërsul besimeve fetare, Zamputti u godit tërthorazi dhe drejtpërdrejt,[11] madje nuk iu lejua të botonte studimet e tij në pjesën më të madhe të shtypit periodik, pengesë nga e cila do të çlirohej vetëm mbas njëzetë vjetësh, por gjithsesi u mbajt në Institut vetëm sepse ai (Instituti) kishte nevojë për të ; sepse dokumentacioni mesjetar nuk lexohej si duhej prej askujt tjetër. Injac Zamputti duke mos qenë një njeri i regjimit, në këtë vështrim nuk gëzonte ndonjë mbështetje të veçantë pothuajse prej askujt, por pavarësisht nga kjo ai vlerësohej konfidencialisht nga pjesa më e madhe e kolegëve të tij për

10 Lidhur me këtë aspekt ja se ç'shkruan ai në kujtimet e tij: "*Viti 1949 ka qenë për mue ma i randi i jetës sime. Edhe vitet që do të vijnë nuk do të jenë ma të lehta për mue e për familjen time... Në tetorin e atij viti të zi (por a pati pastaj ndonjë vit të bardhë për mue?) një djalë hyni në jetën time për me e bamë edhe ma të zezë. Kur po shkoja rrugës në atë mbramje të errët, m'u afrue nga pas një hije si të ishte hija e trupit tim në rreze të hanës. Në një qoshe të rrugës, pranë ish pallatit te Zogut, hija lëshoi za. Ndalova dhe u gjeta ballë për ballë me atë djalë. Më ftoi që të shkoja me të në një drejtim tjetër. Në krye të rrugës së Barrikadave takuem në një burrë të pjekun që po na priste. Gjithë mirësi më vunë në mes dhe ecëm nëpër atë rrugë në të cilën nuk bante dritë asnjë llampë dhe hymë në rrugën Qemal Stafa e cila ishte gjithashtu në errësinë të plotë dhe vetëm dritat e dyqaneve ndriçonin ndopak. Nisën të thuheshin disa fjalë të pakuptimta për mue. Shumë vonë erdha në vete dhe kuptova humnerën ku donin me më plandosun. Sikurse lexuesi e ka kuptue, unë tashma isha mësue të ulja kokën. Por në atë mbramje të zezë puna kishte shkue në fije të penit. Harrova nanë, grue, motër e fëmijë dhe ndalova hapin i vendosun për mos me ecë një metër ma tej me ato dy hije që më ftonin të hyja në një apartament aty përballë. Kambëngulja ime mos me u bindë i tronditi shoqnuesit e mij që më dhanë me kuptue se, në raste të tjera, kishin dalë përherë fitues. Kur e panë se isha i vendosun edhe të vdisja por jo të bindesha, më detyruen të lëshoja një deklaratë se nuk e pranoja propozimin që m'u ba. Nuk pata asnji ngurrim. Në dritën e vitrinës së një dyqani shkrova fjalët që m'u diktuen, sigurisht me shprehjen negative për propozimin që m'u ba. Kjo deklaratë ndoshta do të gjendet në dosjen time të M.P.M. dhe, nëse do të dalë në dritë, do të shihet se nuk më asht dridhun dora kur e shkrova. Hijet e asaj mbramje të zezë më kanë ndjekun gjithë jetën. Edhe sot në pleqninë time kur po thuhet se erdhën kohë të reja (1992), kujtimi i asaj mbramje më ban me u dridhë dhe më pengon që të them çdo gja me hollësi, sepse qeshë porositun me kërcënim që ta mbaja për vete atë propozim dhe, nëse jam gjallë ende, asht sepse fjalën e mbajta deri sot...*".

11 ZAMPUTI, Injac. *Letër në redaksi. Rreth disa formulimeve të gabueme në artikullin "Elemente të vetëdijes shqiptare për liri, për gjuhën shqipe dhe për arësim në shek. XVI-XVII. "Studime historike"*, 1965, nr. 3, f. 37-59, *Studime. Historike*, 1967, Nr. 2, fq. 195-199.

profesionalizmin, kompetencën, integritetin, përgjegjshmërinë dhe ndershmërinë e pashoqe. Ai bëri emër në atë kohë të vështirë, pikërisht falë këtyre cilësive, duke u angazhuar kështu tërësisht me të gjitha aftësitë e tij intelektuale në shërbim të shkencave albanologjike. Detyra që i kishte vënë vetes për botimin e burimeve dokumentare lidhur me mesjetën shqiptare shihej prej tij si domosdoshmëri për fillimin e mbarë e të qëndrueshëm të studimeve shqiptare për këtë periudhë historike.

Në vitin 1993 u riatdhesua në Itali, ku sërish vijoi punën e tij mbi dokumentet shqiptare të historisë mesjetare, duke lënë dorëshkrim dy vëllime të tjera me dokumente të transkriptuara e të përkthyera si dhe një autobiografi në trajtën e një ditari kronologjik me mjaft interes. Injac Zamputti vdiq në Tivoli, (Itali) më 28 shkurt 1998, për tu riatdhesuar sërish në Shqipëri, ku edhe u varros më pas në varrezat e Sharrës në Tiranë **më 5 mars 1998,** sipas amanetit të lënë prej tij. Megjithëse një punonjës shkencor i dalluar për kontributet e tij për historinë e Shqipërisë, atij nuk i dha asnjë titull shkencor. Asnjëherë nuk ia njohën titullin doktor i shkencave dhe diplomën e marrë në Trieste, megjithëse të gjithë e thërrisnin "Profesor," madje ai u pagua gjithnjë si punonjës me arsim të mesëm dhe asnjëherë nuk i dhanë jo vetëm një titull shkencor, por as edhe një vlerësim dinjitoz për punën e kryer. Në vitin 1995, u dekorua me titullin: "Punonjës i shquar i Shkencës dhe i teknikës " nga Presidenti i Republikës Sali Berisha, me motivacionin: "Për kontribut shumë të shquar në zhvillimin e shkencave albanologjike".

Punës së madhe përgjatë dyzetë vjetëve për traksriptimin dhe përkthimin e dokumenteve burimore origjinale nga latinishtja dhe italishtja mesjetare, i shtoi edhe kontributin e tij me studime historike përkatëse për këtë epokë, periudhe e cila ishte ende në atë kohë një nga më të errëta në historinë e Shqipërisë. "*Shkenca duhet të jetë rigoroze në të gjitha anët, por sidomos në bazat mbi të cilat ajo vepron*."- do të shprehej ai.[12] Injaz Zamputti me punën e tij skrupuloze mbështetur mbi dokumentacionin e shqyrtuar, botoi një varg studimesh në formë artikujsh që u botuan në *Buletinin e Shkencave Shoqërore*, në revistat *Studime Historike*, *Studime Filologjike, Iliria, Studia Albanica,* etj., të cilët sollën një pamje dhe këndvështrim të ri të kësaj periudhe të patrajtuar majftueshëm deri atëherë në studime. Ndër punimet e tij të para ishte transkriptimi i alfabetit të dorëshkrimit të njohur si "Anonimi i Elbasanit", të cilin e shoqëroi me komentin përkatës, duke

12 ZAMPUTI, Injac. "Dy mbishkrimet e fillimit të shek. XIII dhe lidhjet e tyre me principatën e Arbërit*". Hylli i Dritës*, Tiranë, 1995, Nr. 5-6, f.17.

përsaktësuar e datuar kohën e shkrimit të tij në shek. XVII, si dhe duke argumentuar me këtë rast edhe lëvizjen e ritit ortodoks të shoqëruar me një liturgji përkatëse në gjuhën shqipe.[13] Po kështu transkriptoi alfabetin e panjohur të shek. XIX, të një poezie me përmbajtje bektashiane.[14] Më pas botoi shkrimet lidhur me luftën e popullit shqiptar kundër pushtuesit turk në vitet 1479-1492;[15] projektet shqiptare për çlirimin e vendit në vitet 1577-1621;[16] bashkimin e Maleve shqiptare dhe ekspeditën e Vuço Pashës në Kelmend;[17] gjendjen në krahinën e Dukagjinit dhe Pultit në gjysmën e parë të shekullit XVII,[18] si dhe rëndësinë ndërkombëtare të Kuvendeve shqiptare në shekujt XVI-XVII,[19] të cilat në vitin 1961 përmblidhen shkurtazi në monografinë *Përpjekjet Shqiptare për liri i pavarësi në shek. XVI-XVII*,[20] fryt ky i punës së dalë nga shqyrtimi i imët i dokumentacionit arkivor të asaj periudhe, por për fat të keq këtu nuk i janë bashkangjitur referimet e duhura të artikujve të mëparshëm të autorit që i përmendëm më sipër. Një interes i veçantë i tij ka qenë jeta dhe veprimtaria e personaliteteve me rëndësi të botës shqiptare apo autorëve të hershëm të letërsisë shqipe

---

13 ZAMPUTI, Injac. "Dor*ësh*krimi i Anonimit t'Elbasanit – transliterim, transkriptim dhe koment". *Buletin i Shkencave Shoq*ërore, Tiranë. 1951, nr. 3-4, f. 64-131

14 ZAMPUTI, Injac. "Një dor*ësh*krim bektashjan i gjysm*ës* së dytë të shek. XIX ». *Buletin i Shkencave Shoq*ërore, Tiranë. 1955, nr. 4, f. 203-210.

15 ZAMPUTI, Injac. « Luftat e popullit shqiptar kund*ër* pushtimit turk në vjetët 1479-1492 ». *Buletin i Shkencave Shoq*ërore, Tiranë. 1956, nr. 1, f. 76-95.

16 ZAMPUTI, Injac. «Projektet shqiptare p*ër ç*lirimin e vendit drejtue Evrop*ës* në vjetët 1577-1621 ». *Buletin i Shkencave Shoq*ërore, Tiranë. 1956, nr. 4, f. 116-132.

17 ZAMPUTI, Injac. « Bashkimi i Maleve shqiptare në fillim të shekullit XVII-të – Ekspedita e Vuço Pashës mbi Kelmend m*ë* 1638. *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiran*ës, seria për Shkencat Shoqërore, 1957, nr. 1, f. 63-95.

18 ZAMPUTI, Injac. *Dukagjini dhe Pulti në gjysmën e parë të shekullit XVII – Të dhana mbi diferencimin shoqnor. Buletin i Shkencave Shoq*ërore. Tiranë, 1959, nr. 1, f. 3-20.

19 ZAMPUTI, Injac. « Rand*ësia* ndërkombëtare e Kuvendeve shqiptare n*ë* kalim prej shekullit XVI në t*ë XV*II-tin », *Bulletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, 1962, nr. 4, fq. 140-152. Ribotuar në : *Konferenc*ën *e Parë të Studimeve Albanologjike*, Tiranë 1965, f. 498-505, botuar në përkthimin italisht në: *Rassegna di Studi Albanesi*, nr. 1. Tiranë, 1963, f. 101-109.

20 ZAMPUTI, Injac. *Përpjekjet e shqiptarëve për liri në dy shekujt e parë të sundimit otoman*. «Naim Frashëri», Tiranë, 1961. 123 f.

sikurse Gjon Buzuku,[21] Pjetër Budi[22] e Frang Bardhi,[23] Pjetër Mazrreku[24] apo Pjetër Bogdani.[25] Në vitin 1984 botoi tek revista *Iliria* studimin lidhur mbi rindërtimin Mbishkrimit të Arbërit, si një mundësi për leximin e tij për herë të parë në mënyrë të plotë.[26] Një lloj ngushëllimi për të erdhi në fund të viteve 80-të kur iu dha e drejta e publikimit të studimeve të tij në shtypin shkencor si dhe iu botua përkthimi i librit "Burgimet e mija" të Pashko Vasës (1989). Në vitin 1993, botoi dy veprat studimore kushtuar dy autorëve të rëndësishëm të letërsisë shqipe: At Gjergj Fishtës dhe Ismail Kadaresë, të titulluara përkatësisht: " Fishta – Koha, Njeriu, Vepra"[27] dhe "Ekskursion në dy vepra të Kadaresë".[28] Në vitet 1995-1997 botoi artikuj e studime me shumë interes në revistën *Hylli i Dritë*s,[29] për çështje të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe,[30] dy mbishkrimeve të fillimit të shek. XIII dhe lidhjet e tyre me Principatën e Arbërit,[31] përdorimin e disa fjalëve

21 ZAMPUTI, Injac. «Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" t*ë* Gjon Buzukut dhe vendin e tij në Letërsin*ë e V*jetër Shqiptare. » *Studime Filologjike*. Tiranë, 1986, nr. 3, f. 185-204.

22 ZAMPUTI, Injac. « Shënime mbi rrethanat e vdekjes së Pjetër Budit. Letra drejtue me 1621 kardi nalit Gozzadino ». *Buletin i Shkencave Shoq*ërore, Tiranë. 1958, nr. 2, f. 67-94.

23 ZAMPUTI, Injac. «Qëmtime p*ër* Budin e Bardhin ». *Studime Historike*. Tiranë, 1985, nr. 1, f. 165-176.

24 ZAMPUTI, Injac. *Pjetër Mazrreku dhe Fjalorthi i tij i vjetit 1633*. *Studime Filologjike*. Tiranë, 1964, nr. 2, f. 167-174. *Studia Albanica*. Tirana, 1964, nr. 2, f. 129-136.

25 ZAMPUTI, Injac. « Shënime mbi kohën dhe jetën e Pjetër Bogdanit ». *Buletin i Shkencave Shoq*ërore, Tiranë, 1954, nr. 3, f. 39-56. *Qëmtime mbi Pjetër Bogdanin*. *Buletin i Shkencave Shoq*ërore, Tiranë, 1963, nr. 2, f. 199-207.

26 ZAMPUTI, Injac. « Rind*ë*rtimi i Mbishkrimit të Arbërit dhe mundësit*ë* e reja p*ër* leximin e tij ». *Iliria*, 1984, nr. 2, f. 207-218.

27 ZAMPUTI, Injac. *Fishta, koha, njeriu, vepra*. "Pasqyra„, Tiranë, 1993. 175 f.

28 ZAMPUTI, Injac. *Ekskursion në dy vepra të Kadaresë*, Shtëpia Botuese «Dituria», Tiranë, [1993], 235 f.

29 Pas vdekjes së tij, nën kujdesin e të birit Jozef Zamputti, u botuan në "Hylli i Dritës" sipas dorëshkrimeve edhe punimet e mëposhtme: "Kujtime për Dom Ndre Mjeden". Nr. 2, 2011, f. 122-141; "Gjon Kole Kujxhija". Nr. 3, 2011, f. 131-136; "Kronika e Shkodrës". Nr. 4, 2011, f. 69-84; "Çashtja e kombësisë në shekullin XVII". Nr. 2, 2012, f. 49-52; "Shënime për fazën përfundimtare të lëvizjes shqiptare dhe të ekspeditës së Gjon Kastriotit". Nr. Jubilar, 2013, f. 277-300.

30 ZAMPUTI, Injac. "*Çësht*je të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe." *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1995, Nr. 1-2, f. 14-51.

31 ZAMPUTI, Injac. "Dy mbishkrimet e fillimit të shek. XIII dhe lidhjet e tyre me

në praktikën fetare katolike,[32] prejardhjen e toponimit Valbona[33] si dhe disa përsaktësime toponimike lidhur me aksionin kolonizues të Dionisit e luftërat iliro-romake,[34] si dhe botimin me paraqitje të tekstit të transkriptuar, përkthimit dhe rindërtimit të dokumentacionit të Regestit Kamsi, të punuar me shënime plotësuese.[35]

Injac Zamputti e nxori historinë e Shqipërisë të periudhës së sundimit të zymtë osman (shek. XVI-XVIII), nga kronikat provinciale, thuajse të panjohura e të shpërndara andej-këndej ndër burime të pakta dokumentare të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke e shndërruar atë në një seri të plotë dokumentare unike të munguar për këtë periudhë historike e cila shkëlqen jo vetëm për nga sasia por mbi të gjitha për nga cilësia e saj. Udhëtimi i tij në një tokë djerrë dhe të pashkelur më parë, e cila që me vdekjen e Gjergj Kastriotit (1468) dhe rënien e Shkodrës (1479), rëndom konsiderohej si një periudhë 5 shekullore e humbur, apo e thënë ndryshe "periudhë e errësirës", që gjithsesi kishte "prodhuar" historinë e saj, rezultoi jo vetëm frutdhënës, por mbi të gjitha themelor në shkrimin e historisë së popullit shqiptar për këtë periudhë kohore. Vepra dokumentare dhe studimore e Injac Zamputti-t ia arriti të provojë qartazi se përkundrejt frakturës së rëndë politike-ekonomike dhe kulturore që kreu pushtimi osman, ai nuk arriti të bënte atë që pretendonte e pretendon të bëjë historiografia ballkanike, orientimin ideologjik i periudhës së regjimit komunist (1945-1990) dhe tash së voni edhe disa qyqarë të sevdasë neootomane, të kontaminuar me përbërës ngjyrosës nga shkretëtirat arabike, të cilët kishin dhe kanë si shumatore të përbashkët mendimin që e konsideronte kinse këtë periudhë si një shkëputje e pakthyeshme e lidhjeve të botës shqiptare me botën perëndimore, që rrekej në fund të fundit ta zhvendoste e ta paraqiste Shqipërinë në Lindje. Dokumentacioni që pruri Zamputti tregoi qartë se shqiptarët pavarësisht bindjeve fetare (katolikë, ortodoksë apo

---

principatën e Arb*ë*rit". *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1995, Nr. 5-6, f. 16-29.

32 ZAMPUTI, Injac. "Mbi disa fjal*ë* të kristalizueme në lutjet e në praktik*ën* fetare katolike". *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1996, Nr. 1-2, f. 9-17.

33 ZAMPUTI, Injac. "Valbona – argumente dhe dëshmi në lidhje me prejardhjen e këtij toponimi". *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1996, Nr. 3-4, f. 68-79.

34 ZAMPUTI, Injac. "Përsakt*ës*ime në toponiminë me fiset p*ë*rkatëse n'aksionin kolonizues të Dionisit në luftat Iliro-Romake". *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1997, Nr. 1-2, f. 25-49.

35 ZAMPUTI, Injac. "Regesti Kamsi". *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1997, Nr. 5-6, f. 70-95

myslimanë), edhe përgjatë kësaj periudhe "përgjumjeje" vijonin të ishin të orientuar nga Europa, jo thjesht si një alternativë e detyruar nga nevoja, por mbi të gjitha se ata e shihnin dhe e shohin edhe sot këtë orientim si një ndjesi dhe njëkohësisht si një përkatësi identitare. Këtë e tregon qartazi dokumentacioni i kohës i përcjellë nga Injac Zamputti, prej të cilit merret vesh se shqiptarët janë në komunikim dhe marrëdhënie të ngushtë me Republikën e Venedikut e Republikën e Raguzës, me Mbretërinë e Napolit, me Mbretërinë e Spanjës dhe Selinë e Shenjtë. Këtë barrë përgjegjësie shkencore, fati e deshi ta ndërmerrte vetiu mbi shpatulla këtu e gjashtëdhjetë vjet më parë një dijetar i tillë, më një profil elitar për të cilin familja puna dhe atdheu ishin si uji, ajri e zjarri, përmes të cilëve ai përballoi, trysninë intelektuale të një monodrame vetmitare e cila nuk e ligështoi, nuk e demoralizoi dhe nuk e dëshpëroi për asnjë çast të vetëm, por i dha mundësinë të gëzojë me modestinë që e karakterizonte për gati 9 dhjetëvjeçarë frymën dhe *corpin* e paqtë që frymonte bota e tij e pasur e shpirtit. Me të drejtë ka theksuar historiani Pëllumb Xhufi se "*....falë tij,* (Injac Zamputtit, shënimi im K.M), *historia e Shqipërisë në shekujt e sundimit osman mbeti një histori evropiane dhe nuk u katandis në një kronikë provinciale otomane*."[36]

Kontributi dhe trashëgimia e tij e pasur shkencore pranë Institutit të Shkencave dhe atij të Historisë, përfshin pjesën më të madhe të dokumentacionit të shekujve XVI-XVII, (tre shekujt të parë të sundimit osman), dhe veçanërisht dokumentacionit kishtar të kësaj periudhe. Këtë dokumentacion ai e transkriptoi, përktheu, komentoi dhe botoi në dhjetë vëllime nën logon e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit të Historisë. Si burime kryesor i studimit hulumtues për gjetjen e dokumentacionit dhe më pas përpunimit dhe seleksionimit të tij, i kanë shërbyer vjeljet e kryera nga fondet jashtëzakonisht të pasura të Bibliotekës Kombëtare në Tiranë, e cila ka ndërmjetësuar sigurimin përmes praktikës së huazimit apo mikrofilmimit të botimeve të rralla nga bibliotekat e huaja apo botime dhe dokumente të mikrofilmuara që i kishte biblioteka dhe Arkivi i Instituti i Historisë, ardhur përgjithësisht nga Arkivat e huaja, të cilët ia vunë në dispozicion autorit, ndërkohë që pjesa tjetër e përbëhej nga materiale të pabotuara që ruheshin në Arkivin Qendror të Shtetit. Janë më shumë se 5000 faqe me dokumente të dala nga dora e tij. Të gjitha këto vëllime janë botuar me transkriptimet origjinale, përkthimet përkatëse, me

36 XHUFI, Pëllumb. "Historia evropiane e Injac Zamputtit". *Shekulli*. Nr. 2878, 14 shkurt, 2010, f. 16 - 17.

indekset e emrave të personave e të vendeve dhe me shpjegimet e duhura.

Nga botimet e tij kryesore (dhjetë volume të tjera me dokumentacion historik), veçohen përmbledhja me dokumente kishtare me titull: *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII.*[37]. Vëllimi i parë ka 39 dokumente gjithsej, 16 prej të cilëve janë relacione, 19 janë letra 1 informacion, 2 janë dëshmi dhe 1 është pasqyrë. Vëllimi i dytë ka 114 dokumente nga të cilët 19 janë janë relacione, 75 janë letra dhe 20 janë të tjera si 3 dëshmi, 1 pasqyrë, 1 urdhëresë 8 lutje, 1 dëftesë, 1 informacion, 3 kërkesa 1 promemorie dhe 1 interdikt. Po ashtu përktheu dhe përgatiti për botim : *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës, 1416-1417, - Le Registre de Cadastrage et de Concessions pour le district de Shkodër 1416-1417,*[38] i cili përbën një burim me rëndësi për njohjen e krahinës së Shkodrës në fillim të shek XV. Ai ka të regjistruar të gjithë fshatrat e komunës së Shkodrës, emrat e banorëve të tyre, sasinë e detyrimeve, tokat dhe vreshtat e komunës, si doganat dhe peshkoret, bashkë me të ardhurat e tyre. Në vëllimin «Dokumenta të shekullit XV për Historinë e Shqipërisë. Vëll. IV (1479-1506). Pjesa I (1479-1499).[39] Përgatitur nga Injac Zamputi, Tiranë,1967, pjesa e parë e dokumenteve të këtij vëllimi trajton dokumentacionin lidhur me rënien e qyteteve dhe kështjellave të fundit të Shqipërisë në duart e turqve në 1479 përmes 373 dokumenteve, kurse pjesa e dytë (1499-1506), e botuar në vitin 1979,[40] përmban një shtojcë plotësuese të pjesës së parë me 58 dokumente si dhe dokumentacionin vijues që shkon deri në fund të vitit 1506 me plot 456

37 ZAMPUTI, Injac. *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII.*, Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë 3 dhe 3/2, Teksti origjinal dhe përkthimi, përgatitur nga Injac Zamputi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Vëll. I. (1610-1634). Tiranë 1963. Vëll. II. (1634-1650). Tiranë 1965. Vëll. I. 540 f. Vëll II. 525 f.

38 ZAMPUTI, Injac. *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës, 1416-1417, - Le Registre de Cadastrage et de Concessions pour le district de Shkodër 1416-1417*. Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Historisë, përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Tiranë, 1977. 499 f,

39 ZAMPUTI, Injac. *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë,* Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Vëll.IV. (1479-1506), Pjesa I, (1479-1499). Mihal Duri, Tiranë 1967. 311 f.

40 ZAMPUTI, Injac. *Dokumente për historinë e Shqipërisë 1479-1506*. Akademia Shkencave e R.P.S të Shqipërisë, Instituti i Historisë. Pjesa e dytë (1499-1506), Përgatitur për botim nga Injac Zamputi. Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Instituti i Historisë, Tiranë, 1979. 559 f.

dokumente. Kjo periudhë dokumentare pasqyron përpjekjet e shqiptarëve për të rimëkëmbur principatën e Kastriotëve. Në vëllimet katëme titull: *Dokumentet të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*. Tiranë, Instituti i Historisë, 1989. Vëllimi I, (1507-1592). Përgatitur nga Injac Zamputi, 1989; Vëllimi II, (1593-1602). Përgatitur nga Injac Zamputi, 1990. Vëllimi III, (1603-1621). Përgatitur nga Injac Zamputi: Vëllimi IV, (1675-1699). Përgatitur nga Injac Zamputi dhe Selami Pulaha, 1990,[41] përfshihen gjithsej 921 dokumente venedikase, raguziane dhe dokumente austriake në gjuhët italisht dhe gjermanisht me prejardhje nga kancelaritë e Venedikut, Raguzës, dhe Vjenës (Vëllimi i parë ka 280 dokumente, vëllimi i dytë ka 195 dokumente, vëllimi i tretë 211 dokumenet dhe vëllimi i katërt 235 dokumente), të cilët sjellin të dhëna me vlerë për krahinën perëndimore bregdetare që në shumicën e tyre botoheshin për herë të parë e që sillin të dhëna për trevat verilindore të Kosovës dhe rrafshit të Dukagjinit përmes informacioneve me hollësi lidhur me veprimet luftarake të ushtrisë austriake në këto vise për pushtimin e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, kështjellës së Kaçanikut, si dhe për depërtimin deri në thellësi të krahinës së Lumës. Këto dokumente dëshmojnë qartazi se trevat e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit ishin troje të banuara kryesisht nga popullsi shqiptare dhe përfshiheshin në konceptin gjeografik dhe etnik të Shqipërisë dhe kundërshtojnë pikëpamjet nacionaliste të mjaft studiuesve jugosllavë lidhur me popullsitë gjoja autoktone serbe në ato territore. Është kjo periudhë e cila shënon një pikë me rëndësi në organizimin e lëvizjes për çlirim nga pushtimi osman, përmes organizimit të kuvendeve shqiptare si një formë e lartë e organizimit politik shqiptarë sikurse ishte Kuvendi i Dukagjinit, në të cilin morën pjesë 2056 krerë prej 13 krahinave shqiptare, që i bie të kenë qenë të pranishëm rreth 200 krerë për secilën krahinë. Injac Zamputti përveç veprave të botuara, ka lënë edhe disa dorëshkrimet me vlerë ku spikat: Vëllimi i tretë me dokumente të nxjerra nga Arkivi i Kongregatës së Propagandës Fide në Romë **të transkriptuara e të përkthyera të periudhës mes viteve 1623-1653, me 169 dokumente e pjesë relacionesh të transkriptuara e të përkthyera + 61 dokumente të transkriptuara pa përkthim),** vëllim ky vijues i dy vëllimeve të botuara

41 ZAMPUTI, Injac. *Dokumente të shekujve XVI-XVIII për historinë e Shqipërisë*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Historisë Vëll.I. (1507-1592), Tiranë 1988, 490 f; vëll.II. (1593-1602), Tiranë 1990. 387 f; Vëll. III. (1603-1621), Tiranë 1989. 465 f; Vëll.IV. (1675-1699). Me bashkëautor dhe Selami Pulahën. Tiranë, 1990. 569 f.

tashmë para 50 vjetësh me titullin: *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII.* Teksti origjinal dhe përkthimi, përgatitur nga Injac Zamputti. Vol. I. (1610 - 1634). Tiranë 1963. Vol. II. (1634 - 1650). Tiranë, 1965, vëllim i cili u botua në vitin 2015 me titullin : *Dokumente për historinë e Shqipërisë "(1623-1653)/Documenti per la storia dell' Albania 1623–1653*.[42] Po ashtu në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë ruhet përkthimi i relacionit të Imzot Vinçenc Zmajeviçit të vitit 1702, me titullin: *Relacion i gjendjes së Shqipërisë dhe Serbisë (nënkupto: Kosovës - K. M), të vizituara nga Vinçens Zmajeviç, Arqipeshkëv i Tivarit në vitin 1702 – 1703 (Tivari – Shkodra - Postriba – Pulti - Sapa (Zadrima], Lezha – Durrësi - Serbia (Kosova),*[43] si dhe një tjetër me titull: *Dokumente të shekullit të XVIII për historinë e Shqipërisë*, Vol. I. (1700 - 1718).[44]

Materialet burimore të këtyre vëllimeve Zamputti i ka siguruar duke hulumtuar nëpër bibliografitë ekzistuese me karakter përmbledhës dokumentar, nëpër studime apo shtojca studimesh të shoqëruara me dokumente shoqëruese ilustruese të nxjerra nga fonde të ndryshme arkivore (histori të përgjithshme, intinerare udhëtimesh të udhëtarëve, materiale paralele nga burime të ndryshme, materiale të krijuara nga kancelaritë, zyrtarët, entet, të cilët hartonin shkresa, urdhëresa, raporte, porosi etj.). Një pjesë e tyre kanë qenë të botuara, kryesisht prej autorëve dhe institucioneve të huaja si ato studiuesve të ndryshëm si: Augustin Theiner, Franc Mikloshich, Stojan Novakovič, Eusebius Fermendzin, Franjo Rački, Sime Ljubič, Ivan Kukuljeviç, Vikentij Vasilyevich Makučev, Charles Hopf, Franc Babinger, Giuseppe Gelcich, Nicolae Jorga, Marino Sanuto, Konstandin Jireček, Ludëig vonThalloczy, Milan Sûfflay, Gennaro Maria Monti, Konstantinos Sathas, Vittorio Catualdi, Constantin Marinesco, François Lenormant, Donato Fabianich, Luigi Maria Ugolini, Giusepe Praga, etj., të cilët nuk e kanë pasur si qëllim më vete botimin e dokumenteve për Shqipërinë por janë marrë në shqyrtim për botim për shkak të përbajtjes

42 ZAMPUTI, Injac. *Dokumente për historinë e Shqipërisë "(1623-1653)/Documenti per la storia dell' Albania 1623–1653". Transkriptuar e përkthyer nga - Trascritti e tradotti da Injac Zamputti*. Albanisches Institut dhe "Faik Konica", Prishtinë 2015. 578 f.

43 Arkivin e Institutit të Historisë Tiranë. në sinjalizimin A – II - 535 dhe nr. inv. 4120. Vëllimi i parë f. 1 - 115, Vol. II. f. 116 - 197. Përktheu Injaz Zamputi, (1988).

44 ZAMPUTI, Injac. *Dokumente të shekullit të XVIII për historinë e Shqipërisë,* Vol. I. (1700 - 1718), Materiale të gatshme për shtyp. Dorëshkrim në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë. (A – III - 55 z. Nr. inv. 4208).

integrale të dokumentit për viset ballkanike në të cilat bënte pjesë edhe Shqipëria, por që gjendeshin në botime të ndryshme që thuajse përbënin raritete, ndaj edhe kjo ka bërë të nevojshëm botimin e plotë të dokumentit, ndërsa një pjesë janë përfshirë aty edhe si gjetje burimore rastësore. Në jo pak raste dokumentacioni i botuar më parë ka qenë i njëanshëm, i kufizuar në hapësirë dhe në përmbajtjen e tij intergrale, i kushtëzuar kështu varësisht dhe qëllimisht nga synimi i autorëve krijues të dokumentit dhe më pas edhe i botueve të tij. Në këto dokumente ka edhe ndonjë rast kur dokumenti nuk është botuar i plotë, por vetëm pjesa që Zamputti e gjykoi se kishte interes dhe që nevojitej, ngaqë sillte informacion rreth zhvillimeve ekonomiko-sociale, kishtare dhe politike të vendit në territoret e trojeve etnike shqiptare, duke ndjekur kështu një praktikë të njohur në botimet e ngjashme të kësaj natyre. Çdo material dokumentar i botuar më parë ose jo, që trajtonte në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi çështje që kanë të bëjnë me Shqipërinë dhe shqiptarët është paraqitur në këto vëllime në rend kronologjik. Një pjesë dokumentash, nisur nga qëllimi i ndryshëm autorëve dhe botuesve të cilat nuk e kënaqnin rigorozitetin shkencor janë përkthyer drejtpërdrejt nga origjinali duke sqaruar gabimet e mundshme të shtypit dhe duke e lexuar korrekt origjinalin. Pjesa më e madhe e materialeve qenë krijuar për nevoja të administratës dhe luftës, për të siguruar të dhëna lidhur me pozitën strategjike dhe burimet ekonomike për të cilat interesoheshin oborret princërore e mbretërore. Një pjesë e madhe e këtij dokumentacioni nuk është i drejpërdrejtë, por i tërthortë, i gjentur kryesisht në korrespondencën, relacionet dhe memorialet që mbaheshin me botën e jashtme. Shqipëria ishte pjesë e takimit të drejpërdrejtë me botën Perëndimore përgjatë gjithë bregdetit të saj nga Tivari, Ulqini, Shkodra, Lezha, Durrësi, Vlora, Butrinti e po ashtu edhe Himara-Labëria, Shqipëria Veriore dhe ajo e Mesme Qendrore, Dukagjini etj. Qëllimi i botimit të tyre ka qenë vënia në dispozicion të studiuesve dhe studimeve të dokumenteve të dorës së parë, të cilat do të mund të shërbenin si bazë për interpretime dhe riinterpretime të çështjeve dhe ngjarjeve të caktuara historike të përfshira në kufijtë kohor ku datohen dokumentet e botuara.[45] Materialet e tjera janë transkriptuar drejtpërdrejt nga riprodhimi fotografik i origjinaleve duke i vendosur përkrah përkthimit edhe origjinalin, pra qoftë në gjuhën e origjinaleve qoftë në përkthimin shqip, të përcjella gjithashtu me shënime sqaruese të karakterit terminologjik, historik, gjeografik dhe gjuhësor.

45 Shih: MALLTEZI, Luan. "Injac Zamputi - Historiani shqiptaro-italian që hodhi dritë mbi mesjetën tonë". *Gazeta shqiptare*. Nr. 4837, 13 shkurt, 2010, f. 18 - 19.

Gjurmimi, qëmtimi, mbledhja, arkivimi, studimi, transkriptimi, përkthimi dhe pranëvënia origjinaleve; komentimi dhe paisja me shënime kritike si dhe me indekset e emrave të personave dhe të vendeve e më në fund botimi i burimeve dokumentare për Shqipërinë dhe shqiptarët e bën Injac Zamputti-n ashtu sikurse e vën re Aurel Plasari "themeluesin e disiplinës së diplomatikës në historiografinë shqiptare"[46], dhe nuk do të ishte e tepërt të thuhet se po ai u bë njëkohësisht në kuptimin e plotë të fjalës themeluesi i shkollës historiografike shqiptare. Emri i tij rezulton të jetë emri më i cituar pothuajse në të gjitha rrethet e studimeve albanologjike të disiplinave të ndryshme jo vetëm përmes gjurmës së dokumenteve por edhe përmes studimeve të tij të vyera. Duhet thënë kjo e fundit sepse pëveçse operacioneve paleografike, tekstologjike e filologjike etj., në personalitetin e Zamputti-t shfaqet po ashtu në krye të herës historiani për të vijuar më pas gjuhëtari, etnologu, shkrimtari, kritiku dhe studiuesi i letërsisë. Do të ishte në nderin e Akademisë së Shkencave, Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe Institutit të Historisë që një nga sallat kryesore të tyre të kishin emrin e tij. Kam menduar dhe vijoj të jem i mendimit se pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike duhej të kishte një Shkollë në Paleografi, Diplomatikë dhe Arkivistikë, një lloj kursi specialistësh që përveç paleografisë, diplomatikës, filologjisë dhe gjuhëve të vjetra (greqisht, latinisht, osmanisht), të jepte mundësinë e formimit në aspekte teorike e praktike ndërdisiplinare, në mënyrë që kandidatët pjesmarrës të diplomuar në shkencat humanitare (histori, letërsi, gjuhësi, etnologji, arkeologji, antropologji kulturore, jurisprudencë apo teologji), të formoheshin si specialistë të pritshëm që garantojnë studimet e nesërme albanologjike. Kush më mirë se sa emri i Injaz Zamputti-t do të meritone përnderimin e saj?

Është për të ardhur keq që një koleksion i tillë dokumentar, i botuar sipas traskriptimeve të origjinaleve në italisht dhe përkthyer e pranëvënë në shqip, nuk gjendet në asnjë prej bibliotekave publike në rrjetin bibliotekar të Italisë. Mjafto të bësh një kërkim të thjeshtë në katalogun e *L'Istituto Centrale per il Catalogo Unico* (ICCU), në OPAC, e të vëresh kollaj, madje të mbetesh i impresionuar dhe tejet i zhgënjyer që në të gjithë këtë rrjet bibliotekash publike, nuk gjendet qoftë edhe një kopje e vetme e *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*. Një botim i tillë i një rëndësie të jashtëzakonshme për albanologjinë,

46 PLASARI, Aurel. "Injac Zamputi, themeluesi i diplomatikës shqiptare". Gazeta *Panorama*, E enjte, 28 prill 2016, f. 18-19.

i botuar për fat të mirë në një gjuhë të rëndësishme ndërkombëtare sikurse italishtja, e shkruar sipas transkriptimeve origjinale, për fat të keq mungon. Në duart e albanologëve të huaj (posaçërisht atyre italianë), qarkullojnë botime të tjera me dokumente të nxjerra nga fondi i Arkivit të Propagandës Fide të botuara nga studiues të tjerë të huaj, që kanë ndonjë dokument për Shqipërinë, ndërkohë që koleksioni i Zamputti-t mungon. Me sa duket "rrezikshmëria" e Vatikanit përgjatë periudhës së regjimit komunist, ka bërë që Italia të përjashtohej nga huazimi bibliotekar, posaçërisht për këtë lloj libri, ndërkohë që për ironi të kërkimit tënd mund të gjesh nëpër këto biblioteka përplot botime të ish-diktatorit, fjala vjen si: ***Contro il revisionismo moderno, L' eurocomunismo è anticomunismo, Il pericolo angloamericano in Albania, Rapporto sull'attivita' del Comitato Centrale del Partito del Lavoro d'Albania,*** dhe mjaft literaturë shtesë ideologjike të asaj kohe e cila gjendet mjaftueshëm në këto biblioteka, mbërritur me sa duket si literaturë e shkëmbyer. Dy vëllimet e relacione, të botuara këtu e 50 vjet më parë janë kthyer në një raritet për studiuesit, pa folur pastaj për lexuesit, madje këta vëllime nuk gjenden në një numër të madh bibliotekash kryesore qytetëse në Shqipëri dhe Kosovë, pa folur për bibliotekat e institucioneve të tjera si dhe ato shkollore, ndërkohë që vepra studimore e Zamputti-t mbetet e shpërndarë nëpër organet periodike të shtypit përgjatë 50 vjetëve pa u botuar më vete sikurse do ta meritonte, edhe përkundrejt një angazhimi publik të Institutit të Historisë kohë më parë për ta botuar atë, por është e qartë se edhe për atë institucion, nuk është e lehtë, sepse nuk mund të „shtrish këmbët më shumë se sa ke jorganin", për më tepër që kujdesin nga të „ftohtët" (jorganin), duhet ta presësh ta kesh nga qeveritë shqiptare që për gjiththçka thonë se mendojnë, por vetëm për historinë dhe kulturën e këtij vendi që nuk kërkon aq shumë parà, nuk janë kujtuar dhe me sa shihet nuk e kanë ndërmend të kujtohen ndonjëherë. Deri atëherë shpresojmë se emri dhe vepra e Zamputti-t së paku të mos kursehet nga shpërdorimet dekorative presidenciale, jo se Zamputti ka nevojë për medalje, por është fatbardhësisht historiografia dhe kultura shqiptare që ka aq shumë nevojë për emra si ai i Injac Zamputti-t.

REGJISTRI I KADASTRËS
DHE I KONCESIONEVE PËR RRETHIN
E SHKODRËS 1416-1417
RELACIONE
MBI GJENDJEN E SHQIPËRISË VERIORE
DHE TË MESME NË SHEKULLIN XVII
RELACIONE
DOKUMENTE PËR
HISTORINË E
SHQIPËRISË
(1623-1653)
DOCUMENTI PER LA STORIA
DELL' ALBANIA 1623-1653
Injac Zamputti
albanisches institut
FAIK KONICA
INJAC ZAMPUTI
FISHTA
koha
njeriu
vepra
Injac Zamputi
Ekskursion
në dy vepra
të Kadaresë

Gëzim PUKA

"VALË MBI VALË" E ATË ANTON HARAPIT - KUR ARTI I FJALËS ËSHTË MË I VËRTETË SE NGJARJET REFERENCIALE

Kënaqësia e leximit rrjedh nga mundësia e pushtimit emocional që letërsia ofron. Përsiatjet letrare lejojnë të bëhen kapërcime në kohët dhe botët e ndryshme shpirtërore. "Valë mbi valë" e Atë Anton Harapit është një novelë e receptuar relativisht vonë nga lexuesi shqiptar dhe duket se kjo novelë ofron një lëkundje të tillë midis kënaqësisë dhe meditimit për lexuesin bashkëkohor. Studiuesit që kanë marrë në shqyrtim veprën e Harapit, si Aurel Plasari dhe Anton Gojçaj, i kanë renditur veprat e këtij autori si vepra "sui generis". Si çdo tekst letrar edhe novela "Valë mbi valë" paraqitet si një sistem kompleks ku ndërveprojnë nivelet tematike, simbolike, ideologjike, linguistike, kuptimi i të cilave kërkon një hetim të kujdesshëm.

Disa pikëvështrime mbi veprën

"Valë mbi valë" u botua fillimisht tek "Hylli i Dritës" në vitet 1936-1942, ndërsa si libër më vete u botua në vitet '90. Studiuesi Anton Gojçaj me të drejtë vëren: *"Për gati gjysmë shekulli Anton Harapin dhe krijimtarinë e tij e zunë në gojë veç Ernest Koliqi dhe disa shkrimtarë e mendimtarë françeskanë, që të gjithë në "dhera të huaja", mirëpo në decenien e fundit të shekullit të kaluar me të u morën një radhë shkrimtarësh dhe kritikësh të rinj, vizionesh dhe botëkuptimesh të reja mbi artin dhe letërsinë, si Aurel Plasari, Anton Nikë Berisha, Prend Buzhala, Bardhyl Matraxhiu, Tringë Dukagjini, Gjystinë Cacaj-Shushka etj..."*[1]

Një teksti të tillë nuk mund t'i ndërpritet komunikimi me sistemin letrar shqiptar. Duhet thënë se kjo gjëmë i ka ndodhur edhe shumë teksteve dhe autorëve të tjerë që nuk patën rastin t'u drejtoheshin lexuesve në kohën kur ato u shkruan. Kjo ka ngjarë me tekstet letrare të shumë autorëve të tjerë, të cilët sistemi letrar nën diktaturë i përcolli me heshtje. Duhet shtuar

1 Gojçaj, Anton: *Fakticiteti në letërsi. Proza letrare e Anton Harapit*, Shtëpia botuese "Gjon Buzuku", Prishtinë, 2007, f. 26.

se është fat edhe i vetë formës letrare të këtyre teksteve narrative, që kanë aftësinë të komunikojnë më lehtë me lexuesin dhe të mbijetojnë.

Po të vështrohet në aspektin e vendndodhjes në letërsinë shqipe për kohën kur u shkrua, "Valë mbi valë" e A. Harapit do të pozicionohej, në qendër të të ashtuquajturit *"Qarku katolik i Shqipërisë Veriore".*[2] Duke folur me termat e një komparatisti, novela do të zinte vend në letërsinë dominante (letërsi që kundërshton normat dhe modelet zotëruese). Po të marrim në konsideratë gjendjen e sistemit letrar shqiptar të kohës, ajo do të përbënte fillesat e një letërsie moderne.

E vështruar sinkronikisht mund të themi se vepra ka specifikën e saj letrare në përshkrimin e peizazhit dhe të personazheve, në dialogun e monologun e brendshëm, në gjuhën e gjallë të rrëfimtarit, prej nga buron edhe dinamizmi i veprës. Në të njëjtën kohë, mund të thuhet se idetë filozofike që ajo përmban, të cilat në ndonjë rast nuk janë shkrirë si duhet nga forma kompozicionale, e bëjnë veprën t'i ngjasojë një sprove filozofike.

Përmes këtij artikulli do të theksojmë se është vetë struktura narrative e kësaj novele që e bën të ruhet në kujtesën e lexuesit një tekst me rreth njëqind faqe që rrëfen për një kohë ngjarjeje rreth 36 orë.[3] Përmes këtij leximi mund të vërehet se sa pak ndikon tek tekstet letrare faktori kohë i receptimit. Autorët e gjejnë vetë lexuesin. Kjo është mrekullia e komunikimit të letërsisë.

Libri në prozë i Anton Harapit "Valë mbi valë", ngjan i frymëzuar nga ngjarje apo ndodhi të jetës së vetë autorit, i cili sjell përshkrime të mrekullueshme referenciale për një rajon dhe një kontekst shumë të veçantë historik siç ishte Lufta e Parë Botërore. Shkrimi i tij edhe pse me një stil të drejtpërdrejtë, i mbarsur me ndjenja të fuqishme, duket se e befason dhe e tërheq lexuesin e sotëm.

---

2 Shih: *"Brenda literaturës shqipe unë shoh të jenë formuar katër qarqe kulturore e letrare. Janë këto: Qarku katolik i Shqipërisë Veriore, Qarku italo-shqiptar, Qarku ortodoks i Shqipërisë Jugore, dhe së fundi Literatura kombëtare e shekullit XIX."* Çabej, Eqrem: Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, Shtëpia botuese "Çabej", Tiranë, 2006, f. 61.

3 Shih: *"... fabula që zhvillohet brenda 36 orëve pa shumë kërcime para e mbrapa në kohë, flasin në favor të faktit se ajo është një novelë."* Gojçaj, Anton: Fakticiteti në letërsi. Proza letrare e Anton Harapit, Shtëpia botuese "Gjon Buzuku", Prishtinë, 2007, f. 44.

Në kontaktin me strukturën e tekstit

Narracioni fillon dhe mbaron në rrethanën nistore të bashkëkohësisë së autorit. Në kontaktin me strukturën e veprës do të vëreja se elementet e subjektit janë të organizuara sipas kësaj skeme: Nisja për në famulli; udhëtimi përmes liqenit të Shkodrës; një natë në bregun e liqenit; mbërritja; Tuzi; takimi me oficerët austriakë; famullia. Në thjeshtësinë e vet, duket sikur vepra nuk ka asnjë konflikt, asnjë dramë, përveç dramës së përditshme të jetës, dramës universale të jetës së shqiptarit që vuan për të gjetur kuptimin e jetës, të vërtetën e jetës. Këtu na vjen në ndihmë elementi biografik (Harapi prift dhe filozof i diplomuar në Austri).

Subjekti i thjeshtë dhe personazhet njerëz të thjeshtë (lundërtarët shirokas, nëna, një grup oficerësh austriakë), vihen në raport me strukturën ideore psikofilozofike të veprës. Rrëfimi dhe monologu i brendshëm vihet në raport me dialogun.

Në këtë tekst, duhet bërë një ndarje midis autorit dhe narratorit, të cilit siç duket i është dhënë e drejta të rrëfejë. *"Ishte një e merkure e korriku, vjeti 1918..."*[4] kështu fillon rrëfimi dhe të duket se do të lexosh për një ngjarje historike, por në të vërtetë rrëfimtari i shmanget pak sfondit historik duke i lënë më shumë vend një fryme romantike. Atë ditë ai do të lundrojë në liqenin e Shkodrës, për të dalë në Grudë ku ka marrë detyrën si famullitar. Duke ecur mes turmave në pazarin e qytetit, për të arritur varkën dhe për t'u nisur, ai ndien brenda vetes një trazim të çuditshëm. Është i huaj në këtë mori njerëzish praktikë: *"Popull, o popull thaçe veti me veti ti pra je njeri ti nierzimi, ti Shqypnia. Kshtu thekshem pyetshe veten, e turpshëm u matshe me depërtue në shpirtin e të gjithëve për me hetue e me pa fundin e jetës"*. [5]

Mes këtyre turmave endet një shpirt human, që dhe në veshjet e këtyre njerëzve sheh të pasqyruara copëza jete, gjallërie, shpirti, prandaj ndryshueshmërinë e tyre e kupton si ndryshueshmëri edhe në mendësi. Narracioni i Harapit ndërthur sekuenca përshkruese që lidhen me ambientin, personazhet, objektet dhe sjelljet domethënëse që duken si sekuenca statike. Të tilla janë edhe sekuencat meditative, që ftojnë në rrëfim mendimet e personazheve ose të rrëfimtarit për ngjarjet.

Rrëfimtari shfaq shpirtin dyshues për problemet e mëdha të jetës.

4 Harapi, Anton: *Valë mbi valë*, Shtëpia botuese "Shpresa & Faik Konica", Prishtinë, 2003, f. 7.

5 Po aty, f. 9.

Citojmë: *"Ku do ta pshtesin gjallnimin e vet"*[6] Është një meditim rraskapitës, teza e kundërteza, ndaj kur arrin në vendin e nisjes mendon se ky udhëtim përmes liqenit do të ishte njëkohësisht një udhëtim eksplorues edhe brenda vetes. *"Ku jam? Ku due? Shka due?"* [7] Pyetje të tilla e mbyllin dhe e frikësojnë. Ka frikën e humbjes së vetvetes përballë kësaj bote materiale. Në këtë botë duhet të ketë akoma dashuri, solidaritet njerëzor, miqësi. Koncepti i vlerës shpirtërore përvijohet edhe tek kjo prozë e Harapit. Mëdyshja, dyshimi për këtë vlerë s'është gjë tjetër veçse një frikë e natyrshme njerëzore e intelektuale. Në planin e gjatësisë kohore ai operon me teknikën e përmbledhjes përmes shkurtimit të kohës së rrëfimit përballë kohës së ngjarjes. Kur varka-simbol fillon të lundrojë dhe natyra rreth liqenit shfaqet me bukurinë e saj, ai ndien një lloj qetësimi, ndërsa për narracionin kalohet tek një thyerje e ekuilibrit. Rrëfimtari na udhëheq përgjatë udhëtimit në liqenin e Shkodrës, si dhe paraqet disa zhvillime ngjarjesh me protagonistë të përfshirë në peripeci përmirësimi apo përkeqësimi. Sekuencat rrëfimtare, përshkruese, meditative vihen në raport me dialogun. Udhëtojnë bashkë me ta dy voztarë të varfër, dy vëllezër: Gaspri dhe Shani. Strategjia autoriale kërkon t'i bëjë këta pjesëtarë edhe në udhëtimin e brendshëm. Gaspri është i matur, i urtë dhe punëtor, ndërsa Shani është mjaft i zgjuar. *"Atë natë pashë e provova shka asht drita në terr, shoqnimi në vetmi, gjallnia në shkreti".*[8]Një njeri i dijes që i mbush njerëzit e tjerë me mesazhe shprese, dashurie për jetën, për natyrën, për gjithçka të bukur dhe njerëzore.

Rrjedha e ngjarjeve dhe gërshetimi i tyre i korrespondon logjikës dhe kronologjisë. Narratori përdor edhe kapërcimet kohore duke sjellë një kuptim ose ndjenjë, duke ndarë e përshkruar një e nga një elementet që përbëjnë tekstin. Për të bërë këtë, atij i duhet të përdorë fjalën e shkruar, shumë më ngadalë se mekanizmat e të menduarit dhe duhet të bëjë një analizë që ka si rezultat një ngadalësim të kohës së veprimit përballë realitetit. Narratori na shfaqet ***in medias res***, thënë ndryshe në mes të ngjarjeve, e njeh mirë shpirtin dhe psikologjinë e shqiptarit, ndjenjat e tij shpërthyese. Me keqardhje konstaton se ky popull në historinë e tij ka qenë fatkeq, ndaj dhe nuk i është kultivuar si duhet pasioni për punë, gjë që ka sjellë pasoja edhe në zhvillimin e tij të përgjithshëm. *"Zoti e thashtë e sa ma parë t'agojë ajo ditë ku vleftja e*

6 Po aty, f. 10.

7 Harapi, Anton: *Valë mbi valë*, Shtëpia botuese "Shpresa & Faik Konica", Prishtinë, 2003, f.16.

8 Po aty, f. 30.

randsija e punës t'i hijë në shpirt shqiptarit! Kur ai t'a kuptojë e t'a shikjojë punen si vlerë e nderë, si gurrë e pashpikshme gjallnimi e perparimi, si ma të çmueshim *vizar perftues kulture, lirije e lumnije!"*.[9]

Realiteti është mjaft i dhimbshëm, aq sa nganjëherë edhe logjika më të shëndosha duket sikur humbasin vlerën para mjerimeve të mëdha që me aq emocion përcillen përmes fjalëve të Shanit, i cili është ndezur nga inati për këtë botë të padrejtë. Sekuencat dialogjike përmbajnë shkëmbimin e replikave të personazheve. Alternimi i këtyre tipeve të ndryshme të sekuencave përbën ritmin e rrëfimit të Harapit, ku mbizotërojnë sekuencat narrative të ritmit të shpejtë, ndërkohë që prezenca e sekuencave të gjata refleksive, përshkruese dhe dialogjike vijojnë shtjellimin e ngjarjeve të rrëfyera.

"He-e-e, more djalë, se s' luen fjala e të moçmit. I ngishmi kurr nuk ia din t'unshmit! Jo, more vlla, e ke kot, se zotnija nuk ka si të merr vesht, mbasi nuk e ka sprovue shka don me thanë me kenë zot shpie e babe fmish, e mos me pasë pse me shkue te shpija…"[10]

Është ky mllef i përgjithshëm i mbledhur tek këta njerëz të varfër, që shpërthen dhe duket sikur nuk ka asnjë ngushëllim. *"Mjerim e mjerim i madh, kurse nieri don, mundohet e pelset, e nuk i hecë me u ba ball as nevojave të para të jetës as nuk din si me ia ba, as s'i shef majë vetit veç me u mbytë në Buenë të pafund…"*[11]

Vlen të theksohet se në tekstin e Harapit nuk ka një rregullsi apo një ndarje të saktë se ku duhet të fillojë njëra dhe ku duhet të mbarojë tjetra nga llojet e sekuencave. Është e rëndësishme të kuptohet se pas rrjedhës së ngjarjeve, të historive që tregohen, fshihet një "makinë" e montuar sipas një prosedeje narrative mjeshtërore, e cila ruan një raport interesant midis rrëfimit dhe dialogut.

Personazhet e Harapit qëndrojnë dhe përzihen në kufirin mes tipave të personazheve që përshkruhen nga narratorri nga një pikëvështrim i jashtëm dhe nga personazhe ku narratori jep hua pikëvështrimin e tij. Gjatë dialogut që vijon duket se fillon një polemikë jo veç mes françeskanit dhe Shanit, por mes idealistit dhe materialistit. Rrëfimtari e sheh veten përballë mishërimit të mjerimit, të cilin edhe ai vetë e ka pranuar për ushqimin e shpresës. Zemreku i kësaj proze janë Shani dhe Gaspri që paralizohen para një protagonisti tjetër: *Rrëfimtarit-misionar*. Gjendja e këtyre personazheve

9 Po aty, f. 36.
10 Po aty, f. 37.
11 Po aty, f. 38.

nuk ka kohë dhe hapësirë. Ata janë të mjeruar në shumë pikëpamje, me një ankth të vazhdueshëm, të përjashtuar dhe të padobishëm. Ky dialog karakterizohet nga një stil pa asnjë lloj zbukurimi. Një ndër interpretimet që mund t'i bënim domethënieve të kësaj proze dhe këtyre vetjeve është tëhuajësimi i njeriut për shkak të ritmeve të jetesës materiale.

Shpesh narratori di aq sa dinë edhe personazhet e tij. Ai identifikohet me personazhet dhe impostohet sipas këndvështrimit të tyre, duke u përfshirë kështu brenda historisë. Në këtë rast mund të flasim për fokalizëm të brendshëm, i cili përqendrohet më shumë tek analizat e ndërgjegjes. A ka se si të mos ta këpusë shpirtin një dëshpërim i tillë. Përballë kësaj gjendjeje, frati i varfër, i emocionuar mbledh veten dhe arsyeton drejt. Asgjë e mirë prej dëshpërimit nuk vjen, sa miliona njerëz vuajnë në këtë botë dhe më keq. Megjithatë ka ngushëllim për çdo fat njerëzor qoftë edhe duke parë një më të keq se ai. *"Bluejshe me mend, se si do të mund të shti ndër kto zemra të vrame prejë skami, ndoj grimë ngushllim sado të vogël(...) E pra disi duhet me ia ba - thojshe me veti - ktu nuk asht Shani që flet e ankon, asht zemra e nierit, e mbarë njerëzimit..."* [12]

Në brigjet e këtij liqeni shtrihet fshati i tij i lindjes, një fshat i varfër me njerëz të thjeshtë. Aty ai gjen shenjat e fëmijërisë së tij, aty janë gjurmët e gëzueshme të së kalurarës, të cilat e ngazëllejnë: *"O kohë t'amla, qi nuk kthejnë ma. Kujtimi i asajë perjudhe freskon, e shum herë ven në fash jeten e rrmyeme prej tallazeve".* [13] Është një gjendje delikate shpirtërore që vjen si kontrast me jetën dinamike e të zhurmshme të qytetit. Është një qetësi që buron nga ajo natë reflektimi. Në këtë udhëtim autorin e përcjell nëna. Mjaft interesant është edhe dialogu nënë-djalë. Ajo është shpirtdhembshur, e dashur dhe plot me këshilla. Tek ky burrë i pjekur sheh akoma fëmijën e saj. Nëna si personazh i jep tregimit mjaft gjallëri dhe e bën të këndshëm.

Më në fund udhëtimi përmes liqenit mbaron. Pasi përshëndeten me voztarët, nënë e djalë mbeten të vetmuar në atë breg të shkretë të liqenit. Një trishtim i madh e ka mbuluar rrëfimtarin. Ndihet i pafuqishëm, i humbur shpirtërisht dhe gjeografikisht. Shpejt ndodh kthesa, rrugëdalja. Për çdo njeri ekziston rrugëdalja dhe ajo sipas autorit është tek besimi, shpresa, feja. Ajo është në të gjithë qenien e tij. Ndaj nuk është një mrekulli zgjidhja e çdo situate të vështirë. Në fund të fundit, i gjithë ky tregim, është si një rrymë, si një valë që vjen nga realiteti shqetësues, turbullon dhe krijon një

12 Harapi, Anton: *Valë mbi valë*, Shtëpia botuese "Shpresa & Faik Konica", Prishtinë, 2003, f. 40.

13 Po aty, f. 19.

konfuzion total, pastaj vjen kthesa, dalja nga kriza e besimit, ballafaqimi me të vërtetën dhe në fund mbrojtja e besimit. Sipas narratorit-misionar rruga më e vështirë që bën njeriu në jetë është ajo drejt besimit. Kjo është në rrafshin përmbajtësor domethënia e novelës.

Në tekstin "Valë mbi valë" gjejmë si personazhe mjaft interesante edhe disa oficerë austriakë, që u ngjajnë njerëzve në krizë ekzistenciale, që nuk po arrijnë të jenë me hapat e kohës dhe qëndrojnë mënjanë në kthina apo periferi të ngjarjeve.

Në finale kemi dialogun në mes rrëfimtarit dhe një doktori austriak për çështjet e besimit. *"Mos kujtoni, zotni, se na meshtarët katolikë duem t'a monopolizojmë të verteten; krejt kundra, misjoni i ynë asht, me u orvatë e me ba, qi e verteta të ndrise sa ma fort e sa ma shum vehtje; na nuk përjashtojmë kend, as nuk jemi refrektarë me kurrkend qi mbahet me të verteten e me shka asht e vertetë".* [14]

"Valë mbi valë" si letërsi e mirëfilltë

Atë Anton Harapi është ndër ata autorë që krijonë vetvetishëm historinë e heronjve të vet. Në këtë rast ai është bashkëkohës i heronjve, rrethanat e jetës së të cilëve i merr vesh nëpërmjet rrëfimeve dhe nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë i jetës reale.

Arti i fjalës që prodhon Harapi tek "Valë mbi valë" krijon parimisht një nivel të ri realiteti. Kur objekt i kësaj proze arti bëhet një shoqëri patriarkale apo ndonjë formë e idealizmit të pandryshueshëm, atëherë përkundër përfytyrimeve të përhapura, stimul për krijimin e një teksti të tillë letrar është jo shoqëria e pandryshueshme (stabile), por shoqëria që përjetëson proceset katastrofike, siç ishte edhe Lufta e Parë Botërore, në kontekstin e së cilës është shkruar kjo novelë. Arti i saj shihet si një mjet njohjeje dhe në radhë të parë i njohjes së njeriut. Me të drejtë studiuesi Anton Gojçaj shkruan*: " "Andrra e Pretashit" dhe "Valë mbi valë" janë dy shembuj që dalin nga i njëjti proces – shndërrimi i fakteve historike në fakte të fiksionit letrar".* [15]

Duhet të njihet fakti se udhëtimi / humbja /rigjetja në tekstin letrar "Valë mbi valë" kanë një status të dyfishtë: janë vetvetja si fakte d.m.th.,

14 Harapi, Anton: *Valë mbi valë*, Shtëpia botuese "Shpresa & Faik Konica", Prishtinë, 2003, f. 130

15 Gojçaj, Anton: *Fakticiteti në letërsi. Proza letrare e Anton Harapit*, Shtëpia botuese "Gjon Buzuku", Prishtinë, 2007, f. 97.

janë pohime ngjarjesh të jetuara, por nga ana tjetër, një domethënie mund t'u bashkangjitet këtyre domethënieve.

Mund të thuhet se domethëniet e rendit të parë janë si shenja apo simbole, të cilat nga ana e vet kanë një domethënie të një rendi të dytë, mbase më të përgjithshme e kuptimplote. Shtresa e artikulimit simbolik është ajo në të cilën domethëniet e gjuhës së Anton Harapit kthehen në shenja që kanë një kuptim më të thellë. Teksti letrar i Anton Harapit qoftë me elementet biografike, historike, filozofike apo imagjinare, na ripohon atë që Aristoteli kishte në mendje kur i referohej artit të fjalës dhe deklaronte se arti është më i vërtetë se historia. Do të shtonim se letërsia në këtë përmasë autoriale na shfaqet si një mjet i adhurimit të njeriut ndaj Krijuesit të botëve dhe mjet komunikimi me botën dhe me sprovat e njeriut në këtë botë. "*Kjo mundësi i është dhënë gjuhës dhe gjuha këtë mundësi ia ka lënë në dispozicion edhe letërsisë*".[16]

Ja pse për lexuesin e sotëm fjala që vjen përmes këtij teksti letrar, si komunikim gjuhësor, përshtatet me rregullat hyjnore të komunikimit. Novela "Valë mbi valë", kudo që të pozicionohet, qoftë në anën e referencialitetit faktik, qoftë në anën të trillit letrar, është e vërtetë për nga ndjeshmëria dhe bukuria e saj.

BIBLIOGRAFI:

ÇABEJ, Eqrem (2006): *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes,* Shtëpia botuese "Çabej", Tiranë, 126 f.

DADO, Floresha (2006): *Teoria e veprës letrare – Poetika,* Shtëpia Botuese "Toena",Tiranë, 326 f.

GOJÇAJ, Anton (2007): *Fakticiteti në letërsi. Proza letrare e Anton Harapit,* Shtëpia botuese "Gjon Buzuku", Prishtinë, 102 f.

HARAPI, Anton (2003): *Valë mbi valë,* Shtëpia Botuese "Shpresa & Faik Konica", Prishtinë, 149 f.

KRASNIQI, Milazim (2010): *Letërsia dhe besimet fetare,* Shtëpia botuese "Logos", Shkup, 310 f.

PLASARI, Aurel (1994): *Anton Harapi i ridimensus,* Revista "Hylli i Dritës".

16 Krasniqi, Milazim: Letërsia dhe besimet fetare, Shtëpia botuese "Logos", Shkup, 2010, f. 294.

Hans-Joachim Lanksch

Gjuha dhe poetika e Martin Camajt

Po ia nis me nji konstatim banal: gjuha e shkrimtarit Martin Camaj asht gege. Në nji dokumentar për Martin Camajn autorja e filmit, Juli Krisafi, disa specialistëve ua shtroi pyetjen se pse Martini nuk shkruente në gjuhën e njisueme. Njena e përgjigjeve qe: në Itali dhe Gjermani ai ka kenë larg viseve shqipfolëse dhe nuk e kishte ma lidhjen me gjuhën aktuale shqipe. Ky asht nji nonsens i madh. Në Mynih dhe Lenggries Martin Camaj ka kenë i parapaguem në disa organe të shtypit shqiptar: *Zëri i Popullit*, *Bashkimi*, *Nëndori*, *Drita* dhe gazeta dhe revista rajonale. I lexonte përditë për të ndjekë 1. se çfarë po ndodhte në Shqipni dhe 2. se si ishte gjendja dhe zhvillimi i gjuhës së njisueme. Përveç kësaj rregullisht lexonte dhe letërsinë bashkëkohore të Shqipnisë. Martini e njihte fort mirë gjuhën shqipe me krejt gamën e versioneve, varieteteve dhe të folmeve të saj – prej gjuhës së njisueme deri te idioma e arbreshëve. Ai e përdorte gegnishten veriore kryesisht për dy arsye: 1) ajo ishte idioma e tij e natyrshme, me të asht rritë, në të asht shkollue, në të mendonte dhe ndjente dhe 2) ai kishte para sysh jo vetëm gegnishten por **gjuhën shqipe**, nji gjuhë të tansishme kombëtare ku njisuemishtja do të përfshinte edhe thesaret e varieteteve të saj dhe ku dy trungjet e saj kryesore, baza toske e gjuhës së njisueme dhe gegnishtja letrare, nuk do të zhvilloheshin ndaras në divergjencë por do të shkriheshin në nji proces të lirë e organik konvergjence. Nuk asht e rastit se gegnishtja e Martin Camajt gjithnji e ma shumë i afrohej gjuhës së njisueme: "nji" bahet "një", "ishin kanë" bahet "kanë qenë", "pranveruer" bahet "pranveror" etj.

Gjuha dhe poetika e Martin Camajt nuk mund të ndahen nga njenatjetra. Gjuha e tij asht nji pjesë konstituive e poezisë dhe prozës së tij, mund të themi edhe se gjuha e tij asht nji koncept i të shkruemit e tij. Gjuha e poezisë camajane asht vetë poezi. Fjalës letrare të Martinit do t'i hiqej fuqia ekspresive dhe magjike po t'i hiqej gegnishtja. Nji gjuhëtar gjerman propozoi që vepra e Martin Camajt të "përkthehej" në gjuhën e njisueme për t'u përhapë ma lehtë. Po të bahej asi përkthimi, do të ishte nji zhveshje, nji zvetënim sikur të këndoheshin kangë popullore shqiptare p.sh. hungarisht a persisht. Jo se gjuha e njisueme s'paska vlera të saj, por Camaj i konceptonte, komponente dhe shkruente poezitë dhe prozat me

fjalët, togfjalëshat, frazeologjizmat e gegnishtes dhe me prozodinë gege, dmth. me zanoret hundore dhe gjatësitë e ndryshme rrokjesh. Me amputimin e tipareve specifike leksikore, frazeologjike, prozodike dhe fonologjike, gjuhës poetike të Camajt në poezi dhe prozë do t'i tretej muzikaliteti dhe tingulli specifik. Për Martin Camajn tingulli ka kenë me randësi të dorës së parë. Ai thoshte vetë se fjala "TINGULL" (dhe vetë tingulli i saj) ishte fjala e tij ma e dashtun. Poezitë e tij janë edhe kompozime tingullore, nji muzikë që duhet pasë para sysh në leximin e tyne.

Bukuria dhe magjia e poezisë së Martin Camaj ka kryesisht dy sekrete: thjeshtësinë (në dukje, si do të thoshte ai vetë) dhe ngjeshjen. Në tekstet e tij nuk ka zbukurime, lajle, arabeske – me nji fjalë: nuk ka gja të tepërt. Nuk ka përshkrime të gjata dhe shumëfjalëshe, nuk ka shpjegime llafëshumë, nuk ka metafora tekanjoze, shprehje artificiale, pozime të shtira. Fjalët rrjedhin natyrshëm, thjesht si në kuvendimet e pleqve të urtë. Përzgjedhja dhe kombinimi i fjalëve, tingujve, imazheve e simboleve përban artin e të shkruemit të Martin Camajt.

Ngjeshja e teksteve, strumbullari i dytë i letërsisë së tij rranjët i ka në traditat e moçme gojore me të cilat rritej Martini i ri. Kangët lirike dhe epike, legjendat, përrallat, trajtat e gjata e të shkurta traditash gojore na vijnë nga kohnat e lashta, nga nji botë pa shkrim ku tekstet duheshin mbajtun mend përmendsh, kështu që s'kanë kenë me vend pispillosje të panevojshme, të udhës ka kenë dendësimi, përqëndrimi në thelbin, në esencën. Këtë strukturë e përvetësonte Martin Camaj në poezinë e tij. Kjo poezi nuk asht as përshkruese dhe as narrative por përdor imazhe dhe simbole, për këtë ajo shpesh quhet "hermetike" – sidomos nga lexues joshqiptarë. Në këtë mes flitet shumë për ndikimin e Camajt nga Giuseppe Ungaretti: Ungaretti ka kenë profesori i Camajt në Romë, Ungaretti ka kenë poet hermetist, Camaj asht poet hermetik, prandej: Camaj asht i ndikuem prej Ungaretti-t. Ky asht nji silogjizëm sikur të thonim: kali ec mbi tokën dhe ka veshë, njeriu ec mbi tokën dhe ka veshë, prandej: njeriu asht kalë.... Hermetizmi i Martin Camajt bazohet në thesarin e lashtë traditash gojore shqiptare. Kur jetonte dhe studionte në Romë ai njihej me poezinë e hermetistëve italianë dhe autorëve të tjerë modernë europianë, Camaj ndjente nji afinitet me këto forma të dendësueme poetike dhe thurte poezi tue zbatue strukturat e ngjeshuna të thesarit të lashtë gojor të popullit. Me këto struktura të lashta Martin Camaj krijonte poezi moderne, dendësimi eliptik e ban moderne poezinë e tij. Poezia e Martin Camaj, kësisoj asht nji simbiozë e modernës me arkaiken.

Aristea KOLA

Korpusi i soneteve të Arshi Pipës

Korpusi i soneteve të Arshi Pipës asht i shpërndamë në disa vepra poetike të tij. Botimet e para të soneteve të Pipës, i gjejmë tek vepra *Lundërtarë* botue në 1944. Në këtë vëllim përfshihen gjashtë sonete:

Dashuni e pakohshme (f. 19)[1]
Post mortem (f. 20)
Lulja e mallit (f. 21)
Borë I, II, III (ff. 80-82)

Sonetet e tjera, të cilat përfshijnë pjesën dërrmuese të krejt korpusit sonetor të A. Pipës gjenden të botueme në *Librin e burgut* (Romë, 1959). Në të bajnë pjesë:

Natë e parë (f. 27)[2]
Kanali I-XXIV (ff. 63-79)
Tingëllim i këputun (f. 79)
Prendvera e bodrumit I, II (ff. 128-129)
Excelsius (f. 149)
Mëshirë (ff. 149-150)
Nisje (f. 155)
Burg i Burrelit (f. 156)
Mbreti Pleurat I-IX (f. 168-173)
Giordano Bruno I-XIII (f. 179-187)

Kjo vepër përmban 54 sonete të konceptueme kryesisht në cikle. Ky grup sonetesh përban palcën e modelit të sonetit të Pipës: sonet ky, me natyrë ***testimoniale***. Këto krijime gjenden të shpërndame (si kohë kompozicionale) sipas lokaliteteve, ku autori ishte pa të drejtë lirie. Kështu, burgu i Gjirokastrës, i Tiranës, i Burrelit, i Durrësit, kampi i Vloçishtit ngjajnë me rrathët e ferrit dantesk. Prandaj edhe natyra ndërtimore e sonetit ndryshon simbas kontekstit të përgjithshëm të autorit. I gjithë *Libri*

1 Të gjitha citimet e kësaj vepre janë marrë nga Arshi Pipa, *Lundërtarë; Libri i dashunís dhe i fatit*, Vepra 1, Plejad [anastatik i vitit 2000 nga Phoenix], Tiranë, 2010.

2 Të gjitha citimet e kësaj vepre janë marrë nga Arshi Pipa, *Libri i burgut*, [anastatik i vitit 1959], Eurorilindja, Tiranë, 1994.

i burgut, sikurse edhe vepra të tjera të Pipës, asht shkrue në burg dhe asht arritë që të nxirret jashtë hekurave. Në këtë mënyrë dallojmë kontributin sakrifikues të autorit për veprën e tij. Nëse ai do të diktohej se ç'përmbajtje kishin poezitë e tij, varet se me ç'rrethana do të ishte përballë.

Ma pas nji pjesë e mirë e soneteve që përfshihen në *Libri i burgut*, gjenden të rikonceptueme në *Meridiana* (1969). Korpusi i soneteve që përfshihet në këtë vepër asht si ma poshtë:

Moçali I-V (ff. 134-138)[3]
Kukuvajka (f. 143)
Burrel (f. 148)
Mbreti Labeat I-V (ff. 149-153)
Giordano Bruno I-IV (ff. 154-157)

Ciklet sonetore kryesisht, në këtë vepër, janë reduktue, riemërtue ose asht ndërhy në tanësinë e produktit poetik. Asht me interes fakti i përpunimit të soneteve dhe botimi i tyne, dhetë vite ma pas, tashma jo në burg por në nji vend të lirë, në Amerikë. Vetë autori pohon për *Librin e burgut* (*L.B.*): "*qysh lindi nji libër ndër burgjet komuniste të Shqipnìs dhe qysh udhëtoi s'andjemi der te Shtatorja e Lirìs*".[4]

Pas këtyne tri veprave kemi nji vepër tjetër, jo në shqip por në gjuhë të huej. Në vëllimin *Autobiography*, gjejmë përkatësisht gjashtë sonete:

Fille de Mostar – frangjisht (ff. 38-39)[5]
Conscience de vie – frangjisht (ff. 40-41)
Hope – anglisht (f. 43)
Langage de fleurs – frangjisht (ff. 50-51)
Metamophose – frangjisht (f. 69)
Sogno – italisht (f. 71)

Siç vihet re, sonetet në frangjisht zanë pjesën ma të madhe. Kemi nji raport të tillë: frangjisht, 4 sonete; anglisht, 1 sonet; italisht, 1 sonet. Pipa njihet po ashtu edhe si përkthyes (kemi parasysh *Lyrika latine* dhe *Lyrika evropiane moderne*),[6] por fakti i autorësisë në gjuhë të huej përban nji

3 Të gjitha citimet e kësaj vepre janë marrë nga Arshi Pipa, *Poezi*, Dukagjini, Pejë, 1998.
4 *Paraqitje*, *L.B.*, *vep. e cit.*, f. 10.
5 Të gjitha citimet e kësaj vepre janë marrë nga Arshi Pipa, *Autobiography*, Vepra 2, Plejad [anastatik i vitit 2000 nga Phoenix], Tiranë, 2010.
6 Të dy botimet janë kolanë e Phoenix fillimisht e ma pas e Plejadit.

rast të randësishëm. Kësisoj dëshmohet dhe gjanësia intelektuale e këtij autori. Pipa, nuk asht vetëm njohës i mirë i shqipes, i dy sistemeve të saj: gegënisht dhe toskënisht, por edhe i disa gjuhëve të hueja, në të cilat madje ka arritë të eksperimentojë me sonetin.

Morfologjia e sonetit

Në këtë punim do të trajtojmë përbamjen strukturore të secilit sonet të Pipës, nisë nga rendi kronologjik i veprave. Evidentimi morfologjik i soneteve, asht tregues i larmisë apo i varianteve të shumta, të sekstinës kryesisht. Gjatë kërkimeve tona na rezulton se ndër 80 sonete, të shkrueme në gjuhën shqipe, oktava *abba baab* asht e vetmja që përdoret. Ndërsa sekstina asht e ndryshme.

Sa i përket librit *Lundërtarë*, ndër 6 sonete, në të cilët përjashtojmë sonetin me bisht, skema dominuese e sekstinës asht *cdc dee* (2/6). Tercina e parë ma e shpeshtë e sekstinës, asht *cdc*. Ma poshtë po japim skemën e soneteve marrë nga *Lundërtarë*:

Dashuni e pakohshme [abba baab cde cde]
Post mortem [abba baab cdc dee]
Lulja e mallit [abba baab cdc eed]
Borë I [– – [7*] cdc ede]
II [– – cdc dee]
III [– – cde fed gfg]: *sonet me bisht*

Tek *L.B.* skemat ma të denduna të sekstinës janë *cdd cee* (12/53) ose *cdd eed* (12/53); *ccd eed* (10/53). Kurse si tercina të para *cdd* dhe *ccd*, ndër 53 sonete që përmban *L.B.*, sigurisht tue përfshi dhe ciklet, dalin me 20 herë prezencë secila. Në vijim, po paraqesim skemat përkatëse:

Natë e parë [– – cdc dee]
Kanali I [– – ccd eed]
II [– – cdd cee]
III [– – cdd cee]
IV [– – ccd eed]
V [– – ccd eed]
VI [– – cdd cee]
VII [– – cdd cee]

7 * Kjo shenja tregojnë oktavën e njëjtë të A. Pipës [*abba baab*].

VIII [− − cdd cee]
IX [− − cdd ece]
X [− − cdd cee]
XI [− − cdd cee]
XII [− − cdd cee]
XIII [− − ccd eed]
XIV [− − ccd eed]
XV [− − ccd eed]
XVI [− − cdd cee]
XVII [− − ccd eed]
XVIII [− − ccd eed]
XIX [− − ccd eed]
XX [− − ccd dee]
XXI [− − ccd eed]
XXII [− − ccd eed]
XXIII [− − cdc ede]
XXIV [− − cdd cee]
Tingëllim i këputun [− − cdc dcd]
Prendvera e bodrumit I [− − cdd cee]
II [− − cdc dee]
Excelsius [− − cdc dee]
Mëshirë [− − ccd eed]
Nisje [− − cde dce]
Burg i Burrelit [− − cdd cee]
Mbreti Pleurat I [− − cdd ccd]
II [− − cdd ccd]
III [− − cdd cdc]
IV [− − cdc dcd]
V [− − cdd ccd]
VI [− − cdd ccd]
VII [− − cdc dcd]
VIII [− − ccd ccd]
IX [− − ccd dcd]
Giordano Bruno I [− − cdc ddc]
II [− − cde ddc]
III [− − cdd cdc]
IV [− − ccd cdd]
V [− − ccd cdd]

VI [– – ccd cdd]
VII [– – cdc cdd]
VIII [– – ccd dcd]
IX [– – cdc dcd]
X [– – cdd ccd]
XI [– – ccd dcd]
XII [– – cdc ddc]
XIII [– – cdc dcd]

Tek *Meridiana* skema ma e shpeshtë e sekstinës, në 16 sonete gjithsej, asht *ccd eed*. Kurse *ccd* si tercinë e parë del 7 herë, si konstrukti ma i naltë në frekuencë. Poshtë, skemat e plota të soneteve:

Moçali I [– – cdd cee]
II [– – cdd cee]
III [– – ccd eed]
IV [– – ccd eed]
V [– – ccd eed]
Kukuvajka [– – cdc dee]
Burrel [– – ccd ede]
Mbreti Labeat I [– – cdd ccd]
II [– – cdd cdc]
III [– – cdc dcd]
IV [– – cdc cdd]
V [– – ccd dcd]
Giordano Bruno I [– – cdc cdd]
II [– – ccd cdd]
II [– – ccd dcd]
IV [– – cdc ddc]

Tek vepra *Autobiography*, kemi 6 sonete, në të cilat skema bazë e oktavës asht *abba abba* (5/6). Sekstina ma dominate, ndërkaq asht *ccd eed* (3/6). Tercina e parë e sekstinës si ma përfaqësuesja *ccd* (4/6).

Nga *Autobiography*:
Fille de Mostar [abba abba ccd eed]
Conscience de vie [abba abba ccd eed]
Hope [abba abba ccd eed]
Langage de fleurs [abba abba cdd cee]

Metamophose [abab cdcd efg feg]
Sogno [abba abba ccd ede]
Organizimi i rimave simbas kategorisë gramatikore

Përveç paraqitjeve të skemave rimuese të sonetit, e shohim me interes që të trajtojmë edhe aspektin e kategorisë gramatikore të sonetit të A. Pipës. Në këtë mënyrë vërehet edhe cilësia organizuese e vargut dhe e rimave në sonet. Gjatë kërkimit tonë kemi konstatue se rimat emnore mbisundojnë në pesë kategoritë formuese të rimave (emnore, mbiemnore, foljore, përemnore dhe ndajfoljore). Në përllogaritjen tonë për rimën emnore, meqenëse asht dominuesja, rezulton se 65% e të gjithë rimave, ndër 73 sonete shqip (ku përjashtojmë tipologjinë e sonetit me bisht) asht e tillë. Pra ndër 1022 rima të përdoruana nga Pipa [73 sonete x 14 vargje], 659 janë rima emnore. Pjesa tjetër, kuptohet, janë rima të përdoruna simbas kategorive gjuhësore që dhamë nalt. Ky asht nji tregues konkret për cilësinë poetike të Arshi Pipës për të përdorë llojin ma të vështirë të rimës për sa i përket nivelit gramatikor.

Kemi vu re se nji pjesë e natyrave të rimës për nga ana gjuhësore, përkojnë me anën skematike të rimës. P. sh. oktava e sonetit *Kanali* XI, e cila asht, kuptohet, *abba baab*, i përgjigjet edhe për nga rrafshi i strukturës gjuhësore njilloj: mbiemën-emën-emën-mbiemën / emën-mbiemën-mbiemën-emën (*e brymtë-krahnorit-zorit-i krymtë* / *Qershorit-e lymtë-i zymtë-Nandorit*). Të tillë strukturë e ndeshim edhe tek disa sonete të tjera, siç asht rasti i *Mbreti Labeat* III, (em.-mb.-mb.-em. / mb.-em.-em.-mb.), *Mbreti Pleurat* VII (fo.-em.-em.-fo. / em.-fo-fo.-em.), *Giordano Bruno* II (mb.-em.-em.-mb. / em.-mb.-mb.-em.). Po përsëri vihen re struktura të ndryshme organizative, si në rastin e *Kanali* XVI, ku kemi nji oktavë të njëjtësueme me emën (*iriq-krraba-shkaba-lakuriq* / *baba-miq-sihariq-zhaba*), e cila pasohet prej nji sekstine të tillë: emën-emën-folje / emën-emën-folje (*krup-shpellë-përcjellë* / *trup-krodhën*[8]*-ndodhën*). Po prapë në struktura të veçanta mund të rendisim *Mbreti Pleurat* II dhe *Mbreti Labeat* I, të cilët kanë të integrueme 13 emna në cilësinë e rimave, dhe 1 folje, përkatësisht secili. Ka edhe trajta të sekstinës me ndërtime specifike, që për nga ana vizuale ngjajnë me skemat rimuese (p. sh. rasti i sonetit *Mëshirë*, sekstina ndërtohet: em.-mb.-em. / em.-mb.-em.).

Për me e konkretizue këtë analizë, u pá e nevojshme të ndërtohet nji

8 Bahet fjalë për krodhën e bukës.

tabelë, e cila ndihmon në sqarimin ma të imët të punës sonë. Në vijim tabela përkatëse: Paraqitja tabelore e kategorisë gramatikore të rimave të soneteve të A. P., për sonetin shqip

Soneti	**Oktava I**	**Oktava II**	**Sekstina I**	**Sekstina II**
Dashuni e pakohshme	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.-em.	për.-em.-fo.	em.-em.-fo.
Post mortem	em.-em.-em.-em.	mb.-em.-em.-mb.	em.-em.-em.	fo.-për.-ndajf.
Lulja e mallit	mb.-em.-fo.-fo.	fo.-ndajf.-mb.-fo.	em.-em.-em.	em.-em.-fo.
Borë I	mb.-em.-mb.-fo.	em.-fo.-fo.-fo.	em.-ndajf.-em.	mb.-mb.-fo.
Borë II	fo.-për.- mb.-fo.	em.-fo.-mb.-em.	fo.-fo.-mb.	mb.-em.-për.
Borë III	*sonet me bisht*	*sonet me bisht*	*sonet me bisht*	*sonet me bisht*
Natë e parë	fo.-em.-em.-em.	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.	em.-ndajf.-em.
Kanali I	em.-em.-em.-em.	em.-em.-fo.-em.	em.-për.-fo.	em.-em.-mb.
Kanali II	em.-em.-për.-em.	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.	em.-mb.-em.
Kanali III	fo.-fo.-fo.-em.	fo.-fo.-për.-fo.	em.-em.-fo.	em.-em.-em.
Kanali IV	em.-em.-ndajf.-em.	em.-em.-em.-em.	em.-em.-ndajf.	fo.-fo.-em.
Kanali V	em.-em.-em.-em.	em.-ndajf.-em.-em.	em.-em.-ndajf.	fo.-fo.-em.
Kanali VI	fo.-ndajf.-em.-fo.	em.-fo.-fo.-em.	em.-për.-ndajf.	mb.-em.-ndajf.
Kanali VII	ndajf.-fo.-fo.-mb.	fo.-ndajf.-em.-fo.	fo.-fo.-em.	fo.-fo.-fo.
Kanali VIII	em.-fo.-fo.-em.	em.-em.-em.-em.	fo.-fo.-fo.	fo.-fo.-ndajf.
Kanali IX	em.-fo.-fo.-em.	fo.-mb.-em.-fo.	em.-em.-em.	em.-em.-em.
Kanali X	em.-fo.-em.-mb.	fo.-em.-em.-fo.	fo.-em.-em.	ndajf.-em.-em.
Kanali XI	mb.-em.-em.-mb.	em.-mb.-mb.-em.	em.-fo.-fo.	fo.-fo.-fo.
Kanali XII	ndajf.-em.-em.-em.	em.-em.-em.-fo.	em.-em.-em.	em.-em.-për.
Kanali XIII	em.-em.-em.-em.	mb.-em.-em.-ndajf.	em.-em.-fo.	em.-em.-em.
Kanali XIV	fo.-fo.-fo.-fo.	fo.-fo.-fo.-em.	fo.-mb.-ndajf.	fo.-fo.-ndajf.
Kanali XV	em.-em.-em.-fo.	mb.-em.-em.-em.	em.-em.-mb.	em.-em.-em.
Kanali XVI	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.-em.	em.-em.-fo.	em.-em.-fo.
Kanali XVII	em.-em.-fo.-fo.	ndajf.-em.-fo.-em.	fo.-fo.-em.	fo.-fo.-ndajf.
Kanali XVIII	em.-fo.-em.-em.	fo.-em.-em.-fo.	em.-em.-em.	em.-em.-em.
Kanali XIX	em.-em.-për.-em.	mb.-em.-em.-em.	em.-fo.-em.	ndajf.-fo.-em.
Kanali XX	mb.-fo.-em.-em.	em.-fo.-em.-em.	em.-em.-em.	ndajf.-fo.-em.
Kanali XXI	em.-ndajf.-fo.-em.	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.	em.-ndajf.-em.
Kanali XXII	em.-fo.-fo.-fo.	em.-em.-fo.-em.	për.-em.-em.	mb.-em.-em.
Kanali XXIII	fo.-për.-em.-em.	ndajf.-em.-fo.-em.	fo.-em.-fo.	em.-em.-em.
Kanali XXIV	em.-em.-em.-mb.	em.-em.-ndajf.-em.	em.-fo.-em.	për.-em.-em.
Tingëllim i këputun	për.-em.-ndajf.-për.	mb.-em.-em.-em.	em.-për.-em.	em.-em.-për.

Prend. e bodrumit I	ndajf.-em.-fo.-fo.	ndajf.-em.-em.-ndajf.	em.-em.-em.	em.-em.-em.
Prend. e bodrumit II	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.-em.	ndajf.-ndajf.-ndajf.	fo.-për.-em.
Excelsius	em.-em.-mb.-mb.	mb.-mb.-em.-em.	mb.-fo.-em.	em.-em.-mb.
Mëshirë	për.-em.-em.-em.	em.-em.-em.-mb.	em.-mb.-em.	em.-mb.-em.
Nisje	fo.-em.-fo.-ndajf.	fo.-em.-fo.-fo.	em.-fo.-mb.	fo.-em.-mb.
Burg i Burrelit	em.-em.-em.-em.	em.-fo.-em.-em.	em.-em.-fo.	ndajf.-fo.-em.
Mbreti Pleurat I	em.-fo.-ndajf.-em.	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.	em.-em.-fo.
Mbreti Pleurat II	em.-em.-em.-em.	em.-em.-fo.-em.	em.-em.-em.	em.-em.-em.
Mbreti Pleurat III	ndajf.-fo.-em.-fo.	em.-fo.-em.-em.	fo.-mb.-em.	em.-fo.-për.
Mbreti Pleurat IV	fo.-mb.-em.-em.	mb.-mb.-fo.-em.	fo.-em.-em.	em.-fo.-em.
Mbreti Pleurat V	em.-mb.-mb.-em.	em.-em.-em.-em.	mb.-fo.-ndajf.	mb.-mb.-em.
Mbreti Pleurat VI	mb.-mb.-mb.-ndajf.	mb.-mb.-em.-fo.	em.-em.-em.	mb.-em.-em.
Mbreti Pleurat VII	fo.-em.-em.-fo	em.-fo.-fo.-em.	em.-ndajf.-mb.	em.-em.-em.
Mbreti Pleurat VIII	em.-fo.-mb.-mb.	mb.-em.-em.-ndajf.	ndajf.-em.-fo.	em.-fo.-em.
Mbreti Pleurat IX	em.-mb.-em.-em.	mb.-em.-em.-mb.	fo.-ndajf.-em.	ndajf.-fo.-em.
Giordano Bruno I	për.-em.-em.-ndajf.	mb.-em.-em.-mb.	em.-em.-em.	em.-em.-em.
Giordano Bruno II	mb.-ndajf.-ndajf.-em.	mb.-em.-em.-mb.	ndajf.-fo.-em.	fo.-fo.-fo.
Giordano Bruno III	em.-em.-em.-mb.	em.-ndajf.-em.-em.	em.-em.-em.	em.-fo.-em.
Giordano Bruno IV	em.-em.-fo.-em.	em.-fo.-fo.-em.	fo.-em.-fo.	em.-fo.-fo.
Giordano Bruno V	fo.-mb.-ndajf.-em.	ndajf.-ndajf.-fo.-ndajf.	em.-fo.-fo.	fo.-fo.-fo.
Giordano Bruno VI	mb.-em.-em.-em.	em.-em.-em.-mb.	për.-em.-mb.	fo.-em.-ndajf.
Giordano Bruno VII	em.-em.-em.-em.	fo.-em.-fo.-ndajf.	em.-fo.-em.	em.-fo.-em.
Giordano Bruno VIII	mb.-për.-em.-em.	em.-em.-për.-em.	mb.-mb.-em.	em.-ndajf.-em.
Giordano Bruno IX	ndajf.-em.-em.-em.	ndajf.-em.-fo.-em.	em.-mb.-mb.	em.-mb.-mb.
Giordano Bruno X	em.-em.-fo.-em.	fo.-em.-em.-em.	em.-em.-em.	em.-em.-mb.
Giordano Bruno XI	em.-mb.-ndajf.-em.	mb.-mb.-em.-fo.	fo.-em.-mb.	em.-em.-em.
Giordano Bruno XII	em.-em.-em.-em.	em.-për.-em.-em.	em.-për.-em.	em.-em.-em.
Giordano Bruno XIII	fo.-em.-em.-mb.	em.-fo.-fo.-em.	em.-em.-em.	em.-em.-em.
Moçali I	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.-em.	fo.-em.-em.	fo.-em.-em.
Moçali II	fo.-fo.-fo.-em.	fo.-em.-em.-fo.	em.-em.-fo.	em.-em.-em.
Moçali III	em.-em.-ndajf.-em.	em.-em.-em.-em.	em.-em.-ndajf.	em.-em.-em.
Moçali IV	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.	fo.-fo.-em.
Moçali V	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.-em.	em.-em.-mb.	em.-em.-fo.
Kukuvajka	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.-em.	ndajf.-em.-mb.	fo.-për.-em.
Burrel	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.-em.	em.-em.-em.	em.-em.-em.
Mbreti Labeat I	em.-em.-em.-em.	em.-em.-fo.-em.	em.-em.-em.	em.-em.-em.
Mbreti Labeat II	ndajf.-fo.-fo.-fo.	em.-fo.-em.-em.	fo.-mb.-em.	em.-fo.-për.

Mbreti Labeat III	em.-mb.-mb.-em.	mb.-em.-em.-mb.	em.-ndajf.-mb.	em.-ndajf.-em.
Mbreti Labeat IV	mb.-mb.-mb.-ndajf.	mb.-mb.-em.-fo.	fo.-fo.-ndajf.	mb.-em.-ndajf.
Mbreti Labeat V	em.-mb.-ndajf.-em.	mb.-em.-em.-mb.	fo.-ndajf.-em.	ndajf.-fo.-em.
Giordano Bruno I	për.-em.-em.-ndajf.	mb.-em.-em.-mb.	em.-em.-em.	em.-em.-em.
Giordano Bruno II	mb.-em.-em.-mb.	em.-mb.-mb.-em.	em.-fo.-fo.	fo.-fo.-fo.
Giordano Bruno III	mb.-për.-em.-em.	em.-ndajf.-për.-em.	fo.-mb.-em.	em.-ndajf.-em.
Giordano Bruno IV	em.-em.-em.-em.	em.-për.-em.-em.	em.-për.-em.	em.-em.-em.

em. – emën
mb. − mbiemën
për. – përemën
fo. – folje
ndajf. – ndajfolje

Funksioni i sonetit

Sonetet e Pipës, pá në kandvështrimin e përgjithshëm të poezive, kanë nji funksion specifik. Ato sikundërse thotë dhe vetë autori në *L.B*. nuk kanë dimensione përshkruese: "*Karakteri në thelb lyrik i librit n'anën e vet, nuk lêjonte auktorin qi ta ngarkonte me hollësì përshkruese rreth vendit, kohës, dhe vetjeve*".[9] Asht vetë autori që sonetet (në këtë rast) sugjeron që t'i receptojmë jo thjesht si fakte apo dokumentime besnike të ngjarjeve apo historisë kronologjike, por të kërkojmë kuintesencën poetike. Kështu funksioni i soneteve, ruen cilësitë e përgjithshme të funksionit të letërsisë (funksionin e vet *katharstik*).[10]

Funksioni kondensues i imazhit asht tipar kyç në poezinë e Pipës. Nëse nisemi nga rrethanat e autorit, në kohën kur u kompozuen sonetet, mbërrijmë në gjykimin se përjetimi, tanësia reale e imazheve, reduktohen në nji formë poetike siç asht soneti. Mjeshtëria autoriale, tashma, asht sesi ta rrëfejë diçka të mundshme për me u rrëfye. Diçka që nis nga realiteti i nji periudhe politike, dhe që dështmohet në trajtë artistike. Toni dhe ritmi

9 *L.B.*, *vep. e cit*., ff. 10-11.

10 Khs. René Wellek; Austin Warren, *Theory of Literature*, Harcourt, Brace and Company, New York, 1949: "*It remains to consider those conceptions of the function of literature clustered about the word "catharsis.""*, f. 27. Ose khs.: "*Na mbetet të vështrojmë ato koncepte për funksionin e letërsisë që lidhen me idenë e fjalës "katharsis""*, në: René Wellek; Austin Warren, *Teoria e letërsisë*, përktheu: A. Myftiu, Onufri, Tiranë, 2007, f. 35.

poetik i sonetit janë të përshtatshëm që të përkapin dramacitetin. Kështu funksioni dëshmues i sonetit, veçan tek *L.B.*, përban plotsinë e pikëpamjes okulare. Kjo vepër përban risinë sonetore në traditën shqipe, siç thekson edhe Leka Ndoja: "*Libri i burgut, prishi rendin e poemave triumfale të sistemit letrar në Shqipëri e Kosovë*".[11] Kurse në raste të tjera, soneti (si tek *Lundërtarë* dhe *Autobiography*) funksionalizohet me pjekuninë relative të autorit. Pra, tek *Lundërtarë* kemi të bajmë me sonetet e para të Pipës: sprovat fillestare, ndërsa tek *Autobiography* kemi të bajmë me pjekuni të plotë artistike. Funksioni i përgjithshëm i sonetit, ndërkaq, lidhet me tematikat gjegjëse.

1.2.1. Sonet vs. tubë sonetore

Nga tanësia e soneteve, na rezulton se ciklet sonetore përbajnë numrin ma të madh të korpusit sonetik të Arshi Pipës. Kështu, sa i takon raportit numerik *sonet* vs. *tubë sonetore*, del se ndër 86 sonete (po të përfshijmë edhe sythin e varianteve në *Meridiana*), kemi të bajmë me 19 sonete (22%) dhe 67 sonete që përfshihen në cikle/tuba sonetore (78%).

Ky raport na tregon se autori, tematikës historike veçanërisht, kërkon t'i bashkëngjisë vijimsinë e mendimit. Pra kemi *Mbretin Labeat*/*Pleurat*, që shtjellohet në nji sasi sonetesh sikundërse ndodh edhe me *Giordano Bruno*-n, apo edhe me vetë *Kanalin*, që asht nji histori e persekutimit komunist. Kështu tematikat historike nuk mund të reduktohen apo kondensohen në nji sonet të vetëm. Zgjerimi poetik vjen si nevojë e brendshme autoriale për me detajue tharmin historik ose për me dhanë nji pasqyrë sa ma reale të burgut komunist. Fakti që tematikat historike shpalosen në tuba sonetore për letërsinë shqipe nuk asht i ri, sepse ma herët Dom Ndre Mjedja e ka elaborue këtë trajtë (*Lissus*, *Scodra*).

Në mbyllje të kësaj trajtese, konkludojmë se sonetet e A. Pipës kanë nji randësi të veçantë sa i takon vijimsisë së sonetimit shqip, por edhe të pasunisë organizative, strukturore të kësaj forme poetike. Mbi të gjitha sonetet e tij nisin nji tipologji të re në traditën shqipe: *sonetin testimonial*, tue denoncue kështu vuejtjet intelektuale e njerëzore në burgjet komuniste; dhe tue e renditë njikohësisht veprën *Libri i burgut* përkrah veprave të tjera me vlerë si *Rrno vetëm për me tregue* të At Zef Pllumit dhe *Burgjet e mia* të Dom Simon Jubanit.

11 Leka Ndoja, "Forma sonetike në poezinë e Arshi Pipës", në: *Si vdesin personazhet në letërsinë shqipe*, SA, 2013/2, viti XVIII, UT, FHF, f. 183.

Çezarin TOMA

Giuseppe Schirò e Luigi Pirandello: un'amicizia fraterna

Krijimet përrallore që na paraqet shkrimtari Teufik Gjyli, përfshijnë në thelbin e vet si elementin fantastik, si elementin mitik, si elementin realist, të cilët lidhin, ndërlidhin dhe zgjidhin pikat kryesore të rrëfimit

---

Edhe del me e kerkue të vorfnen, tue porositë kedohin me ba mirë.

Në të dytën pjesë keni për të pa Jetimen kah kujton mjerimin e vet, pse nuk i ka prindt per t'a ngushllue e të kujdesen për te, por i duhet me kerkue rrugat per me lypë nji kashatë buk e me bajtë të shamet, të përbuzunat e të rrahunat e fmive të kqi. Mjes ktij pikllimi, Drita, vajzë e urtë e zemerdhimshme e ngushllon tue thanë Jetimes: Dikur edhe per ty do t'agojë nji ditë e bardhë, e i bertet fmive. Deri nji rrugac ka dhimë per Jetimen, kuer e shef kte fjetë mbi nji gur në rrugë të madhe, e i falë çka ka.

Në pjesën e tretë keni per të pa se Plaku i a mbushë mendja t'a kerkojë at bi:

Qi nanë nuk ka, nuk ka as shpi,
Qi vlla nuk ka, nuk ka gjini.
Don qi doren me i a dhanun
E në rrugë të madhe mos me e lanun.
Don t'a marrë me vedi në shpi
Per t'a bamun vajzë në pleqni.

10 Panajoti, Jorgo: "Përralla popullore dhe fëmija", f. 34-35; nga libri: "Probleme të traditës dhe të aktualitetit në letërsinë tonë për fëmijë", Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1976.

dhe formojnë portretin e strukturës përrallore. Është kjo arsyeja që "Subjektet e këtyre përrallave zbulojnë tipare të njerëzve të thjeshtë të popullit, si ndershmërinë, zgjuarsinë, dashurinë dhe sinqeritetin midis tyre. Por, me gjithë përpunimin e kujdesshëm, ato nuk janë zhveshur plotësisht nga elementët idealistë që i ndeshim në përrallat popullore. Herë-herë idetë jepen hapur, me anë të sentencave. Sidoqoftë, përrallat e kësaj përmbledhjeje ("Trëndafili i artë", u botua më 1957 – nënvizimi i im Xh. B.) ruajnë bukurinë e tyre që u jep gjuha e krehur dhe përshkrimet tërheqëse." [11]

Mendimet e shprehura nga studiuesi Çadri, me të drejtë i krijojnë një vend të merituar përrallës së Teufik Gjylit që, në zanafillën e saj të krijimit paraqiti interes jo vetëm për ecurinë e kësaj gjinie, por edhe të rrugëtimit të vetë letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Kur flasim për rrugëtim, flasim për kontribute krijuesish edhe në këtë gjini. Shkrimtari Gjergj Vlashi, që e lëvroi këtë gjini jo pa sukses në një shkrim të tij thotë: "Nga e kaluara ne trashëgonim shumë pak përralla të kultivuara nga shkrimtarët, po nga ana tjetër trashëgonim një letërsi të pasur gojore me përralla të krijuara në vise dhe në kohë të ndryshme. Mjafton të shfletosh katër vëllimet e Prozës Popullore, - të botuara nga Instituti i Folklorit, dhe ato 488 përralla janë një pasuri e paçmuar, një burim frymëzimi dhe një shkollë e vërtetë mjeshtërie. Pikërisht motive të këtyre përrallave morën shkrimtarët tanë dhe i përpunuan. Kështu vepruan në mes të tjerëve shkrimtarët Dhimitër Pasko, Bedri Dedja, Kolë Jakova, Moisi Zaloshnja, Teufik Gjyli e ndonjë tjetër. Një pjesë prej tyre janë shkruar mirë, me gjuhë të pasur e të kulluar e me mjete shprehëse të goditura dhe kanë hyrë në fondin e artë të fabulistikës sonë të kultivuar."[12] Në vijim të mendimit për paragrafin e mësipërm, arsyetojmë: *Përrallës duhet t'ia njohim rrugën, zhvillimin dhe problematikat e saj. *Përralla mbart vulën e kohës kur u krijua. *Sikur ia ngushton 'shpirtin' kësaj gjinie kur thuhet: "... kanë hyrë në fondin e artë të të fabulistikës sonë të kultivuar". *Të mos harrojmë se, edhe emrat që përmend autori (të cilët edhe mund të shtoheshin, - nënvizimi im, - Xh. B.), në vetvete, në lëvrimin e përrallës ishin modele. Modele që ruanin tipare e veçanësi. Një i tillë ishte dhe Teufik Gjyli. Është kjo arsyeja që

11 Çadri, Prof. As. Dr. Ramazan : « Letërsia shqipe për fëmijë » (Probleme, autorë, vepra), Tiranë, SHBLSH, 2001, f. 113.

12 Vlashi, Gjergj: "Përralla ka vendin e vet në letërsinë për fëmijë", rev. Nëndori, 11/1970, f. 152.; "Përralla në letërsinë tonë për fëmijë", Drita, 01.11.1970.; "Përralla në letërsinë tone për fëmijë", Nëndori, botim i posaçëm.

Prof. Bedri Dedja konkludon në këtë mënyrë: "... një nga autorët e mirë që punuan për përrallën".

E, në këtë hulli, vlen të shënohen dhe dy vështrime. Kritiku Nikollaq Hanxhari thekson: "Mua më duket se një shembull të mirë për paraqitjen e idesë së luftës për çlirim e kanë trajtuar bukur dy nga krijimet tona të para të kësaj gjinie "Kacimicri" dhe "Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit".[13] Ndërsa shkrimtari Naum Prifti duke u ndalur tek vendi dhe koha në përrallat tonë (shqiptare) shenjon: "Edhe në vendin tonë lëvrimi i përrallës ka shkuar në rrugë pak a shumë të tillë, si në vendet e tjera, pra, nga folklori, te përralla e përpunuar, te krijimet origjinale. Veçse është për t'u vënë re se këto stade zhvillimi, ashtu si edhe në fusha të tjera letrare tek ne, u kaluan në periudha shumë të ngjeshura. Shkrimtarë si Zihni Sako, Kolë Jakova, Bedri Dedja, Teufik Gjyli bënë një punë shumë të dobishme e të lavdërueshme në fushën e përpunimit të përrallës, duke na dhënë një sërë krijimesh të bukura, me vlera artistike, të cilat jo vetëm ndihmuan për krijimin e një tradite të mirë e të shëndoshë, por edhe sot ruajnë vlera artistike."[14]

"Trëndafili i artë" përmban tetëmbëdhjetë përralla, legjenda dhe tregime për të vegjël. Në parathënien që kanë shkruar për lexuesit e vegjël redaktorët e librit, shkrimtarët e studiuesit Bedri Dedja e Nasho Jorgaqi, ndër të tjera thonë edhe këto fjalë: "... në këtë vëllim të ri, ju përsëri do të takoheni me heronjtë e përrallave tona popullore, do të njihni heroizmat, përpjekjen dhe luftën e tyre për një jetë më të lumtur, ... , luftën për të drejtën dhe të vërtetën, për lumtërinë dhe gëzimin. E patjetër, edhe këto përralla do t'i pëlqeni shumë. Autori i këtij libri, Teufik Gjyli, na ka thënë se këto përralla i ka pasë treguar një kopshtar dhe bahçevan plak. Dhe me të vërtetë, po të lexoni librin me vëmendje, ju do të vini re se aty ka edhe disa legjenda popullore mbi lulet, të cilat gjithashtu janë të bukura."

Duhet thënë që "Lëvrimi i gjerë i përrallës dhe i nënllojeve të saj, të cilat zinin pjesën më të madhe të botimeve për fëmijë (në këto vite që po flasim, - shënimi im Xh.B.) dhe në vitet që pasuan, dëshmonte për interesimin më të madh të shkrimtarëve për krijimtarinë popullore dhe për përpunimin artistik të saj. Disa prej tyre, si: Z. Sako, K. Jakova, T. Gjyli, S. Çomora, V. Bala, B. Dedja, S. Vaqari, O. Grillo, Gj. Zheji, M. Zaloshnja etj., duke u mbështetur në subjektet e njohura të përrallave popullore, hartuan krijime me të cilat bënë përpjekje për t'i pasuruar ato me elemente të reja, në përputhje me kërkesat e kohës. ... Përpunimi i përrallave popullore nga

13 Po aty, f. 141.
14 Po aty, f.161.

një numër i mirë shkrimtarësh shërbeu si një bazë e shëndoshë për krijimin e përrallës letrare për fëmijë. Ndihmesë e rëndësishme në këtë drejtim dhanë shkrimtarë, si: T. Gjyli, me novelën-përrallë "Kacimicri" (1954), B. Dedja, me novelën fantastike "Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit" (1956)... Mirëpo, shumica e përrallave që u shkruan në këtë periudhë, nuk arrinin nivelin e një krijimi të vërtetë artistik. Ato mbështeteshin në përpunime të thjeshta ose përsëritje të vargëzuara me figuracion të varfër të subjekteve të përrallave popullore."[15]

3.

Krijimtaria letrare e shkrimtarit Teufik Gjyli nuk është anashkaluar nga studiuesit e letrave shqipe për fëmijë. Realisht, më gjerë është folur për kohën kur autori krijonte e botonte. Pastaj, si për këtë autor, ashtu edhe për disa autorë të tjerë të këtij brezi që meritojnë vëmendje për kontributet letrare që kanë dhënë, kujtesa letrare fillon e zbehet... Edhe sot mungojnë studimet analitike dhe krahasuese. Për vlerën e këtij të fundit, studiuesi Shaban Sinani shkruan: "Krahasimet përgjithësisht provokojnë, cënojnë, përafrojnë e po aq mosbarazojnë. Por krahasimeve dhe metodës krahasuese, megjithëse moda mund t'u ketë shkuar, mundësitë nuk u kanë shterruar. Në filozofinë e botës së sotme është "të shohësh veten tek tjetri". Kjo filozofi është themeli i eurokulturës dhe eurocentrizmit."[16]

Përmes studimeve letrare (aq sa ishin) dhe shqyrtimeve të veprave të autorit në shtypin e revistat e kohës; kemi vrojtuar me vëmendje mënyrën se si është evidentuar, problematikat që janë cekur, këndi i shikimit dhe i trajtimit të krijimtarisë së këtij autori, etj., etj. Në ecurinë dhe në arritjet e këtyre studimeve, në zbërthimet dhe në konkluzionet për krijimtarinë dhe vlerat e saj të autorit Gjyli, mendojmë se nganjëherë trajtesat nuk janë dhe aq të thelluara. Na preokupon empirizmi problemor dhe historizmi si dukuri pranimore e diktuar nga koha. Gjithashtu na preokupon edhe shikimi i disa studiuesve se, krijimtarinë e autorit e kanë vendosur vetëm në rrafshin e traditës, aty e kanë qarkuar, aty e nënvizojnë, pa i dhënë një

15 Çadri, Prof. As. Dr. Ramazan : « Letërsia shqipe për fëmijë » (Probleme, autorë, vepra), Tiranë, SHBLSH, 2001. Kreu III, Procesi i formimit të letërsisë shqipe për fëmijë. -Letërsia shqipe për fëmijë në hapat e parë të formimit të saj (1945-1960)-, f. 86-87.

16 Sinani, Shaban: "Tradita gojore si etnotekst", (Studime për etno-folkloristikë krahasimtare), "Naimi" Shtëpi botuese dhe studio letrare, Tiranë, 2012; "Në vend të hyrjes", f. 5.

kapërcim të mëtejshëm në kohë.

Lënda përrallore që na la shkrimtari Teufik Gjyli, për vlerat njohëse, artistike e edukative që sjellin dhe flasin ato, mendojmë se e ka kapërcyer kohën kur u shkruan. Të jetuarit e veprës, ka qenë ndërmjet të tjerave edhe shtysa që më nxitën për t'u dhënë optikë tjetër leximi dhe rileximi krijimtarisë së këtij shkrimtari.

Studiuesi Ramazan Çadri, i shenjon si tipar themelor krijimtarisë së Teufik Gjylit, këtë fakt: "Ndihmesën më të madhe T. Gjyli e solli me përrallat e legjendat e bukura të frymëzuara nga motive popullore, përmbajtjen e të cilave autori e përpunoi me mjeshtëri në përputhje me kërkesat e moralit bashkëkohor, duke u dhënë atyre formën e krijimeve të mirëfillta artistike për të vegjëlit."[17]

Veprimtarinë letrare të këtij autori, me qëllime studimi e kanë parë disa autorë, si Hamid Boriçi, Bedri Dedja, Vehbi Bala, Nasho Jorgaqi, Gjergj Vlashi, Muharrem Xhaxho, etj., por në mënyrë të veçantë, të herë pas hershme e analitike është studiuar nga Profesor Doktor Jup Kastrati[18]

---

17 Çadri, Prof. As. Dr. Ramazan : « Letërsia shqipe për fëmijë » (Probleme, autorë, vepra), Tiranë, SHBLSH, 2001, f. 112.

18 Jup Kastrati ka lindur në qytetin e Shkodrës, më 15 prill 1924 dhe ka ndërruar jetë më 22 shtator 2003. Në qytetin e lindjes mbaroi arsimimin fillor. Më pas vazhdoi mësimet në Liceun Shkencor në Torino, "Galileo Ferraris", Convito Nazionale "Umberto I". Ndonëse ishte shumë i ri në kohën e pushtimit italian, si antifashist ka qenë i burgosur , i internuar në kampe përqendrimi, si në: "Comando Z", në burgun e Prizrenit, në Kodrat e Tepes, Shkodër, etj. Studimet e larta i ka kryer në Tiranë, në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Më pas, ndoqi kualifikimin shkencor pasuniversitar për gradën "Kanditat i shkencave filologjike", me studimin monografik dialektologjik "E folmja e Thethit" (1962), nën udhëheqjen shkencore të Prof. Eqrem Çabejt. Prof. Jup Kastrati është një nga themeluesit e Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës. Për rreth 50 vite ka qenë bashkëpunëtor shkencor, përgjegjës i rrethit letrar të shtëpisë së kulturës në Shkodër (1947-1957), Kryetar i Këshillit të Bibliotekës së Qytetit (1948-1990), anëtar i këshillit shkencor të rrethit të Shkodrës (1988), kryetar i komitetit të kulturës dhe arteve në Shkodër (1989) etj. Ai ishte një ndër themeluesit dhe drejtuesit e revistave shkencore "Buletini i Shkodrës" dhe "Shkodra", etj. Gjatë viteve të punës shkencore është nderuar me disa tituj, si: "Arsimtar i dalluar" (1954). Medalja e Punës (1959), Urdhri "Naim Frashëri i Klasit të Dytë" (1970), "Mësues i Popullit" (më 1987). Është pjesë e Enciklopedisë Ndërkombëtare të Biografive, Edicioni i Trembëdhjetë i Intelektualëve Botërorë (Kembrixh, dhjetor 1977). Ka marrë titullin e lartë "Mjeshtër i Madh i Punës", nga Presidenti i Republikës. Nuk kishte si të mos e respektonte qyteti i tij këtë figurë shumëplanëshe, duke e shpallur "Qytetar Nderi" i Shkodrës. Firmën e profesor Kastratit e kanë rreth 40 vepra të botuara e të ribotuara në një hark kohor

e më pas nga Prof. as. Dr. Astrit Bishqemi e Prof. as. Dr. Ramazan Çadri. I përmenda këta tre studiues si në veçanti, për të thënë se gjykimet e tyre studimore paraqesin interes, vërtetësi dhe konkluzione shkencore të drejta lidhur me interpretimin e dukurive të përrallës që solli në letërsinë shqipe për fëmijë e të rinj shkrimtari Teufik Gjyli.

Studimet e Profesor Doktor Jup Kastratit të botuara në gazetat "Drita", "Puna", almanakun "Shkodra"-1961, në "Simpoziumi i parë kombëtar për problemet e letërsisë për fëmijë" (Tiranë, 27-28 maj 1974, faqe 66), flasin për një njohje të thelluar, të detajuar, gjykim prej eruditi dhe albanologu, prej bibliografi dhe shkencëtari. Të gjitha shqyrtimet, rrafshet apo këndet se si e ka parë Profesor Kastrati krijimtarinë e Teufik Gjylit në gjininë e përrallës, gjithherë është bashkëshoqëruar me një pasuri bibliografike të plotë e përkushtuese, të lakmueshme e të admirueshme.

Mendimet e studiuesve, emrat e të cilëve i shënuam më sipër, për shkrimtarin Teufik Gjyli reflektojnë në dy vatra.

Vatra e parë udhëhiqet nga mendimi i studiuesit Vehbi Bala, që thotë: "Studimi i traditës së re do të nxjerr në shesh meritën e shkrimtarëve Q. Guranjaku, Z. Sako, D. Siliqi, S. Çomora, K. Jakova, H. Stërmilli, **T. Gjyli**… që të parët iu vunë krijimit të letërsisë së re shqiptare për fëmijë pas çlirimit të atdheut".[19]

Vatra e dytë mbart mendimin e shkrimtarit Bedri Dedja, i cili vë theksin, se: "Në këtë periudhë (është fjala për vitet 1949 - 1954, - nënvizimi im, Xh. B.) aktivizohen mbi dymbëdhjetë shkrimtarë në fushën e letërsisë për fëmijë dhe krijohen vepra të tilla, pa të cilat nuk mund të përfytyrohen fillimet e letërsisë shqipe… për të vegjëlit, siç janë librat: "Tetë ditë pa bukë", "Foleja e dallëndyshes", "Shkolla jonë", "Zgjimi i pranverës", "Zemër shqiptare", "**Kacamicrri**", "Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit", "Na hoqën çatinë", "Përrallëza e gjëza" …" [20]

Të dy këto vatra-mendimesh të mbledhura së bashku plotësojnë më dukshëm e më thellë portretin e këtij shkrimtari. Mendojmë, se ata prekin

---

prej më shumë se 40 vjetësh. Si më të rëndësishmet janë: "Historia e Gramatologjisë shqiptare" (1635-1944), "Faik Konica" (monografi), 1995; "Studime për De Radën" (monografi), 1999; "Studime arbëreshe" (monografi), 1999; "Historia e albanologjisë" (1497-1997), etj.

19 Bala, Vehbi: "Probleme të studimit të traditës së re të letërsisë sonë të sotme për fëmijë", f. 39., Simpoziumi i parë kombëtar për problemet e letërsisë për fëmijë", Tiranë, 27-28 maj 1974, Naim Frashëri, Tiranë, 1975.

20 Dedja, Bedri: "Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë", Tiranë, 1971.

më shumë të jetuarin e tij në një cak kohor si krijues e si pastrues i traditës së letërsisë për fëmijë e të rinj. Ndaj, e ndiejmë të nevojshme të pohojmë se, marrëdhëniet e shkrimtarit veçanërisht me përrallën që e kishte "dobësi" kërkojnë një vizion gjykimi dhe interpretimi të mëtejshëm.

Teufik Gjyli, si krijues, lëvroi disa gjini e zhanre letrare, si: fabulën në vargje, apologun, tregimin e shkurtër, kallëzimin apo rrëfenjën, novelën e gjatë, skeçin, dramën, melodramën, skicën, vizatimin letrar, reportazhin, artikullin; por talenti i tij u shqua, shkëlqeu dhe shëtiti në universin e përrallës, ku dhe mbeti përrallëtar. Te kjo gjini shfaqen e përftohen dukuri e cilësi të personalitetit të tij krijues, të cilat na ofrojnë mendimin se Teufik Gjyli e njeh mirë botën e përrallave dhe në veçanti përrallën popullore, hapësirën, domethënien, ngjyrat, karakteristikat, idetë universale dhe kodet e saj. Është i drejtë pohimi për këtë shkrimtar, kur thuhet se: "Teufik Gjyli është bërë i njohur, përveç të tjerave, si autori i dy prej personazheve më të njohur, më popullorë e më të realizuar në krijimtarinë e tij, por edhe në letërsinë tonë për fëmijë, siç janë Kacimicrri dhe Piciruku, dy figura tërheqëse dhe mjaft simpatike për lexuesit e vegjël, i pari trajtuar te përrallat dhe i dyti tek tregimet e tij."[21]

Përmendja e veprës realiste me titullin "Piciruku" na shpie në një kohë botimi, ku edhe gjinia e tregimit kishte problemet e saj. Kritiku Muharrem Xhaxho paraqet këtë tablo: "Tregimi ynë për fëmijë në vitet e para pas çlirimit u përfaqësua nga shkrimtarë të rinj, shumica ish pjesëmarrës të Luftës Nacionalçlirimtare, si: Zihni Sako, Fatmir Gjata, Moisi Zaloshnja, Kolë jakova, dhe nga shkrimtarë të tjerë, si Sterjo Spasse, Teufik Gjyli, etj. ... Ajo që na dhanë në veprat e tyre këta shkrimtarë kontribuoi drejtpërpërdrejt në formimin e një tradite të shëndoshë në gjininë e tregimit për fëmijë."[22]

Duke vazhduar në plotësimin e figurës së shkrimtarit Teufik Gjyli, themi se ai lëvroi: përrallën, fabulën në vargje, apologun, tregimin e shkurtër, kallëzimin apo rrëfenjën, novelën e gjatë, melodramën, skicën, vizatimin letrar, reportazhin, artikullin, etj. Dhe... duke u fokusuar më shumë te gjinia e përrallës, pohojmë se, merita e tij (Teufik Gjylit, nënvizimi im, - Xh.B.) qëndron në faktin se ai e zhveshi përrallën nga koncepti i vjetër dhe, e mveshi me interpretim të ri. Autori krijoi një traditë të re, duke u mbështetur fuqimisht në prozën popullore shqiptare.

21 Nelaj, Milaim: "Teufik Gjyli – një themelues i Letërsisë së re për fëmijë", Telegraf, 12.03.2010.

22 Xhaxho, Muharrem: "Mbi disa probleme të tregimit tonë për fëmijë", gaz. Drita, 01.09.1974.

Dhe në nderim të Prof. Dr. Jup Kastratit, po edhe në qasje të vlerave të autorit Gjyli, po sjellim një analizë të veprës "Kacimicri", mbase nga gjykimet e para të Profesorit. Profesor Kastrati shkruan: "Kacimicrri", i cili ishte (kaq) i vogël..., por asgjë s'e ndalonte atë të bëjë punë e trimëri të mëdha" – shkruan autori në hyrje, duke iu drejtuar fëmijëve. "E dëftojnë përrallat plak pas plaku dhe brez pas brezi. Ai ishte aq i zoti, sa ndihmonte plakun në arë, plakën në kasolle, ..." – vazhdon autori në parathënie. "Na ishte njëherë një plak e një plakë". Kështu fillon vepra e Teufikut. Kështu fillojnë të gjitha përrallat tona popullore. Dhe më duket se këtu qëndron merita e parë dhe kryesore e autorit tonë: tek frymëzimi që ai ka gjetur nga Visari ynë popullor. Këtu duhet kërkuar edhe suksesi i librit. Fryma popullore e përshkon veprën tejpërtej, fillim e mbarim. Ne ndeshemi rrugës me personazhe të njohura të përrallave tona aq të bukura. Ne humbasim në në botën e imagjinatës dhe të fantazisë së krijimeve të gjeniut tonë popullor. Ne flasim me gjuhën e thjeshtë dhe të pastër, por të pasur të popullit tonë mijëvjeçar. Teufik Gjyli ka pasur sens narracioni. Por vepra të pëlqen më tepër edhe për kompozicionin e saj. Pas një hyrjeje, drejtuar fëmijëve nga ana e autorit, të ndjekin 12 tregime të ndryshme. Që të gjitha këto lidhen ndërmjet tyre me anë të personazhit kryesore, Kacimicrrit. Ky është në qendër të të gjitha ngjarjeve."

Po cila është 'harta' e këtij personazhi, që quhet Kacimicër?

* Dashuria për punën. (Punët që bën brenda dhe jashtë shtëpisë janë të shumta.)

* Është i zgjuar.

* Është i shkathët.

* Nëpërmjet intiligjencies di të dalë nga situata, edhe kur ajo është e vështirë.

* Shpëton Vraposhin.

* Di ta përshtatë gjuhën dhe të sjellurin me personazhin që zhvillon dialog.

* Nderon dhe respekton të moshuarit.

* Kacimicri është i prirur drejt Mirësisë.

4.

Edhe sot lexohen me ëndje libra, si: "Kacimicrri" (një novelë-përrallë, ku figura kryesore është huazuar nga letërsia gojore, por me një këndvështrim të ri: në përpjekjet e tij për të luftuar drejt së mirës, e në këtë luftë aventura e bashkëshoqëron heroin në realizimin e qëllimeve të mira,

të virtytshme e me vlera fisnike. Siç thotë Prof. Dr. Jup Kastrati : « … emën të mirë ai fitoi që me librin « Kacamicrri », të cilin e pat nisë që më 1934 dhe botue përfundimisht në vitin 1954 nga N.Sh.B. (152 faqe). » [23] dhe më tej … « Kacimicrri qe novela e parë e gjatë për fëmijë, që u botua në vendin tonë. Ajo e popullarizoi shumë autorin. Me të Teufik Gjyli u fut një herë e përgjithmonë në letërsinë shqipe si shkrimtar i letërsisë për fëmijë. Dhe hyri me një vepër madhore për të vegjëlit. »[24]

Kacamicrri me të gjithë versionet e emrit të tij është një figurë tipike, e njohur dhe interesante në folkloristikën tonë. Është një figurë e dashur popullore, sepse populli në krijimtarinë e tij përrallore e gdhendi me dashuri. Po me dashuri e gdhendi edhe në novelën e tij me të njëjtin emër edhe shkrimtari Teufik Gjyli.

Autori ruajti të njëjtën marrëdhënie me këtë personazh të krijuar nga populli. E mori të gatshëm si personazh, pa vënë « dorë » mbi të. Ruajti lindjen e tij, koncepti zhvillues e përfytyrues, funksionet, pra: « ... bën trimëri, ballafaqohet me kundërshtarë, i mposht dhe vazhdon veprimin. »[25] Kjo « paprekje » dhe ruajtje e identitetit të personazhit shfaqet edhe në titull, edhe në përmbajtjen që fshihet brenda librit, sigurisht, për të zgjuar kërshërinë e lexuesve të vegjël.

Një tipar tjetër i përbashkët është se personazhin, si në përrallën popullore ashtu edhe në krijimin artistik, e gjejmë: « 1.Kur fushëveprimi i përgjigjet personazhit, 2. Kur një personazh i përfshin disa fushëveprime. »[26] Dhe për ta përmbyllur këtë marrëdhënie, shënojmë se : « Tiparet e veçoritë e personazheve tregohen nëpërmjet aksionit dhe aventurave. »[27] dhe « Heroi i përrallës kur nis rrugën e shtegtim it-aventurave, gjithnjë e zgjedh rrugën e rreziqeve… »[28]

Kacamicrri është një personazh, ku elementi fantastik zë fill që në lindjen e këtij fëmije kaq të vockël. Te kjo figurë, e pabesueshmja bëhet e besueshme, e besueshmja bëhet e pabesueshme, e jashtëzakonshmja bëhet e zakonshme, e zakonshmja bëhet e jashtëzakonshme. Shkrimtari Teufik

23 Kastrati, Jup: « Shkrimtari i Letërsisë për fëmijë », Puna, 7.06.1963

24 Kastrati, Jup: "Mbi kontributin e Teufik Gjylit në letërsinë për fëmijë", f. 65 – 66., Simpoziumi i parë kombëtar për problemet e letërsisë për fëmijë", Tiranë, 27-28 maj 1974, Naim Frashëri, Tiranë, 1975.

25 Mustafa, Dr. Myzafere : « Përralla shqiptare » -poetika dhe mitikja-, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2003. ; 3. Veçoritë e botës së përrallës, f.19.

26 Po aty, f. 28.

27 Po aty, 3. Dialogu, f. 269.

28 Po aty.

Gjyli mbeti « fanatik » i këtij personazhi të krijuar më parë nga letërsia popullore. Si i tillë ruajti të njëjtin linjë personazh, edhe në atë që kërkonte të nënvizonte populli, se është zgjuarsia, trimëria dhe virtytet e tjera që vendosin dhe jo forca fizike dhe përpjestimet e mëdha trupore. Me një modulim të tillë e mori këtë personazh Teufik Gjyli dhe e shpërfaqi bukur artistikisht në një realitet të caktuar kohor, ku fëmijët nuk e kanë të vështirë të njihen me heroizmat dhe përpjekjet e tij në favor të së mirës dhe të së drejtës. Kështu duhet ta pranojmë Kacamicrrin e Teufik Gjylit, sepse ky është i mirëpranuar më parë si personazh i krijuar nga populli. S'mund t'i ofrojmë atij asnjë lloj « biografie » tjetër, veç asaj që ai e ka në të vërtetë që në lindjen e tij. Për këtë arsye ne nuk mund të pajtohemi me koncepte të tilla të hamendësuara, si këto që janë shfaqur vite me parë në shtyp, si: « Kacamicri është në përgjithësi një personazh pozitiv… »,[29] ose « Pra, ai ka elementë pozitivë… »[30] ose me një gjykim të tillë që shpreh pavërtetësinë e funksionit real e kohor të këtij personazhi, si këtë që po citojmë : « Po është krejt e gabuar që duke e marrë këtë personazh si krijim të një rendit të vjetër shoqëror, fisnor ose patriarkal, të vihet ky në po këto rrethana e si mishërim i idealizuar i rendit dhe i zakoneve të mykura patriarkale. Autori që shkruan një vepër të tillë, nuk e shikon traditën popullore me syrin e njeriut të kohës sonë, me tendenciozitetin klasor revolucionar, prandaj një vepër e tillë bie në kosh, për arkaizmin, tradicionalizmin e vet. »[31]

Një vështrim tjetër gjejmë te studiuesi Ramazan Çadri. Ai e cilëson si veprën më dinjitoze të autorit, dhe që përshkohet nga fryma popullore. Tjetër cilësim: Nëpërmjet episodeve interesante gërshetohet natyrshëm realja me fantastiken, veprimi dinamik me përshkrimin lakonik të mjedisit e të natyrës. Tjetër cilësim: Konflikti është pasqyruar me vërtetësi. Tjetër cilësim: Në karakterin e tij (është fjala për Kacimicrin, - nënvizimi im Xh. B.) autori ka mishëruar cilësitë më të mira të popullit, shpirtin heroik, dashurinë për punën, zgjuarsinë, shkathtësinë, kujdesin për të moshuarit dhe të vuajturit, përkrahjen për të drejtën, qëndrimin e papajtueshëm ndaj hipokrizisë, intrigave dhe poshtërsive… … Këto cilësi të heroit zbulohen në mënyrë graduale e të natyrshme, nëpërmjet veprimit të gjallë e situatave tërheqëse dhe në lidhje me personazhet e tjera, që mishërojnë kryesisht karaktere njerëzish të varfër, por të ndershëm e me zemër të pastër. Tjetër cilësim: Me idetë e shëndosha që përçon, novela-përrallë « Kacimicri » e

29 X. Dh.: "Mbi disa problem të letërsisë për fëmijë", Zëri i Rinisë, 16. 03. 1968.
30 Po aty.
31 Po aty.

T. Gjylit, i edukon të vegjlit që të duan e të përkrahintë mirën e të drejtën, të luftojnë të keqen, të vjetëruarën, padrejtësinë shoqërore. Tjetër cilësim: Novela karakterizohet nga disa veçori artistike, siç janë : *paraqitja me gjallëri artistike e mjediseve përrallore. *përdorimi me shkathtësi eme vend i elementit fantastik dhe i imtësive shprehëse për karakterizimin e personazheve. *figuracioni i pasur. *rrëfimi i rrjedhshëm. *përshkrimet e bukura dhe tërheqëse.

Duhet thënë se, për nga nga materiali tekstor, e afërt me novelën-përrallë « Kacimicri », është përralla në vargje « Veriu dhe bora », si dhe përrallat e përmbledhjes « Trëndafili i artë », disa prej të cilave bëjnë pjesë ndër krijimet e para të autorit, port ë përpunuara prej tij me vonë. Në to ndeshen mjaft nga personazhet e përrallave tona popullore, përfaqësues të shtresave të varfra të popullit, skamnorët dhe të shtypurit, që kryejnë vepra të guximshme kundër shpirtligësisë, kopracisë, egërsisë dhe babëzitjes së mbretërve dhe agallarëve, për triumfin e të drejtës dhe të vërtetës.

Subjektet e këtyre përrallave zbulojnë tipare të njerëzve të thjeshtë të popullit, si : ndershmërinë, zgjuarsinë, dashurinë dhe sinqeritetin midis tyre.

Në të njëjtën mënyrë, në përrallën « Veriu dhe bora », nëpërmjet krijimit të pamjeve tërheqëse, poetike e të bukura, tregohet për solidaritetin midis forcave të së mirës, që gjen shprehje në përkujdesjet e tyre për Zogën e vogël e të urtë, e cila mishëron cilësitë më të mira të njeriut të thjeshtë të popullit dhe, në anën tjetër, vihet në dukje grindja, smira dhe përçarja që zotëron midis forcave që mishërojnë të keqen. Përralla paraqet tablo reale e fantastike, të përshkruara bukur përmes detajeve poetike, që mendojmë se autori, në natyrën e krijimtarisë së tij, i ka për zemër.

Duke folur për veçoritë e kësaj përralle në vargje, studiuesi Astrit Bishqemi shenjon: *Edhe kjo pjesë teatrore e Teufik Gjylit e merr temën nga një përrallë dhe të kujton Kësulkuqen. Edhe këtu kemi një vajzë malësore 10-12 vjeçe, Zogën, e cila ka marrë rrugën me shportë në dorë.

* Veç animizimit e personifikimit, përdoret edhe elementi i mrekullishëm : Bora ngre në çast pallate prej mermeri në vend të kasolleve.

* Edhe miqtë e dy luftëtarëve janë simbolikë. Veriu e shoqëron Ujku grykës, i cili është jo vetëm gjakpirës, po edhe e tradhton menjëherë të zotin, madje, kur e sheh Veriun të ngrirë, i ngul dhëmbët e i rrëmben edhe krahun. Përkundrazi, Borën e shoqëron Viti i Ri, gjë që do të thotë se koha

punon për të mirën, e ardhmja i takon asaj, Mirësisë.[32]

Edhe dy veprat e tjera me përralla "Trëndafili i artë" e "Vjollca e kujtimit", mbështeten po në thesarin popullor, ku shquhen: veçoritë e botës përrallore, përdorimi i drejtë i simbolikës, i raportit të fantastikes me realen, i raportit si ngjarje ndërlidhëse të përrallës, mitit dhe gojëdhënës, të strukturave të njohura kompozicionale, të funksioneve të personazheve, si dhe trajtimi shumëngjyrësh i subjektit lirik.

5.

Nuk është e vështirë të dallosh veçantitë e mënyrës së të rrëfyerit të Teufik Gjylit në librin e tij "Vjollca e kujtimit"[33], që mendojmë se është më i arriri në vlerat artistike. Një rrëfim që njeh psikologjinë e moshës së cilës i drejtohet. Si i tillë ai bart emocion, lirizëm, ngrohtësi, me strukturë mbi modele e skema, të cilat i kanë përkatësisht përrallat tona popullore. Autori i njeh mirë ato, veçanërisht larminë ndërtimore të tyre, të cilat kanë reflektuar qartazi në krijimtarinë e tij. Por shkrimtari nuk ka mbetur besnik i atyre kornizave, që e kanë shoqëruar në fillesat e krijimtarisë së tij. Një thyerje kornize tip klishe është edhe mënyra e të rrëfyerit.

Në krijimet e librit "Vjollca e kujtimeve" autori mbart njëlloj si te përrallat popullore, formulat hyrëse, të cilat "... kanë rolin e sinjaleve të veçanta që tregojnë se nga të folurit e zakonshëm kalohet në rrëfim të organizuar artistik".[34]

Sipas studiuesit Val Cordum formula "**"Ka qenë një herë..."** shënon ekzistencën e një sistemi tradicional..." Një dukuri e tillë është evidente në krijimtarinë e shkrimtarit dhe lë shenja të dukshme, veçanërisht në librin "Vjollca e kujtimit". S'mund t'i kuptosh këto krijime, pa të tilla poliforma hyrëse, të cilat bartin një cak kohor.

Më konkretisht po japim disa prej tyre, të cilat shprehin secila në mënyrën e vet marrëdhëniet e komunikimit, praninë e kohës shpesh herë si një nocion abstrakt e pa dimension kohor të zhvillimit të ngjarjes: *"Jetonte në kohë shumë të vjetra një mbret". ("Përdredhsa") *"Rriteshin ndër ato kohë të lashta – si i thonë të vjetrit – gjithë këto lule vathe tejet

32 Bishqemi, Prof. as. Dr. Astrit: Histori e Letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj, Botim i katërt, i rishikuar dhe i pasuruar, SHBLSH e RE, Tiranë 2014, Veriu dhe Bora (1959), f. 501, 503.

33 Botim i Sh. B. "Camaj-Pipa, Shkodër, 1999.

34 Mustafa, Dr. Myzafere : « Përralla shqiptare » -poetika dhe mitikja-, f. 248, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2003.

krenare mbi bisqe të vjetra…". ("Lulevathe") *"Një herë – ndër kohë shumë të lashta - …". (Lulekurpna") *Na ishte njiherë një pasanik, i cili kishte shtatë djem e një vajzë të vetme". ("Lavanda") *"Na ishte njiherë një shpirt i keq". ("Vjollca e kujtimit") *"Motit – në një krahinë – jetonte një vajzë shumë e hieshme". ("Lulesansa")

Ndërsa te novela "Kacimicrri" (1954), heroi kryesor i veprës simbolizon njeriun e punës dhe të vullnetit, njeriun e sakrificës dhe të mirëbërësit për të mirën e të tjerëve. Ai i frymëzon fëmijët për ndërmarrje fisnike, i bën të vegjlit të jenë të fortë, guximtarë, trima, luftëtarë të paepur për çështjen e së drejtës dhe të së mirës. Edhe te ky krijim gjejmë poliforma hyrëse, të cilat janë të ngjashme me ato të përrallave të këtij autori, por që ruajnë e flasin për një element tradicional të komunikimit të përrallës si vjetërsi moshe. Po sjellim si shembuj: * "Na ishte njëherë një plak e një plakë". (Kështu fillon vepra e shkrimtarit Teufik Gjyli). Kurse te përralla: "Dhelpna e argjantë"[35] "diktojmë": * "Na ishte një herë një gjuetar." (faqe 119), * "Një ditë prej ditësh..." (faqe 119).

Disa nga këto modele formulash hyrëse që paraqita më lart e, që shumë të tjera gjenden në përrallat e shkrimtarit, janë "shenja" që na tregojnë se kështu fillojnë përrallat tona popullore. Krahas këtij elementi njohës, te Gjyli në të shumtën e rasteve kanë dhe funksionin e mënyrës së prezantimit të personazheve, të rolit të tyre që luajnë në përrallë.

Kjo dukuri nuk është vetëm te Gjyli, por te të gjithë shkrimtarët e plejadës së tij që lëvrojnë gjininë e përrallës, e, që gjejnë frymëzim e mbështetje te thesari ynë popullor.

6.

Novela-përrallë "Dhelpna e argjantë" bën pjesë në krijimtarinë e shkrimtarit Teufik Gjyli. Ndryshe nga një pjesë e lëndës krijuese, ky krijim ka pasur një zbehtësi shqyrtimi në përkatësinë e vlerave që mbart. Për këtë novelë-përrallë është dhënë ky mendim, i shprehur në këtë mënyrë: "Në mjaft vepra për fëmijë përrallat nuk shfrytëzohen drejt dhe nuk i përgjigjen aktualitetit. Nuk është aspak aktual ribotimi i përrallës nga "Dhelpra e argjantë" e Teufik Gjylit, ku na paraqitet një mbret i mirë, por me një vezir të keq. Mbreti qe i mirë dhe kishte asnjë faj për vuajtjet e popullit. Fajtor për të gjitha qe veziri. Me zhdukjen e tij çdo gjë filloi të shkonte sa më mirë në këtë mbretëri. Ky është morali i fabulës. Me këtë moral nuk

35 Gjyli, Teufik: « Dhelpna e argjantë» (përrallë), botuar në Almanakun « Shkodra » (Viti I, 1961,Nr.1) f. 119 – 130.

mund të jesh dakort. Ai është i dëmshëm për fëmijët tanë. Nuk i mëson të urrejnë deri në fund klasat shfrytëzuese. Po aq të panevojshme janë edhe ato legjendat, të cilat fshehin në vetvete veshjen mistike, jo shkencore, si vihet re kjo p.sh. te "Sheboja" e po këtij autori, e botuar, ashtu si e parë, në librin "Tregime të zgjedhura". ... Por shkrimtarët që shkruajnë për fëmijë duhet të kenë shumë kujdes në zgjedhjen e përrallave dhe në përpunimin e tyre. Në radhë të parë duhet parë se sa ato tingëllojnë aktuale, se sa ato i përgjigjen kërkesave aktuale të edukimit të fëmijëve tanë."[36]

Nuk është e vështirë të kuptosh qëndrimin e studiuesit ndaj këtyre dy krijimeve. Më parë se marrëdhënia me letërsinë artistike të kohës, ai ka vendosur një marrëdhënie me sistemin e kohës soc-realiste. Atë ka busull orientuese dhe busull vepruese dhe zbatuese. Mbi bazën e kësaj filozofie gjykon, interpreton veprat artistike, vlerat dhe moralin e tyre. Ky qëndrim, i cili s'mund të jetë jashtë këtij sistemi, mbahet edhe ndaj kësaj pjese të krijimtarisë së shkrimtarit Teufik Gjyli.

Në mënyrë sintetike po japim edhe një herë argumentet që shtron studiuesi V. K. në mbrojtje të realitetit socialist:

* Krijimet nuk i përgjigjen stadit dhe zhvillimit aktual të realitetit.
* Nuk është aspak aktual ribotimi i këtyre dy krijimeve.
* Nuk është dakort me moralin e fabulës "Dhelpra e argjantë".
* Përralla "Sheboja" ka veshje mistike, jo shkencore.
* Duhet të zgjedhim përrallat popullore dhe mënyrën e përpunimit të tyre.

Dhe duke shkuar deri në ekstremin e alogjikes artistike e perceptimit deri-diku jonjerëzor, studiuesi i cakton vetes të rreshtohet në atë pjesë të kritikës: "... e cila bazën e vet e ka pasur në imitimin nga importi i doktrinës zhdanoviste, që ishte shndërruar në platformë zyrtare në letërsinë shqiptare që krijohej në Shqipëri, lidhjen me realitetin e shihte si një kërkesë për zbatimin e së njëjtës doktrinim, në letërsinë e këtij krahu."[37]

Studiuesi V. K., duke gjykuar në këtë mënyrë, mendojmë se, nuk njeh si proces krijimtarinë në gjininë e përrallës të shkrimtarit Teufik Gjyli. Më tej, do të thoshim, nuk njeh cilësitë, veçoritë dhe tiparet e këtyre përrallave; karakteristikat e kësaj përralle të kultivuar dhe marrëdhëniet e saj me përrallën popullore, në ç'raporte është dhe si është ky raport

36 V. K.: "Aktualiteti dhe letërsia për fëmijë dhe të rinj", gazeta "Zëri i Rinisë", 22.02. 1967.

37 Musliu, Ramadan: "Tangjentat letrare", Kritikë, Elta Bs, Prishtinë, 2011., Parathënie, f. 8.

gjatë përpunimit përrallor. Së fundi nuk njeh konceptet estetike të gjinisë së përrallës dhe në veçanti të konfiguracionit të përrallës gjyliane, sepse nuk përmend asnjëherë ndikimin e vlerave të saj ("Dhelpra e argjantë", - nënvizimi i im) në opusin përrallor të autorit. Edhe pse i ndan një hapësirë kohore, është e rëndësishme të shikohet kjo vepër në marrëdhënie me "Kacimicrrin" brenda procesit krijues të shkrimtarit, pasi, që të dy këto vepra kanë pothuaj të njëjtën mënyrë rrëfimi, stil e gjuhë artistike.

Tani po zbërthejmë disa tipareve të këtyre dy krijimeve.

Po të njihte sadopak krijimtarinë përrallore të Teufik Gjylit, studiuesi do të kuptonte sadopak natyrën e saj, metodologjinë, morfologjinë dhe mënyrat e rrëfimit. Do të kuptonte se autori Gjyli krijon një përrallë ku vështrimi i tij është universal si vetë gjinia, po edhe universale janë mesazhet që përçon në këto përralla, pa përjashtuar edhe këto dy krijime. "E mira lufton të keqen dhe triumfon mbi të", "E drejta lufton të padrejtën dhe triumfon mbi të" etj., qëndron në themel të krijimtarisë së Teufik Gjylit. Duke i sjellë artistikisht e me nivel në kohë, ato janë aktuale dhe i përgjigjen aktualitetit; pa thënë se ky përrallëtar është mjeshtër në përpunimin e përrallës popullore.

Personazhi kryesor i novelës-përrallë "Dhelpra e argjantë" është Ko-ko-ja. Për këtë personazh ka një përkujdesje dashurie prej shkrimtari. Një të tillë përkujdesje e pati për personazhin me emrin Kacamicrri. Po i përmend se ata "njihen" përmes krijimtarisë së autorit. Kanë pothuajse të njëjtat plane konceptimi e krijimi, si: në ndërtimin arkitekturor të përrallës, në ec e jaket çudibërëse të aventurës e bëmave, të skalitjeve të personazheve, etj. Te ky krijim ngjarjet zhvillohet në një largësi më të madhe kohore sesa te "Kacamicrri".

Ko-ko-ja është një model personazhi i nxjerrë nga visaret e popullit, nga urtësia, zgjuarsia e mençuria e tij. Hera-herë të kujton vetë Kacamicrrin. Me të njëjtin imazh, do të thosha, është konceptuar e shkruar dhe përkushtimi. Jo më kot autori thotë që në fillim të krijimit të tij: "Unë kam një shok. Emnin e ka Ko – Ko."

Nocioni i së "moçmes" në përrallë, gjithashtu, është në natyrën krijuese të autorit. E gjejmë edhe në këtë përkushtim. Përrallëtari thotë: "... gjyshi i tij ka jetue shumë dhe ka vdesë 103 vjeç. Ko – Ko ka qenë 10 vjeç kur e ka pasë ndëgjue këte përrallë nga gjyshi i tij. Një natë dimni ai ma tregoi mue dhe unë sot po jua rrëfej ashtu si e kam ndëgjue prej goje së tij...".

Teoria e **"shtegtimit në brezni"** e përrallës, pra brenda një qerthulli,

si subjekt, mesazh e personazh, gjithashtu zë vend në krijimtarinë e autorit dhe në rastin konkret, është një refleks nga vetë subjekti i përrallës "Dhelpna e argjantë", në të cilën gjuetari (babai) vdes që në fillim të ngjarjes, duke i dhënë mundësi të birit "t'i marr hakun", duke realizuar kështu amanetin, e njëkohësisht duke e bërë protagonist e hero të përrallës, triumfues i së mirës. Nga pikëpamja kohore dhe e viteve të përrallës, prania e djalit si personazh afron kohën dhe vitet (ik nga koha dhe vitet e babait), i bën më të perceptueshme dhe më realiste, larg legjendarizimit. Rrugën plot peripeci e aventura e shoqëron si një bashkudhëtar edhe përshkrimi, që mendojmë se shërben si "parathënie" dhe "mantel" për personazhet që veprojnë në këtë përrallë të gjatë, e cila edhe kjo nuk përjashtohet nga "injektimi" nga "tharmi" i përrallave tona popullore, ku struktura, mesazhi dhe filozofia nuk janë vështirë të mos duken.

Duke iu sjell edhe një herë sintagmës që përmend studiuesi: "... **ku na paraqitet një mbret i mirë, por me një vezir të keq",** novela-përrallë nuk i ka këto dy personazhe kryesorë, por është Ko-Ko-ja heroi që mbart gjithë ngjarjet që pasqyrohen në vepër.

Si Kacamicrri ashtu dhe Ko-Ko-ja, duke i parë si personazh në thellësi të botës që shpalosin dhe të veprimeve që bëjnë, të akteve që kryejnë dhe të mesazheve që përçojnë, në thelb kanë "biografinë" e personazheve realistë. Dhe për një moment sikur ofrojnë me tregimet popullore realiste. Por, kur ato hyjnë në marrëdhënie me përrallën dhe humbasin në "detin" e saj, duan apo s'duan veshin kostumin e saj përrallor që u rri hijshëm e plot nur-drite. Me të drejtë studiuesi Agron Xhagolli thotë: "Karakteristikë kryesore e këtyre përrallave është dhënia e elementit aventuror në kufijtë e së mundshmes. Pra, ato përralla (novelistike, - shënim i im Xh. B.) kanë një karakter aventuror, i cili shprehet në kalimin e personazhit kryesor në një varg aventurash të papritura."[38]

Ndërsa përralla "Sheboja", mendojmë se, nuk ka veshje mistike. Kjo përrallë zë vend si motrat e saj tek zhanri i përrallës floreale, ku autori i këtyre radhëve ka folur gjatë në këtë shkrim dhe ka bërë një analizë të plotë.

7.

Një veçori e krijimtarisë përrallore të Teufik Gjylit është dhe lëvrimi i përrallës floreale, i cili përqendrohet brenda një fushe veprimi dhe i përgjigjet një personazhi-lule. Brenda kësaj fushe mësojmë ndodhinë apo

38 Xhagolli, Agron: "Klasifikimi i prozës popullore shqiptare", Dudaj, Tiranë, 2001., 4. Tregimi popullor realist, f. 151.

historinë e këtij personazhi-lule.

Historitë magjepsëse të luleve, të mbledhura në simbolikën e gjetur të librit e, që aq bukur i rrëfen autori janë të lidhura drejtpërsëdrejti me personazhet, të cilët, për ngarkesën që mbartin në përrallë dhe mënyrën si e mbartin atë, krijojnë disa funksione sipas këtij klasifikimi, që nga ana tipologjike i mbart dhe përralla popullore.

* Funksioni i dhënësit të lajmit ose të parashikuesit.
* Funksioni dëshmues ose i dëshmitarit.
* Funksioni i bartësit total ose të pjesshëm të ngjarjes.
* Funksioni përjetësues.

Funksioni i dhënësit të lajmit ose të parashikuesit në legjendën "Përdredhsa" realizohet nëpërmjet personazhit të ndërmjetëm, siç është plaka. Ajo është nyja lidhëse në mes historisë tragjike të çiftit mbretëror që nuk kishte fëmijë, me ndodhinë përfundimtare, por tragjike të vajzës që erdhi në jetë e që vdiq pas shtatë vjetësh. Momenti i fundit është përceptuar me ngjyra legjendare e tone lirike. Ky rrafsh ruhet edhe kur shfaqet në mënyrë të papritur shpirtëzimi i lule përdredhses. Në këtë rast ajo mbart edhe funksionin e përjetësisë në historinë e vajzës së vogël. Po i njëjti përceptim ndodh respektivisht te Lulemullaga e te Lule Kalthi. Te e para, ajo lind nga lotët përvëluese të nënës, e cila humb birin e saj; te e dyta, ajo lind kur nëna ndjeh rahanë e bijve të saj. Zakonisht në këto legjenda e në disa të tjera, funksioni i përjetësisë shërben si kurorë përmbyllëse e krijimit. Këto krijimi kanë të përbashkët edhe të njëjtin ndërtim kompozicional.

Në qoftë se te "Përdredhsa" plaka (personazhi i ndërmjetëm) rrit intrigën në fabul, te "Lulezana" kaprolli bëhet "çelës" për zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjes. Po te kjo përrallë, Zana e më pas Lulezana (shfaqja të elementit mitologjik) si personazh kryesor mbart ngjarjen e vetvetes, që zhvillohet në një qytet nënujor. Personazhi (Zana) shndrrohet nga një krijesë reale në ireale (lulezanë), por pa humbur njësinë e vendndodhjes si element real: një lule që rritet pranë bregut të liqenit. Ndryshe ndodh me figurën e floçkës te "Zojëmirana". Gjatë gjithë rrëfimit të ngjarjes, edhe atëherë kur humb emrin e vërtetë, autori procedon që nga fillimi deri në fund duke ruajtur një plan: atë ireal. Në këtë rast, aroma e legjendës është më e ndjeshme dhe dukuria e saj është më e pranishme. Mjafton të kujtojmë këtë copëz pasazhi: "*Kur ai zbriti në vendin tek i cili pa të amen, s'e gjeti ma, pse motrat, trupin e saj të vdekun e kishin marrë me vete për ta varrosë në fund të detit. Vetëm një bimë me gjethe të vegjël mbiu aty dhe*

Urani i shkretë, në të, ndiente erën e së amës.

Në atë çast mandej, që gjindja u mblodhën për të pa, se ç'qe ajo britëm, gjetën djalin që kishte rrokë lulen me gjethe të vegjël e me lulza të imta e të bardha e qante gjithnji tue thirrë të amen. Më mbrapa, atë lule e thirrën: Zojëmiranë".

Në disa legjenda dhe përralla, autori zgjedh një mënyrë tjetër për të komunikuar me lexuesin. Që në hyrje e njeh me personazhin. Karakteri i tij zbërthehet gjatë rrjedhës së ngjarjeve, e njëkohësisht është bartës i saj. E vërejmë me zanën te "Lulezana", me vajzën te "Lavanda". Këto personazhe shquhen edhe për një veçori tjetër. Ata, nuk janë të vetmit bartës të ngjarjes, në këtë rrjedhë lëvizin edhe personazhe të tjerë që, me veprimet e tyre janë në funksion të personazhit kryesor. Kështu ndodh p. sh. me vëllain e vogël që mposht rreziqet që i kanosen vetëm që të realizojë dëshirën e qëllimin e motrës.

Personazheve-lule shkrimtari Teufik Gjyli u ka dhënë edhe fusha të tjera veprimi. Ato nuk kanë funksionin dëshmues, por janë pjesë aktive në zgjidhjen e shumë momenteve të vështira, që u paraqiten personazheve të tjerë. Kështu Lulekumbona u vjen në ndihmë dy vajzave të vogla për të gjetur udhën, të cilën e kanë humbur. Ndërsa Lulengishtëza i vjen në ndihmë Miços, që të punojë e të mos jetë dembel në jetë.

Një veçori tjetër është se, legjendave dhe gojëdhënat me ngjarjet që trajtojnë, me mënyrën se si zgjidhen, karakteristika e stilit me të cilin shkruhet, na kujtojnë baladat popullore, imazhin dhe parafytyrën e tyre.

Lule borziloku bëhet simbol shpëtimi. Ajo ndihmon djalin për të mos rënë në fund të greminës. Kurse Lule jasmina me bukuritë e saj bëhet urë pajtimi mes zemrave të qytetit të Kështjellës së Bardhë. Te këto dy krijime, ndërtimi dhe ngjyrimi figurativ përkon me natyrën e baladës, më konkretisht të Baladës së rinjohjes.

Personazhet-lule, që përgjithësisht mbartin ngjarjen kryesore, brenda fushës së veprimit, ballafaqohen dhe ndeshen me figurën e shtrigës, simbol i së keqes.

Kjo figurë, e ka një mënyrë se si vjen në përrallën e Teufik Gjylit. Një e folur dhe lëvizje dredharake, po me këtë status dialogon edhe me personazhet e tjerë. Arsyetimi, fjalori i përzgjedhur, mendësia, atmosfera që e rrethon, etj. E bëjnë këtë figurë të jetë krijim larg tradicionales, që jemi mësuar ta vizatojmë e ta shikojmë. Por gjithësesi, autori nuk mund t'i largohet ngjyrimit të portretit të jashtëm, të cilin pothuajse të njëjtë e kanë të theksuar ato përralla popullore, ku shtriga është i pranishëm si

personazh. Mjafton të kujtojmë këtë fragment: "…një grue me një fytyrë të verdhë porsi të vdekunve e të shemtueme, me flokë të lëshuem e të ngatrruem, që dilte prej një çufrre". ("Lulekrupna")

Te kjo përrallë, pikësynimi dhe qëllimi i Shtrigës është të eleminojë zanën. Këtu, brenda fushës së veprimit që ka përralla, autori i jep më shumë fushëveprimi dhuratëdhënësit, që është zana. Për të shprehur triumfin e zanës, autori me mjeshtëri e fuqizon atë si personazh nëpërmjet ngarkesës që depoziton te ajo mjeti dhe fuqia mitike. Teufik Gjyli në këtë përrallë thotë: "… kishte me vete të drejtën e fuqinë e një hyjneshe, që për të kishte qenë shërbëtorja ruajtëse e fëminisë".

Për rrjedhojë zana triumfon mbi shtrigën, dhe autori përsërit, si në shumë përralla të tij, modulin : E mira mund të keqen. Autori në fund të përrallës rikonfirmon triumfin në këtë mënyrë: "*E tash, sa herë që boçet e lulekrupnës janë në lulëzim e sipër, gjithnji shihen tue u përkundë në ajri zylyfet e shtrigës smirëzezë".*

Këtu vëmë re edhe dy elementë të tjerë me të cilët operon autori: *) lënia e personazhit pa emër dhe *) ndërtimi i sintagmës me një plotëri e thellësi të së keqes edhe si kategori estetike : shtrigë smirëzezë !

Në këtë përrallë (e në shumë të tjera) shohim të realizuar dukurinë që ka vërejtur në këtë gjini studiuesja Dr. Myzafere Mustafa, e cila thotë: "*E mira dhe e keqja mishërohen në personazhe të caktuara dhe në veprimet e tyre, ashtu siç janë të pranishëm e mira dhe e keqja çdo herë në jetë, ndërsa paradispozitat për njërën dhe tjetrën janë të pranishme në secilin njeri ».* [39]

Në përfundim themi se, në legjendat, përrallat e kallzimet e tij, (ku ka edhe motive me qendërzim magjik e mitologjik), Teufik Gjyli shfaqet si veçori parësore e personalitetit të tij, si një krijues lirik. Lulet-personazhe me historinë e tyre që rrëfyen mbeten një tufë "vjollcash kujtimi" në kujtesën e lexuesve të vegjël. Dhe kjo nuk është pak, sepse ka të bëjë me misionin e një krijuesit të vërtetë. Dhe kjo është meritë e shkrimtarit Teufik Gjyli, që « … përrallat… (të) ruajnë bukurinë, që u jep gjuha e krehur dhe përshkrimet tërheqëse.»[40]

Prof. Vehbi Bala thekson : « Proza tregimtare e shkrimtarit Teufik Gjyli dallohet për stilin e rrjedhshëm, për paraqitjen tërheqëse të viseve,

39 Mustafa, Dr. Myzafere : « Përralla shqiptare » -poetika dhe mitikja-, f. 35, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2003.

40 Çadri, Prof. as. Dr. Ramazan : « Lindja dhe formimi i Letërsisë shqipe për fëmijë », SH.B. Redona, Tiranë, 2009, 1.1. Fillimet e përrallës së re, f. 111.

njerëzve, kafshëve dhe bimëve, për ndjenjën e ngrohtë, me të cilën ai u rrëfen fëmijëve ».

Duke selektuar përrallën, në trinitetin autor-rrëfimtar-përrallëtar, shkrimtari Teufik Gjyli përdori në raporte të caktuara e të drejta elementet fantastike që ia dhuroi tradita, por kurrë se humbi vështrimin në temën aktuale. Ndaj dhe kjo është arsyeja që së bashku me shkrimtarët Spiro Çomora, Qamil Guranjaku, Drago Siliqi, Zihni Sako, Bedri Dedja, Vehbi Bala, etj., sollën në letërsinë shqipe për fëmijë e të rinj mjaft elemente te reja.

Dhe ndalemi konkretisht te Teufik Gjyli, që me talentin e një shkrimtari pasionant për fëmijët, pa të cilat nuk mund të kuptohet jeta e tij artistike, ai e zhveshi përrallën nga koncepti i vjetër dhe e veshi me interpretim të ri. Kjo është arsyeja që legjendat e luleve kanë në themel rrëfime e përshkrime të një bukurie të rrallë që shpirtëzon e frymon përjetësisht Vendlindjen e të parëve e Vendlindjen e poetit, që shpirtëzon dhe frymon përjetësisht amanetin dhe testamentin artistik i shkrimtarit. Ndaj, studiuesi Bedri Dedja thotë me të drejtë : « Mjafton të thuash se ne kemi pasur autorë jashtëzakonisht të pasionuar për letërsinë e të vegjëlve, që kanë hedhur gurët e parë në themelet e saj dhe kanë bërë një punë shumë të kujdesshme, … »[41] dhe më tej vazhdon : « Të tilla janë dy figurat e paharruara të letërsisë sonë të re për fëmijë, Q. Guranjaku dhe **T. Gjyli. »**[42]

Të mos harrojmë se, shkrimtari Teufik Gjyli na dha një model përralle. Ndikimi i përrallës popullore shfaqet në to, në dy drejtime : a) « ndihet në mënyrën e trajtimit të fabulës dhe subjektit, (si dhe) në rrjedhën kompozicionale, …, veçanërisht në tipin e figuracionit dhe detajet poetike, në qartësinë dhe forcën komunikuese të mjeteve shprehëse. »[43] dhe b) në « një brendi realiste, (në) një shpirt të dukshëm popullor… »[44] E gjitha kjo i përgjigjet një momenti të rëndësishëm të letërsisë sonë për fëmijë dhe të rinj, letërsi edhe pse kanë kaluar dy dekada të një realiteti të ri historik demokratik, nga librat që botohen, gjenden ende me shumicë krijime që nuk i kanë shkëputur lidhjet me letërsinë e soc-realizmit, të cilat përkojnë

41 Dedja, Bedri: "Të vlerësojmë më mirë rolin e letërsisë për fëmijë", Drita, 08. 04. 1973.

42 Po aty.

43 Kallulli, Adriatik: "Poezia jonë për fëmijë dhe folklori" faqe 116; nga libri: "Probleme të traditës dhe të aktualitetit në letërsinë tonë për fëmijë", Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1976.

44 Po aty, f. 118.

si në : konceptim, në atmosferë, në zgjidhje të konfliktit, etj. Duke parë këtë gjendje që realisht nuk është dhe aq entuziaste, studiuesi dhe kritiku i njohur Ramadan Musliu shprehet me të drejtë : « Fryma e krizës së letërsisë së realizmit socialist, sikundër edhe modelit letrar të mbështetur mbi figurën, është më i fuqishëm se ndikimi i këtij perceptimi ekzizstent në këtë kohë, por jo aktiv. Që të krijohet prioriteti i ekspresionit të ri estetik duhet që edhe lexuesi të lirohet nga bagazhi ideologjik i veprës letrare, **që të krijojë vetëdijen mbi vlerën e traditës** dhe që përmes përvojave të reja të arrijë të komunikojë me ide dhe koncepte të reja që mund të ofrojë letërsia e periudhës së fundit. »[45]

Nuk e di pse, teksa shkruaj këto radhë për Teufik Gjylin dhe përrallën ëndërrtare që krijoi, m'u kujtua se diku kisha lexuar këto relike të çmuara:

* Përralla ka disa tipare që e bëjnë t'i qëndrojnë kohës.

* Është e padyshimtë vlera njohëse historike e përrallës që, siç shprehet Gustav Majeri, zë një nga vendet e para në studimet që ndihmojnë të njihet e kaluara e njerëzimit.

* Përralla është instruktive, me kuptimin e saj të thellë moral e njerëzor dhe jo vetëm për të vegjlit. Nga ana tjetër, me realizmin e saj ofron situata jetësore e karaktere njerëzore.

* « Përrallat janë të vërteta », thotë me bindje Italo Kalvino në parathënien e përmbledhjes së tij të përrallave italiane. Kjo shprehet edhe në proverbin e popullit tonë : « Shumë përralla që kanë të ngjara ».

* Syri i përrallëtarit ka vërejtur rreth vetes dukuritë, njerëzit e sendet dhe i ka pasqyruar herë drejtpërsëdrejti… herë me alegori… e herë me simbole…

Si përfundim: *Gjuha e përrallës të kthen te gjuha e nënës, e gjyshes.

Gjatë një leximi: « Kur lexova se sot është dhe Dita Botërore e Të Moshuarve, mu kujtuan ato poezitë e librit « Në prehër të gjyshes » të Anton Çettës, « Përrallat e gjyshit » të Mark Krasniqit, poezitë për fëmijë për gjyshin e gjyshen nga Rexhep Hoxha, Rifat Kukaj (libri me poezi « Çao, gjyshe »), Ali Huruglica e deri te Agim Deva dhe Gani Xhafolli. Madje, libra të tërë për fëmijë u kushtohen gjyshit e gjyshes. E kush më shumë si nipat e mbesat i nderojnë ata ? Gjeneratat e sotme të moshuara, po ashtu janë rritur me kallëzimet e përrallat e gjyshërve e me këngët e

45 Musliu, Ramadan: "Tangjentat letrare", Kritikë, Elta Bs, Prishtinë, 2011., Kritika – reflektim i krizës së vetëdijes krijuese, f. 16-17.

historitë e treguara për ngjarjet e së kaluarës. »[46]

Gjatë një leximi:
‘fëmijët e emigrantëve janë fëmijët për të cilët
gjyshja asht ajo fytyra e qeshun në skype
ajo gruja e e ngrohtë që i shtrëngon fort
e nuk din me i lëshu në verë
që duhen tre ditë me u mësu
mandej vjen koha me ikë
e një vit rrinë duke e andrru
fëmijët e emigrantëve nuk e dinë
se gjyshja asht një prehën i ngrohtë
ku ti mundesh me u fsheë çdo ditë
asht ajo që t’i fal tana pa kushte
asht një bohçe me xhepa mbushë me gjana të mira për ty
asht zani që të pajton
me kangë të vjetra
që të kujtohen një ditë
kur bjen shi e ai që don ka ikë
asht plaka që ta ban nanën të re
e të tregon se jeta asht e bukur
se kështu ka qenë
se kështu ka me qenë’[47]

Gjatë një leximi :

Nga një baladë, (fragment) që mendoj se, është një nga perlat e letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Autori Odhise K. Grillo shkruan për gjyshen e tij:

‘I.
Kam pasur një gjyshe
mbi të gjitha gjyshet,
kur ajo tregonte
heshtnin dallëndyshet.

46 Buzhala, Prend.: Muza e dhjetë, (Çaste shkrimi IV), Tri ditë në një ditë (Çaste shkrimi IV, I), f. 9-10.

47 Tabaku (Sorman), Entela: një grusht jetë sa me vdekë, Adonis, Tiranë 2016, poezia: fëmijët e emigrantëve, f. 54.

Kur ajo tregonte
mbanin vesh dhe gurët,
thaheshin moçalet,
lulëzonin drurët…

2.
Po ku je, moj gjyshe,
se më mori malli,
je prapa një ylli,
a prapa një mali ?

Kurt ë kujtoj ty,
Këngët e përrallat,
Gjumi edhe sot
Vjen m'i mbyll qepallat…[48]

8.

Duke gjurmuar rreth krijimtarisë së përralltarit Teufik Gjyli, gjetëm dhe një shkrim të botuar prej tij[49], shkrim që na fliste për marrëdhiet me letërësinë fëminore e në veçanti për përrallën, për mënyrën e të shkruarit të kësaj gjinie, për filozofinë, imazhin dhe konceptet estetike, si dhe për porositë e vyera të shkrimtarit të dhëna në raport me kohën ekzistuese.

Shkrimtari Teufik Gjyli ndalet në disa momente, të cilat janë:

* Pedagogë dhe shkrimtarë, poetë dhe prozatorë, që nga çlirimi e këtej e pasunuen letërsinë fëminore nën ndikimin e një fryme të re, të një edukimi të shëndoshë të brezit të ri ndër të gjitha gjinitë.

* Letërsia jonë fëminore pat prijëse zhvillimin e letërsisë fëminore sovjetike.

* "... ndër botimet e deri tanishme për fëmijë ka mungue kritika aq sa duhet..."

* "... ka pasë edhe mjaft të meta në redaktimin e librave për fëmijë..."

* "... nuk do të na ndalojë që të vemë në skenë të theatrit të kukllave një kallzim o një përrallë të folklorit tonë siç asht p. sh.: 'Bija e mbretit dhe shtriga', kur të jetë përpunue si duhet përpunue si duhet dhe ndërtimi i saj

48 Grillo, Odhise K..: Mollëkuqja e fëmijërisë, vjersha dhe poema, OMBRA GVG, Tiranë 2001., poezia: Balada e Burrave të Vunoit, f. 3-4.

49 Gjyli, Teufik: Përralla në letërsinë tonë për fëmijë, f. 44 – 45, Arësimi dhe Kultura Popullore, Nr. 6 qershor 1955.

të vlejë nga të gjitha anët për edukimin e brezit të ri dhe të fëmijëve tanë.”

Konceptet e shkrimtarit për përrallën:

1.Përrallat kurdoherë kanë mishërue andrrat ma të guximëshme të popullit ...

2.Përrallat dhe legjendat e Tolstoit e të Gorkit paraqesin ciklin ma të bukur të letërsisë së kohës së tyre për fëmijë.

3.Suksesi i kësaj letërsie: “... kanë prekë në përfytyrimet e tyre në fantazin e tyre (të fëmijëve, - nënvizimi im, Xh.B.) “... kanë dijtë t’i mbajnë të magjepun lexuesit për vjet e vjet mbas vdekjes, sepse mbi bukurin e vendit të vet kanë thurrë urtësinë dhe lavdinë e popullit, dëshirat dhe aspiratat.

4.Përrallat ose kallzimi për fëmijë asht ma i lehtë me u kapë, sepse asht ma i afërt drejt përfytyrimeve të tyre, megjithse tepër i vështirë të krijohet nga ana e shkrimtarit.

Në përrallë dhe në kallzim ke të bajsh:

- me kohën,
- me punën,
- me mënyrën e jetesës,
- me zakonet e kostumet e një populli a të një krahine,
- me konfliktin që shpërthen,
- me heronjt që dominojnë për të nxjerrë anën pozitive dhe edukative,
- (brumi duhet të jetë fantastik.)

Gjuha e përrallës

***** të jetë me gjuhën e fëmijës dhe me përsëritje të një mbasnjëshme, ... (me arrijtë edhe diçka ma përtej.)

* ta shkruash bukur, thjeshtë e pastër, në një mënyrë artistike.

* përralla zbavit fëmijët.

* u zhvillon horizontin.

* Krijimi i legjendave dhe i novelave fantastike për fëmijë, të bazohet mbi tematikën e folklorit tonë, të mbështetet në përrallat tona kombëtare; kështu do t’i flasin më mirë realitetit dhe kohës.

Të gjitha këto dukuri u shfaqën e morën udhë përmes një raporti, i cili është dhe "lulëzon" në mes përvojës vetjake të shkrimtarisë dhe tekstit përrallor, tekst që autori e 'qëndisi" me shpirt e talent.

Mendojmë që autori e njeh dhe e ndjek rrjedhën e botimeve dhe të kohës së letërsisë për fëmijë, ndonëse në shumë raste e kapërceu atë, duke mos u ndikuar, gjë që në rastin konkret: profili si përralltar u gdhend që në krijimet e para të kësaj natyre.

Shkodër, 2016

Lisandri KOLA

Gasper Pali, antipodi i vëllazënve
— në njiqindvjetorin e lindjes —

Si këtu e njiqind vjet ma parë, kishte me lindë në qytetin e Shkodrës Gasper Pali. Nji ndër poetët që zen nji vend të caktuem në letërsinë shqipe. Disi i skajtë (i mënjanuem), për shkak edhe të prodhimtarisë së tij letrare jo fort sasiore, apo për shkaqe të tjera të cilat janë mbase jo të nevojshme për me u shtrue a hamendë se janë të vërteta.

Gasper Pali asht nji poet, i cili ka punë monografike apo artikuj të ndryshëm a trajtesa etj., mbi krijimtarinë e tij – punë, të cilat shumë pak na kanë pru nga drita e vargut 'tij. Si brez, i takon atij brezi që u shkollue e u vadit në fushën e letrave jashtë vendit, përkatësisht në Firence, por që pati fatin e tillë për me u nda nga jeta e letërsia në nji moshë krejt të re. Bash atëherë kur niset m'u krijue edhe maza e duhun artistike e nji poeti, e kur palca fillon me marrë trajtën e vet gjegjëse. Pra, gjithçka pushon për shkak të nji sëmundjet mjaft e përhapun në atë kohë: tuberkulozit. Tue e lanë kështu, siç thoshte prof. Kolë Ashta, poezinë e tij "*incompiuta*". Prej tij, na kanë mbetë do poezi, – fare pak, – ku në botimin e hershëm (*Hyjt mbi greminë*) janë lanë jashtë edhe disa me tematika jo shumë të përshtatshme, por gjithsesi të rehabilitueme ma pas në botimin tjetër (*Bisedë me vetvedin*).

Veprimtaria e tij poetike, nis e shtratnohet atëbotë kur letërsia shqipe kishte emna të mëdhaj: Fishta, Mjedja, Koliqi, atëbotë kur po njihej era e modernitetit për letërsinë tonë me Migjenin e Poradecin, e plot të tjerë pa dashtë me rendue lista e stërlista. Por, gjithqysh në atë fazë të shkurtë pune, Gaspri, individualizohet e ndahet në shej si poet, tue mos i përngja disa prej poetëve/shkrimtarëve tonë edhe pse flitet se ka raste përafrie në poezi të caktueme, si p. sh.: *Djepi i vorfen*, ku asht thanë se, shembllen me motive migjeniane, sepse mbrendësojnë njifarë pasqyre të realitetit tonë në ato vite. Porse, kjo poezi dallon ku e ku me Migjenin, ngaqë *së pari*: kërkon me qenë ma klasike si komopozim – strofë katërshe, vargje të matuna (nji tetë e nji katërrokësh), edhe pse shumica e poezive të Palit janë të çrregullta metrikisht, dhe rimë *abab*; *sëdyti*: asht në përkundërsi me paraqitjen e motivit të mjerimit social e kushteve të asohershme të Shqipnisë, ngase nuk mëton me pasë doza të theksueme pesimistike, dhe melodiciteti e harmonia e vargjeve (tipar i qenshëm në poezinë e tij) duket se e fashisin

atë përmasë, që del si kryefill qysh në titull, qoftë kjo edhe me strofat e mbrame të poezisë. Por edhe nëse Gaspri ka motive ngjashmënie me njado poetë tonët, kjo asht nji gja e natyrshme brendapërbrenda letërsisë: vendase a të huej. Kontaktet mbrenda sistemit letrar vendas e të huej, janë kontakte të mirëpranueme tashme. Elemente ndikimesh në letërsi, gjenden qysh në krye të herës.

Në poezinë e tij, nuk mund të themi se nuk gjendet përmasa e etnicitetit[1] (gja që Koliqi në shkrimet e tij, thotë se kjo e fundit tek shkrimtarët tonë asht bjerrë; kritiku në këtë pikë flet për *etnobjerrësit* në kundrojën e tij të letërsisë sonë mbas '45), e përvijueme në kahe të ndryshme, por as nuk mund të themi se ka frymë të thellë me traditën tonë letrare, vijimsinë letrare. Aty-këtu në fakt, ka pikëndeshje, veçse të përpunueme e të ndërkalluna imtazi e hijshëm, dhe disi vështirë m'u vrejtë.

Gaspri si poet, para së gjithash, asht i çinteresuem me qenë nji prej atyne poetëve me nji angazhim tejet social. Por asocialiteti në poezitë e tij nuk don me thanë se e rrëzon përmasën ekzistencialiste. Mbi të tana, poezia e tij asht e interesueme në përfaqjen e përjetimeve vetjake të unit, të përçueme me nji ambëlsi të mjaftë edhe atëherë kur ka dhimbje në vargun e tij. Në raste të caktueme figura e "vashës", nji leksemë e aktant thelbsor, që na del dendun dhe që hera-herës lidhet me elementet e dhimbjes poetike, asht simboli i së parealizueshmes, gja që e ban unin lirik me përsiatë rreth humbjes së nji motivi bazik të jetës – mundsisë për me dashtë. Andaj, në *Zane stuhish* me nji nëntitull (*Vdekja e dashunis*), vrejmë këto vargje: "*Kshtu shpirti i jot, m'rremben ashtu meiherë / e m'shpjen n'lamije, mbushë me frymë mshehsije, / ku m'shuehen andrrat / e ndiej ner dej vdekjen e nji dashunije*", që kanë nji përfundim të pritshëm, meqenëse mbas kësaj: "shpirti mbetë i ftohtë, si muzg dhetori". "Vasha" e konceptueme në natyrën e nji subjekti fshehtësie (misteri) përban *nyjen erotike* të poezisë së Gasprit. Prandej, fytyra e vashës i ngjan atij si: "*nji det plot mshehtsî*" dhe "*gjithkund kah heci ndeshi veç mshehtsi*" – vijon poeti në *Vashë e panjohtun*. Por rishtas në këtë poezi, ai e përmbyll konceptimin për figurën e femnës: "*Kështu vashë, / fytyra e jote forca t'reja m'ngjallë / pse m'bahet se vroj Misterin mu n'ball*". E tillë i duket figura e femnës, prej ku buron vitaliteti i unit lirik paçka se ajo ka mister në qenien e saj, gja kjo që ban shumë të randësishme tharmin filozofik: (vet)eksplorimin. Fillimisht veteksplorohet, prejse bahet i vetëdijshëm për dispozitat e veta,

1 Khs. poezinë *Natë shtrregllash*.

e pastaj eksploron tjetrin (vashën) tue kuptue kështu fillin e vërtetë të jetës, në idenë që me u ndërlidhë njipërnjitas njeni me tjetrin, sikundërse e thotë edhe ligji hyjnor e natyror qysh me prindët tonë parakë.

I ngjashëm vjen konceptimi edhe në *Dritë të mshehuna*, poezi këto të tria krijue nji vit përpara se Gaspri me pushue në të djathtë të vorreve të Rrmajit, n'vendlindjen e tij. Kështu që strofa i përgjigjet së njejtes ide, që cekem ma nalt: "*N'trupin t'and perherë dridh's dej t'ri kerkojshe, / sepse dejt tue, nga vapa kan shastisë. / E ndiej se jeta vlon, si un deshrojshe. / E kryet pshtes mbi flokë të zi, / e ti mbi flokët e mi*".

Pá në trajtë metaforike, kërkimi nëpër ato dej, i gjegjet ekslporimit të natyrës së femnës, dhe dëshirës për me njohë e kuptue sa ma shumë që të jetë e mujtun në nji raport. Pamundësia për me pasë vashën, njeriun e zemrës (edhe nëse duem me iu drejtue unit, qoftë edhe si un biografik/historik), që del edhe si lajtmotiv i këtyne poezive, pasqyrohet edhe në *Andrrime fiorentine*, ku në vargjet: "*Andrroj të Kleydes sye / si dy hije qiellore*", del qartë mosrealizimi i dashnisë. Kjo, tueqenëse, autori tashma asht kthye në atdhe e i ka ndërpre studimet e veta, për rrjedhojë a' i detyruem me këputë në mes edhe lidhjen e tij me vajzën që merr identitetin e sipërm.

Por përpos përmasës erotike në poezinë e Gasprit, gjejmë edhe nji fazë krijimtarie që lidhet padamas me fazën e studimeve në Itali, megjithëse në këtë fazë ka edhe ndoj poezi që na del si realizim i përparshëm. Në këtë fazë shohim të përmasueme *nostalgjinë për vendlindjen: toposi i vendlindjes*. Sikundërse autori asht i kujdesshëm me leksikun e pastërtinë e gjuhës, ai po kështu asht edhe me paraqitjen e këtij kahshikimi. Mbase njifarësoji mund të përjashtojmë poezinë *Bisedë me qytetin tim*, – në të cilën dallohet fermenti riosh i vargnimit (19 vjeç asohere), – e cila e ka ma shumë të dukshme sesa poezitë e tjera lidhjen me vendlindjen dhe shqetësimin e tij për kolapsin e saj. Në këtë atmosferë pesimistike për kohnat e dritësueme të Shkodrës, gja që lidhet me të kaluemen, gjithsesi në mbrendinë e poetit ekziston ana optimiste: shpresa e përtërimjes. Fakt që e shohim në strofën mbyllëse: "*Por Shkodra prap andrron / e zemra nuk e lshon. / Dhe mue m'dridhet nji shpresë, / si n'zemren t'ande. / Kshtu mjes mjerimi na buron andrrimi / pse ty e mue, Shkoder, me andrrue na kande*", edhe pse poeti, në të vërtetë, sjell nji pamje reale të atyne viteve në vargjet e tjera. Prandej kemi nji qytet që "*i shuhet gazi ndër buzë, të vetat e të poetit*", nji qytet "*ku kanë bulue gërmadhat*" e ku "*në muzg ndezet drita e mjerë*"; s'ka "*as kangë e as valle me kalue natën*", por ka veç "*qej që hungrojnë e n'ajrí si gjamë ushtojnë*" etj. sosh.

Natë shkodrane asht nji tjetër poezi me tone përlavduese të qytetit ’tij, në të cilën nuk asht se merr pjesë ndonji tipar solemniteti, ngaqë kjo mund të na çonte në amplifikime të rreme. Por në të paraqitet nji katranzë perceptuese për netët që gjallojnë këtu. Në dukje asht nji qetí gati e plotë, ku nuk ndihet tjetër pos gjetheve që fëshfërijnë e kuakjeve të bretkosave nën nji hanë, që i veshet qiellit rrumbullak. Po ashtu ka edhe kangë e valle shregullash, çka dëshmojnë po përsëri praninë e nyjes erotike, e që njikohësisht dëftojnë edhe identitetin e qytetit verior: skemën funksionale. Kjo nyje përçohet në tri vargjet e fundit të poezisë, sërish ma qartë: “*Shkoder qofsh levdue, / nga buz’t e vashës s’re si karajfili! / Pse netët e ambla, vasha din me i kndue*”[2].

Vegim mergimesh, e shkrueme në Firence, atëkohë kur poeti ishte në përfundim të studimeve e s’kishte edhe shumë për me u kthye e m’iu kushtue mësimdhanies, shpreh mallin për vendlindjen (“*N’shpirtin t’im / rreh malli i Shkodres...*”) dhe dëshirën për me përjetue netët shqiptare (“*... Tash që jam n’mergim / kam èt netësh shqiptare*”). Po përsëri e ndien atë qetësinë e qytetit të lindjes, të dhanë përmes atyne gjetheve që zhurmen ambël natën: “*Ndiej frushullim gjethesh / kah përkdhelë pema pemen me butsí*”, e njikohazi hana asht siç del edhe në poezinë e sipërme, e shoqnueme me figurën e “vashës” – pikë përbashkësore në pjesën ma të madhe të poezive.

Në të njejten vijë asht nostalgjia për vendlindjen në *Muzg mergimi*, e përafërt ndërtimisht si titull me *Vegim mergimesh*, por konceptualisht ndryshe, ngase në të mbrendësohet faza e fëminisë; përjetimet e tij në vendlindje kur ishte fëmi dhe dëshira me qenë rishtas për të pá hanën që del në qiell. Atë hanë që kur ishte fëmi, deri tek ajo, donte m’e çue balonën e tij, së bashku me shokët: “*Andrrimet tona / kaloshin pertej malit. / E kur dilte hana, / na fmí prej zallit, / balonen, der’hanë, dojshim me e çue*”. Por jashtë vendit, kujtimet (shembllye në zane murmuritëse) i thonë atij: “*– Eja n’Shkoder, si dikur fmí, / e prep prej zallit / ke me e pa hanen kah çohet mali. –*”, e pezmas kujton ato kohë të lumtuna tu’ i ballafaqë me ditë-netët e kalueme në vend të huej.

Siqoqoftë, Gasprin, nuk e dallojnë këto dy pika të krijimtarisë së tij, në të cilat u ndalëm, sepse ka shumë autorë tonët që kanë pikëpjekje me *erotiken* dhe poezi me temë qendrore *vendlindjen*, por qasja ndaj këtyne të dyjave asht e personalizueme.

2 Lidhun me nji sintezë të *nyjes erotike* e *toposit të vendlindjes* khs. edhe *Mëngjese Shnjergjash*.

a. Në erotikë, dallohet eleganca e stil të veçantë: pa shumë ornamente/ *afigurativitet* dhe pa shumë stërhollime gramatikale, por me përjetime që ndërhyjnë në sistemin komunikativ të lexuesit, si rrjedhojë edhe në psiken e tij (tue ndërtue *hipotipozën* lirike). Erotizmi, mandej, i pamë në trajtën e tij ma të dlirë e ma[3], ndërton modelin paraqitës (relativ) të këtij elementi që del i pranishëm në veprën letrare.

b. Toposi i vendlindjes, nuk jepet në nivele të tejme të veneracionit ndaj saj, por në pikëpamjen e mallit, të racionalizuem e jo të kapluem nga instinkti sa me shkue deri në patetizma. As nuk ka struktura ligjërimore, që dallojnë për frymje, të cilat shpien në çekuilibër marrëdhaniesor.

c. Asocialiteti i tij kundrejt poezisë angazhuese (programative/ qëllimore) të shumicës prej poetëve tonë të atëhershëm, tregon për nji krijues me tipare të përkundërta me kriteret estetike të dhetëvjetëshit mes ’30-’40. Aq ma tepër kur ne kishim ende prodhime në epikë, lirikë, që ma mirë me thanë, nji pjesë e madhe e tyne ishin *karma*, nëse flasim për Fishtën. Apo ma heret a ma vonë, autorë që kërkojnë me krijue simbas kritereve neoklasiciste në kushte moderniteti.

Vrejtje mbi botimin *Prendimi i andrrimeve*, Dit’ e nat’, Prishtinë, 2015

Tekstet e poezive të Gasper Palit në tanësi, qysh prej poezisë së parë të botueme në të përdymuejshmen e Korçës “Rilindja”, më 15. 02. 1936 tue vijue me botimet në revistën “Shkëndija”, me botimet postume në revistën “Fryma” dhe dy variantet e kuruem nga Nasho Jorgaqi e Filip Ndocaj (1959) apo Filip Ndocaj e Nasho Jorgaqi (2000), paraqesin luhatje të konsiderueshme. Vetë emni i poetit, për hir të së vërtetës, na del në dy variante. Herë *Gasper* e herë *Gaspër*. Dëshirës sonë për me gjetë certifikatën e lindjes së autorit, i lindun simbas burimeve të botueme më 14 gusht 1916, i doli pengesë regjistrimi i vonë i popullsisë së Shkodrës. Simbas informacionit që na dhanë në Gjendjen civile të këtij qyteti, regjistrimi i kësaj popullsie kishte pa’ nisë në 1930. Pra, nji certifikatë lindjet e Gasprit nuk ekziston, përpos ndonji regjistrimi shumë të mavonshëm me të dhanat përkatëse (?). Kështu që, nuk na u duk me vend me ngulmue me gjetë fletoren ku asht pse mund të jetë regjistrue ai, pas atij viti nistues

3 Jo p. sh., fjala vjen, si modeli i erotizmit që na ofrohet nga poezia *Epsh* e Arshi Pipës.

për regjistrimin e frymëve, sepse dokumenti bazik që na interesonte nuk ishte i pranishëm. E njejta gja ndodhi dhe me interesimin e certifikatës së pagëzimit: e pamundun!

Tue shpresue se mos do të gjejmë ndonji siguri në vorrin familjar të Palit, – në vorrin e rindërtuem së voni, ngaqë përpara ka qenë shumë ma modest: nji kryq druni me mbishkrim të kuq, – në të cilin prehet dhe poeti, shikojmë se përveç datës së gabueme të lindjes së mbivendosun (1918) edhe emni asht i shkruem në trajtën jo të duhun. Kjo gja ka ndodhë, mbase, prej ngatërresës së datës së lindjes në diplomën e Palit: *1° novembre 1918*, e bame kjo për arsye të ndoj favorizimi shkollor, ndoshta. Në vorr, me kapitale shkruhet: PROF DOK GASPERI. Kështu, ajo zanore e pavend në emnin e tij, në trajtën e shqueme, mund të ishte E ose Ë, në përputhje me modernitetin shkrimor të zanores ë, e cila del pa dy pikat përmbi. Por sidomeqenë argument themelor për shkrimin e emnit të këtij poeti, kemi *autografin* e tij, si dhe vitet në të cilat botoi Pali sa ishte gjallë. Duhet thanë se, emnin e tij vetë Gaspri, herë e shkruen me *e* dhe herë me ë. Tue u bazue në dorëshkrimet e tij, si dhe në disa korrespondenca me shkrimtarin Filip Ndocaj, mik i ngushtë i Palit, rezulton se autografi mbisundon me trajtën *Gasper Pali*.

Ky poet për publikun shqiptar, nis me u njohë me nënshkrimin tek poezia *Natë shtrregllash* si: Gasper Kolë Pali. Ma tutje tek "Shkëndija" si: Gasper Pali, tek "Hylli i Dritës" (në sprovën 'Romanzi modern italjan' vjeti XVI 1940, korrik-shtatuer, nnr. 7-9, ff. 388-95) si: Dr. Gasper Pali. Mos me shtue faktin, se ai po botonte në organin e drejtuem prej ish profesorëve të tij të Illyricum-it, e nuk mund të mendohet për lajthitje të t'shkruemit drejt të emnit të tij. Po kështu, në pesë poezitë e botueme në 1944 në revistën "Fryma" si: Gasper Pali, në numrat e parë me kryqin përbri, që dëshmon ndamjen nga jeta. Të gjitha këto përbajnë argumente, që na bindin për emnin e saktë të tij, ngaqë ai në këto vite qe gjallë dhe shkrimet janë nisë prej tij në organet botuese. Megjithatë edhe dy vite ma vonë (mbas vdekjes) poezitë e tij u botuen nga miqtë e Gasprit. Si rrjedhojë, autori njihej mirë prej tyne, sepse me shumicën kishte qenë bashkëstudent në Itali.

Titulli i përmbledhjeve të poezive të Gasper Palit, me vullnet autorial duhej të ishte: *Bisedë me vetvedin*. Deri më sot njihen dy botime të poezive të Palit (*Hyjt mbi greminë*, 1959 dhe *Bisedë me vetvedin*, 2000).

Përmbledhja e poezive në dorëshkrim, që mban titullin *Bisedë me vetvedin*, ka vetëm nji korpus të poezive të këtij autori, siç do ta shohim ma poshtë. Prandej tue u nisë prej faktit, se ekzistojnë dy tituj librash të Palit

si edhe korpusi i poezive me vullnet autorial përban vetëm nji pjesë prej krejtnisë së poezive të trashëgueme nga Gaspri, menduem se ky botim lypej me dalë me nji titull tjetër. Nisun prej kontekstit të jetës së poetit, po kështu dhe nga titulli i nji prej poezive të tij, gjykuem që *Prendimi i andrrimeve* të jetë titulli i kësaj përmbledhjeje.

Rendimi i poezive nuk asht prirë për me pasë kriter ndojfarë kronologjie shkrimore, as me pasë farë ndamjet tematikore, ngaqë numri i paktë i poezive nuk ta mundson këtë. Megjithëse dallohen duer poezish që përvijohen nga nji temë qendrore: *a.* faza fillestare e eksperimentit me sonetin dhe pikëtakimet me traditën klasike të vargut, *b.* faza e studimit jashtë vendit – nostalgjia për vendlindjen e për vendin në përgjithësi, *c.* faza e poezisë erotike, *d.* faza të ndërmjeme – poezi të natyrës meditative.

Çdo tekst i poezisë, që paraqitet në këtë botim, e ka të shënueme në fund (*Shënime*) burimin/burimet që janë marrë për bazë. Simbas radhitjes së burimeve (1, 2 etj.), asht mbështetë dhe paraqitja e poezisë. Prandej, kur të shikohet në fund, jo kurdoherë asht bazik i njejti variant. Edhe pse duhet thanë, se varianti i 2000 asht ma i konsoliduemi, jo për faktin se paraqet poezi që botohen për herë të parë dhe po kështu mbarë landën poetike të Palit, por sepse në të ruhen sheja të vullnetit autorial.

Ndryshimet e bame nga ana e jonë, të cilat u përkasin vetëm ndryshimit minimal (paraqitje fjale, ndreqje të shejave diakritike [si p. sh.: *ajrì* kundrejt *ajrí*], kanë ardhë si rezultat i moskorrektësisë. Vetë poezitë, si në dorëshkrim si të botueme, kanë inkonsekuenca, si p. sh.: konfigurimi i përemnave del me dy trajta: *t'im/e* vs. *tim/e*; *t'onë* vs. *tonë*; *t'eme* vs. *seme*; ose *që* vs. *qi* etj. Ndonji shkitje drejtshkrimore e kemi ndreqë në përputhje me formën vetjake të konfigurimit grafematik të autorit, si p. sh.: *nen* në vend të *nën*, *nersa* në vend të *ndërsa*/*ndersa*, *kerkon* në vend të *kërkon*, *perkund* në vend të *përkund* etj. Flasim kështu, vetëm për atë pjesë poezish që nuk gjenden në dorëshkrimet e Gasper Palit. Pra, e kemi fjalën për dy botimet *H. G.* dhe *B. V.* apo organet e tjera, në të cilat dalin të botueme poezitë e këtij poeti.

Grupet bashkëtingëllore *mb*, *nd* ku në të shumtën nuk dalin, i kemi lanë të paparaqituna. Aty ku dalin janë rezultat i botimit përkatës, ose shkak i inkonsekuencës së autorit. Nuk kemi dashtë me i paraqitë kudo këto grupe ku mungojnë, tue besue në vullnetin e poetit dhe idiolektin e tij (ma fort nji shkodranishte, e mbështetun në parimin fonetik, me ndonji prani ex-shkodranishtet). Në shkrimet mbas '41, këto grupe dalin ma të konsolidueme, sikundër nisin me u zhdukë mirëfilli disa nga shejat

diakritike. Pozicionaliteti i tepruem i zanorës ë, asht synue me u ruejtë, jo me u heqë për me u përputhë me trajtën aktuale të shkrimit të fjalës. Po kështu edhe diftongjet *ue*, *ye* ku dalin të pozicionueme si të tepërta [khs. *sye*, *tue*], i kemi lanë të paprekuna. Bashkëtingëlloret *dh* e *ll* që shkruhen të ndërkëmbyeme simbas variantit gegë të Shkodrës, i kemi lanë si shejë lokaliste e ortoepikës, p. sh. *sjedh*, *drillëse* etj. Rastin e ndajfoljes *kshtu* që del edhe me ë mbrenda poezisë [*kështu*] e kemi lanë të atillë, sepse nuk ndeshet vetëm në nji vend kjo luhatje. Pjesëzën mohuese (s') që tek Pali del (s) me hapësinë, si tek Mjedja a Pipa, e kemi lanë të tillë.

Kudo që del nënshkrimi i vendit të poezisë: *Shkodër*, data përkatëse (por edhe në poezi); emnin e qytetit e kemi lanë sipas trajtës së hershme ortografike: *Shkoder*, dhe në përputhje me të njejten trajtë që del në dorëshkrimin e Gasprit. Njikohësisht, në bazë të nënshkrimit të lokalitetit e datës nën çdo poezi, jemi përpjekë me paraqitë trajtën e përputhshme me dorëshkrimin. Fillimisht vendin e mandej poshtë tij datën. Ka poezi të caktueme që s'kanë as datë e as vend kompozimi.

Mbi dorëshkrimet e Gasper Palit

Dorëshkrimet e Palit, të gjenduna në fondin privat të familjes Ndocaj – E. Ndocajt, të cilat ndihmuen mbi bazën e synimit tonë realizimin e këtij botimi, janë të stabilizueme në fletore dhe letra.

Në dy fletore, kemi të paraqituna dorëshkrime të nji faze intensive redaktimi si dhe nji fazë ma definitive. Janë dy fletore me vija (të thjeshta, me kapakë të zi) që kanë këto përmasa afërsisht: 15 x 20 cm. Në mbrendësi gjendet e shkrueme „Bisedë me vetvedin" – *mledhje poezish*, Gasper Pali (dy raste: *gasper pali*) dhe nji rast Gaspër Pali (*gaspërpali*). Fletorja që paraqet fazën ma definitive (ma e pastër në të shkruem) në krye të saj ka po të shënueme *Gasper Pali*, mbi nji letër të bardhë, shkrue me laps. Përgjithësisht në shkrime asht përdorë stilografi i zi, dhe në raste të caktueme lapsi. Për sa u takon paraqitjes së shejave të pikësimit, kemi të bajmë me trajtën grafike të kohës. Atëherë kur kemi pikëpyetje, pikëçuditje, dy pika, pikëpresje i kemi me hapësinë mes fjalës dhe shejës së pikësimit që vendoset[4]. Ne i kemi lanë sipas trajtës aktuale të paraqitjes së këtyne shejave pikësimi. Pra, pa hapësinë. Kemi respektue kështu vetëm trajtën e thojëzave („"), të cilat

4 P.sh.: „Vall perse u shduken andrrat kaq meiherë ?"

në dorëshkrimet e Palit jepen të drejta (″) e jo harkore.

Në dorëshkrimin, që cilësohet ma definitiv gjenden këto poezi:

Kangë gungallash
Hyjt mbi greminë
Dritë të mshehuna
Natë shkodrane
Vegim mërgimesh
Andrrime fiorentine
Vashë e panjohtun
Bisedë me qytetin t'im
Vdekja e dashunis
Pranë luftës
Udhash së vetmueme
Psalm muzgu
Zane knetash

Në dorëshkimin që paraqet fazën intensive të redaktimit, gjendet të gjitha këto poezi veçse *Vdekja e dashunis* asht e paraqitun me trajtën *Zane stuhish*, që së mbrami *Zane stuhish* del si titull dhe *Vdekja e dashunis* si nëntitull. Në këtë fletore gjenden dhe dy poezi të tjera: *Zemer anderrtare*, *Kanga e poetit*. Pjesa ma e madhe e këtyne poezive, ndryshe nga fletorja tjetër, përfshijnë vendin dhe datën e botimit.

Poezia *Muzgu mendët...*, e cila asht dhe poezia e fundit e poetit, asht shkrue në nji fletë me vija (20.5 x 30.5 cm) gjysa me stilograf të zi e gjysa me laps. Ndërsa *Djepi i vorfen* dhe *Mengjese Shnjergjash*, janë të paraqituna në nji fletë tabak (me përmasat e nji A4): secila në njenen anë.

Vjollca OSJA

"Prendimi i andrrimeve", Gasper Pali
[përgatitur dhe pajisur me shënime nga Lisandri Kola,
Shtëpia Botuese "Dit' e Nat' Libra", Prishtinë, 2015]

Këtu e një vit më parë (siç "këtu e njiqind vjet ma parë kishte me lindë në qytetin e Shkodrës Gasper Pali"), doli botimi i veprës së Gasper Palit, nën kurimin elegant dhe kujdesin filologjik të Lisandri Kolës. Siç ndodh, zakonisht me botimet e librave e specifikisht me këtë tipologji libri, pyetja e parë dhe më e thjeshtë që do të shtrohej, e bërë nën zë dhe me zë, është ajo e tipit:

Pse është i vlefshëm ky botim sot, ose, thënë ndryshe, pse është e rëndësishme të sillet në vemendje ky libër?

Përtej një mijë e një argumenteve që mund të rreshtonim, do na dukej ma e vlerë të gruponim disa syresh që lidhen ma së pari me autorin e poezive dhe së dyti me hartuesin e botimit.

Kështu, në lidhje me autorin e poezive do thonim se ky libër realizon dy synime:

rikthimin në vëmendje të një autori që jep premisa për t'u ridimensionuar historia e poezisë shqipe.

Po ashtu, ndihmon për të nxjerrë nga skajimi ku është depozituar një poet i cili:

a) Ka sjellë në poezi një koherencë toni që të paktë e kanë shfaqur në letërsinë tonë;
b) Ka kultivuar vargun e lirë, paralelisht me Migjenin e ndryshe nga ai;
c) Ka sjellë në letërsinë shqipe modelin e munguar të poetit introspektiv me tema personale e me sondime psikologjike në natyren njerëzore ("Në vargun e këtij poeti takojmë në ndrydhjet e dyshimit, në pikëpyetjet obsesionuese, në problemet e pazgjidhuna metafizike, që i karakterizojnë shumë poetë europianë të sodshëm"- shkruan Qemal Dracini në vitet '40);
d) Ka sjellë një poezi që ka një shenjë të fortë rafinimi e formë solide (mbase shenjë e kulturës që mori duke u arsimuar jashtë, specifikisht për letërsinë);

Së dyti, po shumë me rëndësi për t'u përmendur, ky libër reformon konceptualisht procesin e sjelljes dhe të sjellurit me autorët tanë të traditës, duke sugjeruar domosdoshmërinë e botimeve të plota kritike të autorëve tanë të traditës, sidomos asaj gege, po jo vetëm.

Botimi ka vlerë se kthehet te burimi, gjurmon tekstet autentike, dhe tenton stabilizimin e problematikave të rrafsheve të ndryshme, duke filluar nga emri, variantet e deri te operacionet e pastra tekstore, të cilat e bëjnë komod leximin. Po ashtu, botimin e shoqëron një udhëzues pune, le ta quajmë aparat shpjegimi, nga ku kalojnë të shpjeguara të gjithë filtrat që janë përdorur për t'i sjellë tekstet në formën që ato kanë në libër.

Italia Koka (Mencacci)

Ju rrëfej Gasper Palin

Quhet Italia Koka (Mencacci), nji fiorentine e martueme me nji shqiptar (z. Mikel Koka), dhe ka qenë studente së bashku me Gasper Palin në Firence. Të dy në fakt, çifti Koka, ishin miq të Gasprit. Sot ajo jeton në Romë dhe asht 98 vjeçe. Pavarësisht viteve të saj, znj. Italia, na sjell disa kujtime mbi Gasprin, mbi jetën studentore, aspiratat, vdekjen e poetit.

Znj. Italia, së pari Ju falënderojmë për këtë intervistë që po jepni. Kjo intervistë asht shumë e veçantë për mue si përgatitësi i botimit 'Prendimi i andrrimeve' dhe për publikun tonë, për shkak se jeni bashkëkohëse e Gasper Palit dhe mike shkolle. Në këtë mënyrë, përmes kujtimeve Tueja, mund të ndriçojmë sërish disa aspekte jetësore të poetit – të mbetuna të errëta ose të paplota për nji sërë dekadash. A mund të na thoni si e mbani mend G. Palin në ato vite universitare, që keni ndjekë së bashku në Firence?

Me Gasper Palin jemi njohë në vitin e parë të Universitetit. Ishim në të njejten klasë.

Ishte nji djalë shumë i edukuem, serioz e fjalëpakë dhe për ma tepër ishte njeri që studionte shumë.

Ma sa kam pá në letërkëmbimet me Filip Ndocajn, Gaspri ishte nji njeri i hareshëm e me shumë humor, megjithëse edhe shumë pesimist njikohësisht në momente të caktueme. A asht e vërtetë kjo, apo thjesht mund të jetë nji pjesë e së vërtetës?

Nuk mbaj mend të ketë qenë nji njeri shumë i hapun. Asht e vërtetë që ishte njeri me ndiesi dhe shenja pesimizmi për jetën.

Mbasi mësova për vdekjen e tij në 1942, mendova se pesimizmi i tij qe varë edhe nga gjendja e tij shëndetsore. Për sëmundjen e tij, unë dhe im shoq, mësuem vetëm mbas vdekjes së tij.

Me gjasë kishte frikë se nji situatë e tillë mund t'i prishte marrëdhaniet e tij shoqnore. Edhe sikur ta dinim për sëmundjen e tij, për ne kishte me qenë e parandësishme sa i takon shoqnisë sonë.

Megjithëse asht e vështirë, ngaqë kanë kalue shumë vjet, a mund të na thoni se cili ishte raporti i Gasprit me letërsinë? Interesi i tij? Cilët autorë kishte ma të pëlqyem? Flasim si për letërsinë e huej, ashtu edhe për atë shqipe.

Sigurisht mundem me thanë se ishte nji djalë dashunues i "së bukurës": i artit, i arkitekturës, i letërsisë.

A ndodhte që Gaspri, në mjediset miqsore, të lexonte ndonji poezi të tijën? Nëse ndodhte, kjo ndodhte vetëm për pak miq intimë apo ai ishte i hapun edhe për nji pjesë të miqve, që nuk mund të cilësoheshin si intimë?

Në atë periudhë nuk e njihja gjuhën shqipe, prandej nuk ishin gjana posaçërisht për interesin tim.

Në nji pjesë të mirë të poezive vihet re shumë vendlindje, shumë Shkodër. Sa vend zinte Shkodra ndër bisedat tueja dhe si ndihej Gaspri në nji ndër qyetet ma të mëdhaja kulturore, siç asht Firence?

Gasprit i pëlqente shumë qyteti i Firences. E dashunonte Firencen. Por me e kujtue sot në mënyrë të detajueme, e kam të pamundun. Sidoqoftë, sikurse dhe im shoq, ishin shumë të lidhun me atdheun e tyne.

Në bisedat e tyne Shqipnia, ishte nji temë e vazhdueshme. E njejta ndodhte edhe me miqtë e tjerë, bashkëkombës të tim shoq. Në fakt, im shoq nuk pranoi të qëndronte në Itali, paçka se i kishim të gjitha kushtet. Për mue ka qenë e vështirë ta kuptoja, qoftë edhe sot, përse u nisëm.

Cilët ishin miqtë ma të afërt të Gasprit? Me kë shoqnohej ai ma shumë?

Mundem me thanë se rrinte shumë shpesh në shoqninë tonë (timen dhe të tim shoq, Mikelit). Më kujtohet Filip Ndocaj, të cilin e veçoni në pyetjet tueja, por shumë pak.

Nuk do të doja të gabohesha, por mik i Gasprit ishte dhe Isuf Allamani. Edhe ai u martue me nji vajzë fiorentine. Isufi u pushkatue prej komunistëve.

Me sa jemi të informuem, Gaspri ka qenë dhe personi që Ju ka mundsue njohjen me bashkëshortin Tuej. Si e kujtoni këtë gja?

Shumë herë kemi studiue së bashku me Gasprin. Ishte ai që ma prezantoi Mikel Kokën, burrin tim të ardhshëm. U takuem në Fakultetin tonë të Letërsisë.

Pas fejesës sime me Mikelin jemi takue dhe kemi dalë shpeshherë me Gasprin. Në fakt, Gaspri ka pa' qenë ftue shpesh edhe në shtëpinë time, nga prindët e mi.

Gaspri u rikthye në Shqipni para nesh. Ai pati disa letërkëmbime me Mikelin. Më bjen ndër mend për nji kartolinë që më pat nisë, në të cilën më shkruente: "*...të presim nuse në Shqipni...*".

Morëm vesh për vdekjen e tij disa javë përpara se të niseshim për në Shqipni. Isha martue prej do muejsh me Mikelin. Na erdhi shumë keq, sepse për ne ishte nji njeri shumë i dashtun.

Meqë jemi në këtë pikë të bisedës sonë, a mund t'ju pyesim se si e morët vesh lajmin e vdekjes së Gasprit, dhe si mund ta përkufizoni humbjen e parakohshme të këtij poeti, qoftë në plan njerëzor qoftë në plan artistik?

Më duket se ishim në Romë për disa ditë së bashku me Mikelin. Atje, dikush ia dha lajmin Mikelit. Sigurisht, vdekja e tij e parakohshme ishte e dhimbshme për ne.

Znj. Italia a dispononi ndonji kujtim konkret (libër, dorëshkrim a diçka tjetër) nga ana e Gasper Palit?

Për fat të keq jo. Shumë gjana kanë humbë përgjatë viteve. Di që im bir ka arritë të gjejë disa fotografi, pikërisht për këtë rast.

Meqenëse Ju jeni diplomue vetë për Letërsi, ç'mendim **keni për vlerat estetike të poezisë së Gasper Palit?**

Më duket se kam lexue ndonji poezi të tijën, po shumë vite ma herët, por nuk jam në gjendje t'i kujtoj.

A mendoni se Gaspri do të ishte nji kritik i mirë, nëse do të kishte pasë fatin të jetonte ma gjatë?

Sigurisht që do të ishte nji kritik i shkëlqyem. Megjithatë nuk jam në gjendje ta përfytyroj vijimsinë e tij letrare.

Së shpejti afron dhe 100 vjetori i lindjes së Gasper Palit, a jeni e mendimit se ka prapë për të zbulue nga ky poet?

Nuk e di. Sigurisht që gjithçka do të varet nga dorëshkrimet, të cilët do të jenë në dispozicion dhe nga interpretimet që do të bajnë mbi to lexuesit.

Znj. Italia Ju falënderojmë përzemërsisht për intervistën!

Intervistoi dhe përktheu: Lisandri Kola
Maj, 2015

Gasper PALI
Poezi

Muzg mergimi
Mbi syt t'lodhun, dalkadalë,
nji tymtajë ndehet
Në dhomë nga çdo anë,
hije burojnë e qasen me hap t'ploshtë
Dielli ka mshehë ballin e gjanë.
E poshtë
i njellë zogu zogut, gjumë.
Hije t'hjellta si selví
më murmurojnë:
– Shkëputi syt' e librat treti.
N'ara dil, si dikur fmí. –
E si n'dhomë hijet u ngjallen,
fantazmat murmuritse
njimij kujtime nga fminija m'falen:
– Muzgjet plot kumbonë
kur ngitshim arash të mbulueme nga tymtaja,
n'sa n'qiellë, si syni i jonë,
lshojshim balona. –

Andrrimet tona
kaloshin pertej malit.
E kur dilte hana,
na fmí prej zallit,
balonen, der'hanë, dojshim me e çue.
Sonte, n'sa hijet m'flasin
kerkoj han'n m'e ndesh' persrí.
Por hana, ma nuk m'qeshë
si dikur fmí.
O, e kerkoj hanen
n'sa me 'i gjysë zanit
me i folun hijeve, që më rrethojnë,
por mbi sy m'asht nde tymtaja
Ndjeva se më murmurojnë:

– Eja n'Shkoder, si dikur fmí,
e prep prej zallit
ke me e pa hanen kah çohet prej malit. –
– Iken kush'di – pergjegja – sa prendvera
e sa stuhi shpirtin t'im ma rrenuen
sa tash s'pertrihen stin't, që dikur m'gzuen!

1939

Andrrime fiorentine
Kushtue F. N. (*Filip Ndocajt*)

Mbi t'udh's asfalt, që gjarpnon ngjatë lumi
pushon ndoi dritë e zbetë
e drita hijen t'eme n'kalldram tretë.
E ti o Mik kah hecë me mue
m'a shkelë hijen pa u kujtue.
Kshtu shpirti i jem i shuemi
plagohet nga fjal't tueja.
Ti më peshperitë,
e zani t'humbet me t'Arnit zhumhurë:
„A t'bjen ner mend? Dikur...“
E mue më ngjallen kujtime pa pritë.
Andrroj të Kleydes sy,
si dy hije qiellore.
E si n'vegim e shoh Jolen me ty,
vashen me krrela t'zez
si t'landve danga n'Kashine atje poshtë.
Un s pritem pa të pyetë:
„Vall perse u shduken andrrat kaq meiherë?“
Por ti ma s flet.
Shikon sht'pijat, si kulla mesjetare
edhe degjon kumbonen kah kerset
atje larg në nji torre qindvjeçare.
Zhungllon zani si nji ankim,
që rrshqet mbi buzë t'mjerë:
„Vall perse u shdukkan andrrat kaq meiherë?“
Më pyetë tash tanë trishtim.
Por fjala e jote veshin më perkdhelë,

si jeh, që vjen tu' u shkrî
n't'heshtueshmen melodí
që ty e mue na falë nata fiorentine.
Fjal't tash vdesin mbi buzët t'ona.
E vijojmë bashkë me shetitë
e veç n'asfalt ndiejm kundrat tue kersitë.

Firenze
31 marc 1940

Prendimi i andrrimeve

Zhurma e karrove
meket mbi qelqe t'bardh' të dhomës s'ime,
nga sheshi ktu tue ardhë.
E mbrend' s dridhet n'ajrí
as ma e vogla valë.
E mue andrrimet më bulojnë
e syt' me ndriza hijesh m'avullojnë.
Vegime m'lejnë atherë
në ket mjesditë zhegore.
E shoh, shka s pashë kurr në jetë.
ndiej shka s ndjeva kurr nji herë:
vasha me buz' n't'cillat shperthyen burbuqet,
shtëpija të ndertueme
n'rubina, si mollza fytyrash vashnore,
ku rrshqet gazi, si 'i mij gush' bilbilash.
Por nji za nga fundi i shpirtit më trandë.
Shkyhet tisi i vegimeve t'krijueme.
Me nji herë zhduken lulishtat prrallzore
si hyjt, që shkputen në nji natë verore.
Zani më grishë me jetue
e jo me afrue qepallen me qepallë
e me ndejë tue andrrue.
Më thotë zani: me i kndue jetës,
më thotë zani: me i kndue kohës,
më thotë zani: "Kndoj s'vertetës!"

Shkoder
10 Qershor 1941

Vegim mergimesh
N'shpirtin t'im
rreh malli i Shkoders. Tash që jam n'mergim
kam èt netësh shqiptare.
Pse më perkujtohen mbramjet magjistare
ku çdo jeh në muzg, vdes ashtu meiherë
në t'amblen heshtí.
Ndiej frushullim gjethesh
kah perkdhelë pema pemen me butsí.
Por kur mbas mali zblon ballin e gjanë
hana fytyrë-bardhë,
zane shperthejnë.
Tash s ndiej land't tue peshperitë,
pse hana qejt nga gjumi trazon
e njimij gojë lehin ashtu pa pritë.
E vashat ledhatare
qeshin kah ngrehin shrregullat mijvjeçare.
Perkundë djali e kndon:
"Po ti hanë, pse s'dole mbramë?"
Vasha sheh syt djalosharë,
që qeshen n't'mekten dritë:
"Mbramë, si ti dhe un o djalë,
hanen kam pritë".

Por nuk ngjati shum vegimi anderrtar.
Shdukë andrra n'shpirtin t'im
malli kthen meiherë,
mbassi kerkush nuk kndon per mue n'mergim.

Firenze
7 Maj 1940

Vashë e panjohtun
Qepallat m'janë randue,
e dridhen si dejt n'mallin dashunuer.
Janë lodhë e ma ty vashë s donë me t'shikue.
Por un gjithnji i çeli
e atherë rrahin pa pushue.
E ftyra, 'i pjesë në terr nji pjesë n'dritë

t’asht mytë n’muzgun vjeshtuer.
E ftyra m’duket nji det plot mshehtsí,
që me deshirë më mbushë shpirtin pa pritë.
E syt e mi shkojnë meiherë në sy tue,
e syni jot asht mbushë plot trishtim
si mbushë asht muzgu e njerzit ktu per rreth.
Por syni i djathtë nga hija t’asht mertisë
e un due me e zbulue,
pse n’shpirtin t’im
ka lindë malli per sy tue.
Hana tash shkrepi mbi qepalla t’gjatë
e enden viza mu n’mollza t’faqes s’zbetë,
hije që krijojnë gardhin ndalimtarë,
pse tash nuk mundem mâ
asnjenin sy me pa.

Nji kind buzet të dridhet tash e parë.
Më thotë zemra dishka flet
per mue, me shoqen per brí.
A thue buz’t losin n’pshertimë dashunije?
Por buzët tueja mshehun nga kjo hije,
veç m’bajnë me mendue.
M’thuejë vashë: pse s’asht ditë
me pa shka due me pa?
O perse s’asht natë e pa kurrnji dritë,
e mos të shoh ftyren, q’asht tue m’tundue?
Por syt s t’i dajë o vashë,
pse m’perkujton jeten qysh n’fmini t’parë:
gjithkund kah heci ndeshi veç mshehtsí,
por vijoj udhen me sy anderrtarë.
Kështu vashë,
fytyra e jote forca t’reja m’ngjallë
pse m’bahet se vroj Misterin mu n’ballë.

Shkoder

MARTIN CAMAJ[1*] (1925-1992)

NJI DITË KA EDHE KORBI
Erdhi nji korb te dheu i butë nën shkrepa
Ai s'dinte me ndjekun vallet e pllumbave
Palë e palë nën hijen e ullive.
E u ruente mos me lshuem zâ
Mes gazullimit të përgjithshëm
për mos me prishë
ritmin e flatrave ndër valle.
Kur te e vona pllumbat kthyen në banesa,
e ndieu vehten korbi pllumb
në shpirt

GRUEJA E MALIT
Pasqyra sáj âsht mali përballë.
Grigjen e lëshon e mbrama e prêt,
e grigja vjen.

Mbrama vjen burri. Ai përtyp koret
e rreshkuna të bukës tue këqyr në votër,
nesër ai niset e ndoshta nuk kthèn:
len nji bukë në plang e setrën që s'vlen
e djalin në parzëm të saj tue u rritë
si flaka në votër.

Këtë zjarm e ruen përshpirtshëm, grueja.
e me duer që shkulin bar e thejnë krande
djalin në buzqeshje e lëmòn, grueja,
e din me sý e zâ t'urojë:
"Pas –te nana në plang !"

KISHTE ARDHË PËR MIK
Kishte ardhë për mik nji njeri i hajshëm
e i zbehtë si letra.

1 * Nxjerrë nga vëllimi poetik "Lirika mes dy motive" . Vepra letrare 3. Apollonia, 1996.

Thoshin se ai me dorë të vet kishte vrá
Tre vetë e tash âsht pendue.

E më kujtohet si djè
Qeleshja e tij e bardhë,
Nji sumbëll e kuqe në kraholin e zí
e sjellja e përvujtë e ndeja e tij në shkam
pranë votre para nji tryeze të vogël:
nji të katërt bukë misri e ‘i grusht krypë
kishte përpara- si mbas dëshirës së tij.
“Gjinoj e mbaj çdo ditë- tha ai-
pse fajet e mija tri thika
sa tri maje malesh kërcnuese
kah qiella e Zotit! “

Kojet e bukës krisshin nën dhambët e njeriut
që përtypte trishtueshëm, njerzishëm
e me shije.

ZEF ZORBA

SONTE FESTË
(në binzë)
Sonte festë: shi me shtrëngatë,
bubullimë ere leshjane.
(hënë nuk ka)

Mbi çimento para meje
Rrahin pikat me furi,
thyhet breshëri porsi kripa:
o çimento, si unë si ti.

NJË GOZHDË[2]
Një gozhdë e ngulur thik në mur, një gozhdë
e ngulur thik në mur, një gozhdë e ngulur….

2 Nxjerrw nga: Kuçuku, Bashkim. Antologji e poezisw shqipe bashkwkohore. Tiranw:Onufri, 2008. f. 423- 425, 430,432,

Një gozhdë e futur thellë në mur, një gozhdë
e futur thellë në mur, një gozhdë e futur.

Një gozhdë e mbetur thatë në mur, një gozhdë
e mbetur thatë në mur, një gozhdë e mbetur.

e ngulur thik…
e futur thellë…..
e mbetur thatë…..

HËNË TË REJA
Tesh qiellnash enden
me qindra hënë
të reja.
Njeriu s'krijoka tjetër veçse kobe:
Çelik e gizë e refraktarë;
zogjtë artificialë,
lindur ndër ofiçina-inkubatriçe,
si hëna tokën përgjojnë,
e përpunojnë
epshe tinzare
trofesh e përdhunimesh.

E kush s'i ka te vetat këto hënë, vihet e sendërgjon
namë e terratisje.

PËRTEJ…..
Kjo botë (ruajna Zot!) e rrëshqitura !
Mbi ledhe të fildishta
rreh thik,
e na lëbyren sytë
në kundrim të ngulitur
përtej…
e mbesin shtang.

- ALEGRO FURIOSO

.. .e shpesh kam pa liqenin të shpupurishur:
kundër reve të mbarsura
me shkreptima të dhunshme,
me kordha shkumesh të pareshtura,
me gjithë sa kishte fryme,
sulmonte, e gëmushej;

por shi vazhdoi me ra…..

FREDERIK RESHPJA (1940-2006)[3*]

***

Kur ishin të vegjël
I shkruanim njëri-tjetrit nëpër avionë prej letre.
Tani avionët janë prej duralumini:
Po të tërë janë bosh.
...
Bëje një letër, po jo prej duralumini:
Kam nevojë për ty, jo për metalet.

***

Ikën arlekinët e trembur nënë çatinë e përrallës
Kur putha për herë të parë.
Qau vajza e vogël: por kush e di
Ndoshta qante fëminia. Në kopsht
Nga dritarja e përrallës, arlekinët
Vështronin të trishtuar, tërë lot.
Nuk desha t'i tremb arlekinët e mirë,
Nuk desha, por nuk bëhej ndryshe
Se nën çdo mollë, bile nën çdo dru
Kurdoherë një Evë më priste.

3 * Nxjerrë nga vëllimi poetik "Poeti i Vetmisë". Botimet M&B

***
O ajr i mbrëmjes mbështillmë,
erdhi ora të vdes përsëri.
Kur të mbyllen sytë e mi, nuk do të ketë më det
Dhe varkat e lotëve të mi, kanë për të ngecur në sterë.
Shkoj dhe shirat po i lë të kyçura
Por do të kthehem përsëri në çdo stinë që të
dua.
Unë kam qenë trishtimi i botës.
O ajr i mbrëmjes mbështillmë,
erdhi ora të vdes përsëri.

PRIMO SHLLAKU

Vdekja si dashnore
Shpend të turrshëm
rrugën ma presin
e me krahët si thika,
ballin ma përgjakin.

Turre të thekshme
trupin ma rrëmbejnë
e, në atë theqafje,
ballin ma djegin.

Nji plumb i ftofun
ballin ma rrmon
e, si brumbull i trembun,
gjen rrugë e mshefet.

Pa titull
Jo, jo
na nuk jemi
dashunia e prindëve tanë
gjatë luftës.
Na jemi fryt i nji paqe dinake

ku brini i errët i dhisë
ishte edhe majë,
edhe thikë.
Mos vdis edhe pak.
Jeta âsht për ty po aq
e vlefshme sa kapërcimi.
Tashti e ke rastin.
Ville o pshtŷje shpirtin,
ta lexoj.
Mos ik i padeshifruem
se unë do të kujtoj
se prap po del fjala ime.

Fleta e bardhë
Do të jetë bora
që ka me ra
e vetulla e hollë e mbramjes gurkali
o deti i frymë si hipogastër gulshues,
apo fleta e bardhë do të jetë,
e sigurtë fleta e bardhë.
Ajo mund të jetë
gjithçka që unë mund të jem,
aspak çka duhet,
por çka s'e di se jam
e vesht do ta marr
kur ajo s'do t'jetë e bardhë.

Takim i vshtirë me fletën e bardhë
prej majës së ktij harku ure
që më lshon pingul në ujnat e cekta,
e bardha, e forta
të fletës, të fletës së bardhë,
sigurisht të bardhë, sigurisht
të fletës,
sigurisht i dërmuem eshtnash,
i thyem pa gjak,
sigurisht me gjakderdhje të bardhë
mbi fletën sigurisht eshtën-dërmuese,

ku unë nji ditë mund të shfaqem
para vetes së njoftun si nji i panjoftun,
me ,i hap të lshuem përpara
me ,i dritë të naltë verbuese
mbi vorrezën që përmbaj
tash ka mot
vajtueshëm ditën e klimaksit
kur mitrat mund të
valviten si balona të ngecuna ndër tela.

As mbramja gurkali
as gastarja e hollë e qiellit mbi liqen
as ernat e dritës drejt boshtit të sŷve të mi
s'ma japin sigurinë e rrzimit prej harkut të urës
drejt ujit të bardhë të fletës së sigurtë
që më përpin si qumsht i bardhë skëterre.

RIDVAN DIBRA

Plagët e Moisiut
Të gjithë e kanë harruar Seforën, gruan e Profetit

Po shpalosen qiejt si fletët e librit,
Zoti im.

Të zverdhur nga koha
Por unë them më shumë nga shfletimi i përditshëm
Diku të përthyer, diku të grisur
Nga vetëtimat dhe padurimi ynë.

Ne prapë të verbër si në fillim,
Zoti im.

As edhe një fletë s'ditëm ta lexonim
As edhe një rrjesht, as edhe një germë
Thjesht sepse kërkuam larg dhe lart

Kur alfabeti mësohej afër dhe gjithkund.

Ne prapë të shurdhër si në fillim,
Zoti im.

S'ditëm ta dëgjonim zërin tënd
Habitur ndër një mijë e një zëra të rremë
Kur gjithçka qe kaq e lehtë dhe e thjeshtë
Mjaft që të ulnim kokën e të dëgjonim frymën tonë.

Ne prapë të uritur si në fillim,
Zoti im.

Thjesht sepse lakmuam pjergullën e fqinjit
Dhe kurrë s'e bekuam barin tonë të egër
As globin që s'duhej ta kafshonim
Nxitimthi si mollën e papjekur.

Ne prapë të vetëm si në fillim,
Zoti im.

Hapërdarë gjithandej si kokërrizat e rërës
Prej erës që e ngritën bulçitë tanë
A si fëmijë jetimë pendestarë
Pse ngritën dorë e vranë prindërit.

Ne prapë në pluhur si në fillim,
Zoti im.

Ndër buzët tona, në mushkëritë është pluhuri
Edhe kur fluturojmë kinse lart e larg pluhuri na ndjek
Thjesht sepse përtojmë a harrojmë
Të pastrohemi para çdo nisjeje.

Ne prapë të pastrehë si në fillim,
Zoti im.

Shemben pa u ngritur kasollet tona
As një mijë vjet s'i durojnë zemërimit tënd
Teksa ne fajësojmë me radhë
Herë muret, herë themelet, herë çatinë.

Ne prapë të etur si në fillim,
Zoti im.

Me buzët shkrumb të çara si gushti
Ia thamë burimet jetës një e nga një
Lakmuam e sajuam mandej
Burime të panumurt gjaku.

Ne prapë të paditur si në fillim,
Zoti im.

Thjesht sepse hodhëm hapin e dytë para të tretit
Dhe thamë fjalën e parë pas të dytës
Kështu edhe dituria jonë s'është gjë tjetër
Veçse korigjim i gabimeve të bëra dikur.

Ti prapë gjithkund
Dhe ne prapë askund,
Zoti im.

Arsyet e gjakut i shpërfillëm të gjitha
Harruam edhe britmën e të pikëlluarve
Harruam se plagët e armiqëve një ditë
Dhëmbin më fort në gjoksin tonë.

Dhëmbin në gjoksin tim,
Zoti im.

Gazmend KRASNIQI

Shkodra
Ja, zbritur prej kullash të kaltrive, me këngë floçkash e satirësh
shqipja që vendon gardhin e ditëve, një kopsht që shkon
e vjen nën gjethet e ngrira të bime kurrë të dukshme,
por plot kundërmime, dëshmia se jemi ata fëmijët e vocërr
që luajtëm, në skutat ku flenë fillimi e fundi, me buaj
dalldisur dashurie dardane për detin; ja, rezultati i një takimi,
duke u mbërthyer, duke gjetur zgjidhje drejt ashpërsisë
së buzëqeshjes, duke ngacmuar dritën e bollshme
me sigurinë e saj të fundme, si shqipe që ngurron
e ngurron e pastaj sulet, si filozof që thotë çdo mur
është një portë, si monedha antike dhe lumi i poetikës
së saj të errët, ku peshku i trembur i qenies kërkon dritën
pa moshë; ja frika në pëllëmbë (tashmë kallpe), që vjen
e ikën nga pamja, për vetvetet e tretura te monedha e kohës
zero, ku s'i gjejmë fjalët që do duheshin, edhe pse
e dimë se një ditë hapësira me to do flasë, se për këtë
i ngjet dita librit me imazhe, që rri si një turmë murmuritëse
te dera; dhe ja portreti që s'e varim dot në mur pa ardhur
mjeshtri i disonancës – ja kafshimi yt gjeometrik,
ja pjesët e mia më të buta e më të holla: zemra, për shembull,
se mban më shumë.

Kështjella
Kur isha i vogël, i kujtoja numrin
e betejave të humbura: duhet të jem bërë
shumë i moçëm, që tashti ma kujton ajo mua,
pa më thënë si duken ledhet e mia të zbrazëta,
nga dritarja e autobusit që shket shpejt. Vetëm
turisti i ngeshëm mund të largojë mjegullat, të zgjojë
hapa mbretërish e mbretëreshash, në orën e zhegut
a ngricës, të zgjojë njeriun që sheh te Buna e Drini kohën,
puthje kobtare në brinjët e tokës; ujë që mendon vetëm
për veten para se të rrënojë kujtimin e urave e mureve, ku
vetëm zanoret përplasin shpatat. Edhe një lamtumirë: kam

folur me metrin e zjarreve shkrumbuese - ka folur me asonancën e hijes së rëndë; është shtriqur nën tunikën e tejdukshme të shikimeve - kërkova, mbi kurrizin antik të ujërave, një vezullim, që është legjenda ime, se mos e njoh, kur të shkoj te deti: një kështjellë britme mes ujit e reve.

Litani

ShkOdër, e para ofshamë. FaltOre
E fatit të mbramë.
ShkOdër, jehOnë hyjnOre. MizOre.
SaOra dashnOre.
ShkOdër, që mallin ke fat. MetrOpol
Dhe fshat.
ShkOdër, një bOtë që humba. ObOrre.
Pullaze. Pëllumba.
ShkOdër, ritmim vetiu, në lOdër
Të thirrur prej shiu.
ShkOdër, e bardhë si bOra. Orgji
Që mOshës i mOra.
ShkOdër, një jetë që bOra. Ora
E ndOres dhe kOra
E dritës. E Orlit Ortake. Urtake,
AOrtë prej flake;
Në shkrepje të shpejta të mOtit, dOra
Dhe syri i ZOtit.
PranO pa fitOre, triumfi
- JehOnë Orgjie.
PranO pa nënshtrimin, përulja
- JehOnë e fyerjes.
Sa s'shkOi vOnë, caktO
Ndonjë cOpë
Durimi që ndOshta teprOn
E krijOna.
Ahere një përrallë të rrëfejë
Jetën tOnë,
Jo për atë që gjërat vlejnë,
Por nënkuptOjnë,
Para një zOti: histOri që s'guxOn
të tregOhet pa ne.

Rimurimi
Gjithë ditën po punojmë
E gjithë natën po na rrënohet
Balada e murimit

Na ka ëndërr kjo grua, a ëndërr e kemi,
që, gjithkah të dalësh, vetëm një emër,
i flakur me vrundull balade, popullon
kureshtjen tonë? Mos sillet ajo grua

Kalimesh magjike, atje tutje, shquar vetëm
nga Zoti, mendja hyjnore, që shumë të gjorat
trishtime, gëzime njerëzore t'i duken të thjeshta
aq sa s'i thua pa skuqje? Mos ngul sa mundet

Flamurin e butë të ngulmit midis
mundit e gjumit, ku vuan një bulkth, midis hijesh
që duhen si burrë e grua, në zvarrjen
e ngadaltë të gurëve drejt gjuhës? A ndoshta

Është ai zog i dehur nga dielli që bredh
me nge mbi ne në ajrin e qetë: një pikë
e vogël ku vë fati gishtin, një pikë
e errët ku ngrin kujtesa përjetë? A ndoshta,

Lexues i rastit, anonim, që s'bën gjë
për frymëzimin tim, që s'është rasti i poetit
epik, po i poetit që i mjafton vetvetja, ai afsh
që na djeg duart, nuk është hakmarrja

Prej gurësh e asgjësë, po ëndrra e gruas,
që kërkon në portat e saj
si i hiqet poshtërsia, në erdhi ora,
pyetjes së pavdekshme – si vdiset?

LULJETA LLESHANAKU

Autoportret në tekstil

Jeta është kjo garderobë veshjesh
e zgjedhur me sy, dhe rrallëherë me prekje.

Kjo këmishë mendafshi e paveshur kurrë
pret për një xhaketë mashkullore në supe,
për të mbyllur ciklin e saj floreal.
Kur s'ka ardhur, nuk do të vijë. Hidhe pa frikë!

Kjo pulovër dekolte akriliku
kombinohet me një buzëqeshje dy herë më të madhe se unë,
dhe një smalt të përkryer. Vite më parë, ndodhte e kundërta,
ishte trikoja që i përshtatej buzëqeshjes.
Hidhe, as kjo nuk të bën punë!

Kurse ky fustan, të vetmen herë u vesh në një mbrëmje romantike.
Herën tjetër, (nëse ka një të tillë),
deti të hedh në të njëjtin ishull pas dymijë vjetësh,
e deri atëherë, do t'i ketë kaluar moda.
Hidhe, zë vendin kot!

Kjo bluzë e bardhë është nostagji për të shkuarën;
bluja-për të ardhmen,
të dyja thithin oksigjenin e dhomës gjatë natës.
Hidhi, mos ngurro!

Kjo xhaketë e zezë kadifeje, është blerë me të lirë
në tregun e mallrave të përdorur. Mbaje!
Është gjithmonë më e lehtë fshehja pas lëkurës së tjetrit.

Kjo këmishë ekscentrike me vija bardhë e zi
është një alibi e mirë për t'u ndodhur në dy vende njëkohësisht.
Mbaje! Është vonë për të ndërruar stil!

Kjo pallto e rëndë si mjegulla kontinentale,
dy numra më të mëdhenj, e blerë shtrenjtë dhe me nxitim
për një rast ceremonial,
u var vetëm në korridore të ftohta.
Jam në borxh me të; lërë të rrijë!

Këto këpucë elegante me taka ta larta
nuk e kanë instiktin e kthimit. Hidhi!
Hidhi dhe këto çizme që të sollën fat të keq
që herën e parë. Kanë të drejtë marinarët kur thonë:
“Mos merr rrugë të panjohura me këpucë të reja!”

Ja dhe veshjet ngjyrë gri, të preferuarat e mia,
të padepërtueshme si guri, arrogante.
Të vjetra, por pa to,
jam si qeni me jargët jashtë!

Dhe këtë shall me dhjetëra variacione ngjyrash
si qytete të nxehta kaotike,
ma dhuroi dikush, i cili, përmes meje,
donte të dilte prej radiografisë së vet.
Hidhe; nuk ke vend për të!

Dhe kjo çantë e vockël, që zë fare pak gjëra:
një shami dore, një kuti pomadë për bërrylat
dhe ndonjë numër telefoni.
Mbaje, është alteregoja ende e papërdorur
do t’i vijë shumë shpejt koha!

Po e kuqja? Ç’do kjo pulovër e kuqe në raftin tim?!
Përçarëse, në shkak dhe pasojë.
Çfarë pret; pse s’e hedh?!
Dhe më në fund, veshjet e përditshme, të pambuktat,
Kompromiset e vegjël, që nuk të lënë kurrë në baltë
dhe që nuk kanë nevojë as për hekur.
Dhe të vetmet që nuk alarmohen nga shtimi në peshë.
Mbaji; nuk je e lirë t’i hedhësh!

Në dysheme, hedhurinat avullojnë si një mitër gjigande
gjithë fantazinë e dështuar të një gruaje,
E ato pak pak gjëra që mbeten,
mund të lëvizin lirshëm më në fund bërrylet në raft,
si gondolierët një një rrip të përsosur uji.

Sot e kësaj dite unë pyes veten
nëse po ngushëllohej apo shfajësohej ime më,
kur mërmëriste me zë: "Është stof safi, i qepur me dorë",
sa herë që pastronte me pak benzinë kostumin e saj të vetëm.

Shkallët
Im atë ishte i fiksuar pas shkallëve;
gjithë jetën prish një palë shkallë e ndërto të tjera,
herë nga brenda e herë nga jashtë,
pa e gjetur kurrë mënyrën e përkryer
për t'u ngjitur lart.

Unë gjithashtu.
Prej atje lart ka tjetër pamje: rrugët janë të forta litarë;
kopshtet e fshehur pas shtëpive si kafshime sensuale në zverk,
dhe një pluhur kozmik fsheh rrotullimin e dyfishtë të kalimtarëve:
rreth një ylli dhe rreth vetes.
Dhe ai trau i hekurudhës, me shiritat verdhë e zi,
nuk është më nepërka që të ngjeth mishin.

Sa herë që zgjodha shkallët e shpejta, ashensorin,
ngeca midis dy kateve, në një numër iracional
Pasojat, nuk ia vlejnë të tregohen.
Dhe pasatj shkallët e lëvizshme automatike,
që të dorëzojnë si një pako postare të paprekur në një tjetër epokë,
pa e ditur se ç'ke brenda. Bile as ti vetë nuk e di.

Poezia gjithashtu ishte një mënyrë për t'u ngjitur,
joshje përmes mohimit, *via negativa*,
por dhoma atje në katin e dytë
mbetet akoma e lagësht, e ftohtë, e pabanuar.

Ndërsa dikush tjetër zgjedh të identifikohet me një çjerrje gozhde
në shkallët prej druri, në rininë e hershme.
Ajo, për shembull, tregon shenjat hipotetike të tetanozit në bark
sikur po numëron djemtë që mund të ishin zënë për të.
Nuk e mora vesh kurrë se ç'kërkonte që rrinte me orë e vetme në çati,
atyre mbrëmjeve vere që të ofrojnë më shumë se ç'kanë,
por përfytyroj kërcitjen e trishtuar të shkallëve, zbritjen e saj solemne,
kadencën, si çdo lloj kadence, pa gozhdë, pa kthim.

Ndoshta
Krishtlindje pa borë, Krishtlindje në Graz.
Në këtë orë, me siguri tramvajet e fundit tërhiqen me përtaci
nëpër rrugën"Herrengasse".
Barakat që shesin lëng të nxehtë molle në "Jakomini platza"
tashmë janë mbyllur. Dhe si gjithmonë,
e vonuar në nuhatjen e erës së njeriut,
drita e semaforit, drita jeshile.

Lumi Mur vazhdon garën e tij me hekurudhën
kush e fiton nuk dihet,
por e sigurtë që njëri prej tyre nuk do të kthehet më.

Në katin e tretë të godinës,
zhurmojnë studentët që nuk kanë mundur të shkojnë në shtëpi për festa.
Përplasje enësh, karrigesh, dyersh,
"Ndoshta" e Janis Joplin në sfond, vitet '60,
për të kompensuar verën e re e të lirë
të blerë në supermarket.
Pastaj një shpërthim të qeshurash;
ndonjë dorë e pamësuar, nuk ia del të shkulë tapën.
Shpoti. E dashura e njërit prej tyre duhet të jetë rrugës,
(E dashura gjithmonë është rrugës.)
Heshtje. Përplasje e shkujdesur gotash.
Një melankoli e shtirur zërash djalosharë,
si palmat në hyrje të aeroporteve.

I kam zili. Në dhomën time në kat të parë,
nuk dëgjohet asnjë "Ndoshta". Asnjë "Po qe se.."

Kambanat e dyzeteshtatë Krishtlindjeve
i kanë holluar muret, i kanë bërë transparente, qelq.
Gjithçka që ka brenda, shihet jashtë. Dhe ansjelltas.
Tamam si ajo shishe vere,
që duhet hapur me një lëvizje të vetme e të saktë turriele.
Nuk ka kohë për më tepër.

ARBEN PRENDI

Mes shiut të natës toksore
Trishtim solemn i universit,
me shiun nator rënkon,
në vorre të vdekunit,
të gjallët nën strehë,
pikojnë.

S'mundem m'e marrë një lundër,
të bâhem Noe i botës,
ndaj rri e sodis i pafuqi,
me vênë fundin e gotës.

Dhe notoj n'mendime të ngrysta,
kështu si shumë herë të tjera:
Ç'lajme na bjen Imzot, prej qiejsh,
ç'lajme na bjen eteri, era?!
A duhet të presë njerëzimi kumte të reja,
apo duhen kërkue ato në të vjetrat?!

Absurd solemn i universit,
shtrihet tej pa kuptim.
Mes shiut të natës toksore,
në baltë shuhet një vetimë.

A po rrin afër meje përgjithmonë?
Drizat e trishtimit kanë hedhë rrajë
në fytyrën time të nxime.
Rri, a po rrin afër meje përgjithmonë?

Vetëm puthja jote,
mundet me i shkulë ato,
një herë e mirë.

Mishnat e dhambëve më kullojnë gjak,
nga skorbuti i vetmisë.
Rri, afër meje.
A po rrin afër meje përgjithmonë?
Vetëm puthja jote,
ka barin e shërimit.

Flokët e mi janë pështjellue ma keq
se kallamat e kumit,
në deltinë.
Rri, a po rrin afër meje përgjithmonë?
Vetëm puthja jote,
mundet me zgjue te unë,
vullnetin e burrit,
në hekurat e realitetit të egër,
të lidhun.

Oh, rri afër meje!
A po rrin afër meje përgjithmonë,
derisa vdekja të na ndajë?
Me ndie si shpirti yt i kaltër,
me hy te unë,
rreh me flatër.
Me ndie si artikulohet mendimi,
me u bâ fjalë,
me fërgëllima,
si shpirt që merr me dalë.

Me ndie puthjen tënde,
drejt buzëve të mia zhur,
me ndie jetën që vrujon,
në të tana poret e âmbla të trupit,
të bukur.

II.
Në trishtime shkoja rrugës,
kur dielli bekoi njohjen tonë.
Heshtje, veç valët telefonike pëshpëritën:
Me andrrue,
me u takue,
me ndêjtë afër,
me u njoftë,
me bisedue,
me u dashunue,
me u puthë,
nuk âsht kurrë vonë!
A po rrin pra,
a po më rrin afër përgjithmonë?

... edhe tash mendoj nganjëherë
sa të mjerë
kishim me qenë
po të mos ishim njoftë atë verë.

Kena andrrrue, jena takue, kena ndejtë afër,
kena folë për shumë gjâna të kësaj jete,
kena heshtë e jena puthë kur fjalët kishin mbarue.
A jena pra, dy shpirtnat binjakë,
që rrinë si zogjtë riosha në gemb,
gati me flurue?
Me shkue në dhena tjera,
ku çetat nisen shtegtim
për me rikthye në ma të ngrohtën stinë.

Edhe ma qartë e ma mirë e kena kuptue botën,
dobinë e qiellit për fantazinë,
dobinë e tokës për landën e jetës,
harlisjen e pemëve,
rropamën e reve,
rrjedhën e lumit,
dobinë peshkut që lëshon putargat e langshme

në rrajët e kumit...
dobinë e flakëve të zjarrit,
në hinin e të cilit përtrihet gjithçkafja.
Njêna prej arsyeve të ekzistencës
së njeriut
në tokë:
me dashunue si i pari dhe i fundit.

III.
Kur je ngazëllohem tanësisht,
rrënqethem, të ndiej në eter,
trishtohem kur s'je, bâhem vner,
përgjoj rrugët e mundshme nga vjen.

I thyej xhamat e pritjes krejt,
kangjellat e pikëllimit i këpus.
Dal në udhëkryq me të kërkue,
tue e zgjatë qafën majë çative si struc.

Ti vjen, silueta e brishtë në horizont je ti,
bryma e vetmisë firon.
Atëherë rri, mos ik ma,
rri afër meje përgjithmonë!

2005-2015

ENTELA TABAKU SÖRMAN

Poezitë e ftohta

një bulëz fërgëlluese

një bulëz fërgëlluese
befas në buzë
kur nuk e pret
ose e pret se asht stinë për borë
e njëjta stinë

vit mbas viti mbas viti
por megjithatë asht befas
se veç befasia e çastit na mbetet
tashma
kur gjithshka tjetër asht e pritshme

merre këtë flok bore

merre këtë flok bore
ta kam falë
lene me të ra në qerpik
gëzueshëm
me t'u kacavarë në vështrim
kur më sheh
lene me të ra në hundë
përkëdhelshëm
me t'u fresku në nuhatje
kur më merr erë
lene me të ra në gojë
etshëm
me t'u njomë në gjuhë
kur më puth
merre këtë flok bore
dhe shkrije!

akull akull kjo jetë

akull akull kjo jetë
dikush hap vrima në akull
e peshkon peshq të përgjumun
dikush blen copa akulli
me hollu ithtësinë e jetës
dikush ka qysh në verë
në rradhë të akullores
dikush rrëshqet me patina
e mbërrin bukur në rrotullim
unë jam rritë me dimna të butë
ky akull nuk mban shumë

kur binte shumë borë në Shkodër

kur binte shumë borë në Shkodër
atëherë kur dimnat donin me na e kujtu
si ngrihet gjaku në damarë
tanë fëmijët mblidheshin në oborr
me duer të mërdhime
por me zemër të gëzueme
me ba
mandej me e festu
një burrë bore

e tash kur kjo borë m'i ngrin damarët
për të njëzetin dimën rresht
pyes vedin
si nuk u mblodha një herë
me duer të mërdhime
por me zemër të gëzueme
me ba
mandej me e festu
një gru bore

bora nuk bjen

bora nuk bjen
lëshohet
pa duer
me kryet poshtë
flokë flokë
e merr malli
për ujnat e dheut
me u shkri në ta kur të vijnë pranvera
me i gjurmu me ta gjurmët e dheut
me i buru me ta burimet e dheut
me u varë me ta në ujëvarat e dheut
me u avullu mandej
me avujt e dheut

në afsh
e me u kapë prapë për re
andrrash
që ende s'e dinë të ftohtin e madh
bora nuk bjen
lëshohet
pa duer
me kryet teposhtë
flokë flokë

LEDIA DUSHI

***
ajri pështjellues asht litanì e mbrame
brigjesh t'pandeshuna endet
për diell t'mbaruem e jerm
e nuk lëshohet n'kurrnji za
veç ndjesive i vjen
e shfryn sysh e gjymtyrësh t'errëta
eja eja n'barkën teme
se natë asht nata e dita shëmtì
e un' jam i zi e t'grishi n'barkën teme
zhveshun rremash e shenjash për me u mbërri
me ia ba liqen liqenit

***
mjeseve mundesh me ba sende me driten
me iu ruejt me ba sy e sy e sy për me e gjuejt
mos me marrë frymë mjeseve tue kërkue gjumin gjithkah
mjeseve mundesh me i shtri nji kah nji lutjet gojëlangëta t'mbramjes
t'Zotave t'ngulun t'zhgrehun n'vaj për Lutjen n'kambë
për tana herët që s'i je dhanë qiellit t'territ tue ia zhgulë pemët
mjeseve mundesh edhe mos me u lutë ma mbas diellit që t'ban për lojë
e t'prish për gjumë tue pa ara e ara e ara t'lame n'ar me drapna e drapna e drapna e drapna t'zhdukun

***

si plaset toka mjeseve herët kur drita asht n't'lindun
liqeni sjell veç mjegull e pemët pemët vishen e vishen
me frymë t'këndelluna e t'këndelluna
(që) kishin me këndue mos t'ishte agim
tash sall frymë janë e frymë marrin
që kishin me dashtë sy mos t'ishte agim
tash sall mushkëni t'ruajtuna n'dhè
ngjeshen drujve e barit lëshohen përpjetë
s'kanë qiell as tokë as agim shelbimin
që kishte me qenë edhe sy edhe za
mos t'ishte agim avujsh n'liqe'
çahet toka mjeseve herët
kur drita asht n'vezë e shpendi asht dihatje
agimit n'atë t'thyeme kohe
kur mundesh me gjetë shelbim

***
m'bahet vjen prej nalt shkruhet dritë nën dhè
ai mall i pafund lidhun n'liqe me shpend t'kryem përmbi
mbyllun n'fund gjumë e jerm e jerm
tretem malit me Shtriga tjera tue grish mjegull e shpirt
s'mundem me ndejë ma shumë n'tokë
duhet rruga e gjarpnit për kthim si me iu fut nji fije t'reshme pa fund
asht mirë me u mbushë n'flutra t'çiluna që t'shtrihen nëpër trup
t'ngjisin përpjetë e nuk ndjen ma mish
n'kërkim t'ndoj cope dielli
gjen veç gjakun tand që s'derdhet e s'thahet as ngjeshet kurrkund s'miri

Gjovalin ÇUNI

Kontribut për datën e saktë të themelimit të bibliotekës kombëtare

Artikulli hedh dritë mbi një temë mjaft të debatueshme, atë të krijimit të Bibliotekës Kombëtare. Bazu ndër shkrime të ndryshme të gjetuna në periodikë, dokumenta, libra dhe broshura, synohet të skjarohet data e themelimit, fondi bazë mbi të cilin e kriju kjo bibliotekë, drejtuesit e saj ndër vite dhe godina ku u vendos ma së pari.

Artikulli është një homazh, për Profesor Karl Gurakuqin, një nga themeluesit e kësaj biblioteke, njeriut që të tanë jetën e vuni në shërbim të arsimit kombëtar dhe gjuhësisë shqiptare, në veri dhe në jug të Shqipërisë, por edhe midis arbëreshëve të Siçilisë dhe Kalabrisë.

Deri më 2010, data e themelimit të Bibliotekës Kombëtare ishte 10 dhjetori i vitit 1922. Në mujin korrik të 2010-s, zotni Aurel Plasari, ish-drejtori i Bibliotekës Kombëtare, shtypi dhe opinioni vendas njoftuen se data e themelimit të bibliotekës, bazu në konsultimet e shtypit, por edhe të dokumentave të tjera ishte saktësisht, 10 korrik 1920, pra, në muejt e parë të vendosjes së Qeverisë shqiptare në Tiranën e saposhpallun krŷeqytet. Në këtë logjikë në vitin 2015 u festu 95- vjetori i themelimit të B. Kombëtare. Natyrisht, tuj respektu drejtuesit e fundit të B.K, si dhe bashkëpunëtorët e tyne shpresoj që 20 dhjetori i vitit 1920, ka me kenë mâ së fundmi data fikse e krijimit të këtij institucioni. E nënvizoj këtë fakt mbasi deri më tash, festimet e përvjetorëve të krijimit të bibliotekës janë shoqënu gjithnji ndër vite me polemika.

Shkaku i polemikave âsht i ditun, ka ardhë pikërisht prej datës së themelimit, e së bashku me atë edhe burimi i fondeve që e kanë kriju, emnat e drejtuesve të saj ndër vite, godina ku âsht vendosë etj.

Studiues të bibliotekave shqiptare, por edhe në botime, që për kah rëndësia munden me u cilësue dokumenta, japin data të ndryshme të themelimit të bibliotekës.

Po paraqes mâ poshtë disa burime publicistike, në të cilat data e krijimit të Bibliotekës Kombëtare sillet rrokull viteve ‘20, të shekullit që sapo kaloi, pra 1920, 1921-1922, 1922 e 1923.

Në broshurën “Bibliotekat e Shqipërisë”, botim i Shoqatës së Punonjësve të Bibliotekave, data e themelimit shënjohet 10 dhjetor 1922, (në variantin anglisht shënjohet 10 dhjetor 1920). I të njâjtit mendim janë edhe P. Tako

e E. Domi, që në zânin Biblioteka Kombëtare në "*Fjalorin Enciklopedik Shqiptar"*[1] caktojnë përsëri si datë themelimi, 10 dhjetor 1922.

Në fletët e "Hyllit të Dritës", Bardhyli (alias Llukë Karafili), nismëtari i parë i studimit të bibliotekave shqiptare prej lashtësisë deri në vitin 1944, tuj na dhanë njoftime për bibliotekat e Tiranës, sa i takon "Bibliotekës Kombëtare" shkrunte: "*Në vizitën time që i bëra Drejtorit të kësaj biblioteke dhe Z. Tij (autori nuk jep emnin- shën.im)pati mirësinë e na shpjegoi gjithë sa e pyetëm. Biblioteka Kombëtare u themelue në vitin 1921-1922 prej Ministris së Arsimit Kombtarë"*[2]

Ma tej, në botimin "Shqipnija më 1937: *Veprimi shtetnor gjatë njëzet e pesë vjeteve të parë të vetqeverimitë". Vol.I. shkruhet: "Ideja e themelimit të nji biblioteke në Tiranë ka qenë për herë të parë në vjetin 1922. Me përkujdesjen e Ministrisë së Arsimit, e cila ka pasë formue nji bibliotekë qysh në kohë të drejt. Përgjith. Të Arsimit me 1917-19 në Shkodër, në vjetin 1922 asht bamë edhe nji grumbullim librash shumica dhurata, të cilat formuen bazën e Bibliotekës Kombëtare të ardhshme*.[3]

Polemikat rreth datës së krijimit të Bibliotekës Kombëtare u rigjallnuen edhe nji herë mbas kremtimeve të bâme me rasë të 40- vjetorit të themelimit të kësaj biblioteke, në Tiranë, më 24 shkurt 1963.

Gazeta "Drita" e asaj kohe njoftonte mbi mbledhjen kushtu 40- vjetorit të krijimit të Bibliotekës Kombëtare, organizu me 18 shkurt 1963, me pjesëmarrjen e Zv/kryetarit të parë të Këshillit të Ministrave dhe ministër i Arsimit dhe Kulturës shokut Manush Myftiu dhe sekretares së Komitetit të Partisë për qytetin, (e Tiranës- shën. im) shoqes Fiqiret Shehu. Nisun nga ky njoftim del nji datë e re e themelimit të biliotekës, viti 1923.

Ky njoftim nuk kaloi pa reagime. Kësaj radhe reagoi në fletët e revistës "Shenjza", Karl Gurakuqi, njeni nga nismëtaret e krijimit të bibliotekës e muzeut kombëtar. Tuj marrë shkas nga njoftimi i mësipërm ai hedh poshtë këtë datë tuj hjedh dritë rreth dy datave, që lidhen me krijimin e saj, atë të krijimit të bërthamës së bibliotekës viti 1920, dhe datën e saktë inaguruese, 28 nanduer 1922.

Qe çka shkrunte ai: "Më 11 mars 1920 ushtrija franceze me në krye gjeneralin Bardi de Fortou e la Shkodrën, qi e pat mbajtë nën sundim, qysh

---

1 Fjalor enciklopedik shqiptar . Bot. i ri. 1. Tiranë:Akademia e Shkencave, 2008. f. 240

2 Karafili, Lluka (Bardhyli) "*Historija e bibliotekave në Shqipëri*". H. D. 1940-XVIII. Vjeti XVI. nr. 2, f.55.

3 "Shqipnija më 1937… ... Vol.1". Tiranë, 1937, f. 185.

prej vjetit 1918, atëherë kúr Austriakët patën qênë terhjekë nga qyteti. Po atë ditë mbasdreket krejt populli i Shkodrës, me të madh e me të vogël i primë nga Sulça Beg Bushati dhe Shuk Sarreqi, i doli para tek Ura e Bahçallekut, nën rrënonjat e Kishës së Zojës së Këshillit të Mirë, Ahmet Zogut, i cili, si ministër i Punëve të Mbrendëshme, n'emnin e Qeverisë së Tiranës mori në dorëzim për t'a bashkue me trupin e Atdheut. I nënshkruemi i asaj kohe vepronte si mis e sekretar i Komisis Letrare, e cila kishte pasë vú themelet, nën drejtimin e Luigj Gurakuqit, njij Bibjotheke albanologjike tue mbledhë veprat mâ ne shêj t'albanologjisë. Në nji pjekje qi pat me Zogun, u poq mendimi për t'a shpërngulë në Tiranë, bibljotheken e Komisis. Nuk vonoi shumë dhe ministri i atëherëshëm, Sotir Peci me shkresë zyrtare, percjellë me dy gisht letër private, i lutej të nënshkruemit të gjente mënyrën për të sjellë në kryeqytet të gjitha orendit dhe arkivin e ish-drejtorisë së përgjithshme t'arsimit, e cila kish pasë veprue në Shkodër gjatë pushtimit austriak nën kryesin e Luigj Gurakuqit, ashtu edhe bibljothekën e Komisis Letrare. Aso kohe mjetet e transportit ishin të pakta e të pamjaftueshme; udhëtimi i njerzvet për në Tiranë bâhej me karrocë e zgjaste tri ditë të mira. Nuk mbetej tjetër rrugë veç ajo e dedit, por edhè kjo me shumë pengime. Zûna me qirá nji barkë të madhe me vela Ulqinakësh, e, nëpër Bunë e gjatë bregut të Adriatikut mbas tri ditësh e mbas tri netësh, mërrijta në Durrës. Prefekti i qytetit Rexhep Jella, u kujdesue për dërgimin e plaçkavet në Tiranë, në ministrinë e arsimit, e cila i kishte zyrat e veta në nji nga shtëpijat e Selim Stermasit në Rrugën e Postës. Ishte kjo nji shtëpi katër kthinash të vogla sá me t'u marrë fryma, me dritore si biruca që lëshojshin dritë sá mos me thye qafen, me pak orendí edhè këto të vjetrueme; në këto oda punojshin katër-pesë nënpunës; nji sekretar, nji protokolist, nji arkivist, nji shërbtuer... e nji ministër.

Në njênën nga këto oda u vendosen raftat me librat e sjellun nga Shkodra; këta qenë nisërza (fillimi) e asaj qi mâ vonë e muer emnin "Bibljotheka Kombtare", që do t'i hapte dyert e saj me 28 nânduer 1922". [4]

Prej citimit të masipërm po veçoj dy grimca konstatimesh: "nisërza" (fillimi) që asht viti 1920, (datë që përkon me 95-vjetorin e sotëm të bibliotekës), dhe datën e inaguruese 28 nandorin i vitit 1922.

Grimcën e parë po e trajtoj ma poshtë tuj vijue me përcjellë kujtimet e Gurakuqit: "Mbas Sotir Pecit u zgjodh ministër i arsimit Rexhep Mitrovica, njeri i vullnedshëm, përparimdashës, me pamje të largta dhe nisjatuer punësh

4 Gurakuqi, Karl. *Nji përgjigje revistës Drita të Tiranës*. Shejzat VIII/1964, nr. 3-4, ff. 86-87

të dobishme. Në kohën e tij ministria e arsimit u shpërngul nga shtëpia e Selim Stermasit e padenjë për një ministri në shtëpin e Abdi Toptanit, në Rrugën Pjetër Bogdanit, e cila ma vonë pat qenë ble nga Viansone, qi e shëndrroi në bujtinë me emnin "Continental". Shtëpia ishte e gjanë, me shumë oda, me një kopësht të madh përpara. Në pjesën përdhese ishte një salon i madh nga ana e rrugës; këtu u vendosën librat e Bibljothekës së arsimit, e cila kishte ardhë tue u pasunue me botime të ndryshme të bleme apo të dhurueme; kujdesin e saj e pat i nënshkruemi, deri sa kjo me 28 nanduer u përurue e muer emnin: "Bibljotheka Kombetare".

Për grimcën e dytë, pra për përurimin, K. Gurakuqi shkruente: "Në ket përurim morën pjesë të gjitha auktoritet e vendit tue fillue te ministrat, prefekti, kryetari i bashkisë, dhe nji shumicë e madhe populli. Fjalimin e rasës, e mbajti ministri i arsimit Rexhep Mitrovica e fill mbas tij foli shkruesi i këtyne radhëve tue theksue randsinë e bibljotekave për kulturën e Komit". [5]

Pa dashtë me i hý polemikave, mendoj se "nisërza" (fillimi) ishte Biblioteka e arsimit drejtimin e të cilës e pati Karl Gurakuqi. Nëse historia e Bibliotekës Kombëtare fillon në vitin 1920, atëhere padyshim duhet bâ edhe një ridimensionin e figurave, që e drejtuan këtë bibliotekë.

Karl Gurakuqi siç u lexua, nuk e emnon vedin drejtor të bibliotekës kombëtare, por drejtues i përkohshëm i Bibljotekës së Arsimit, e cila falë kontributeteve të tija personale dhe eksperiencës së fitueme gjatë viteve 1917-1919, do të shëndrrohej në "Bibljothekë Kombëtare". Nëse si datë themelimi merret dhjetori i 1920-s, atëhere i takon Karl Gurakuqit me kenë Drejtori i parë i kësaj biblioteke, e jo drejtor i parë i përkohshëm, siç e cilësonte vedin .

Por përsëri mbesim në qerthullin "nisërzave" (fillimeve) dhe përurimit. Asht 1922-shi, viti që daton jo vetëm themelimin e Bibliotekës e të Muzeut Kombëtar, por zgjidh edhe problemin e Drejtorit të parë, të këtyne institucioneve që ishte Viskë Babatasi. Kjo pohohet nga K. Gurakuqi, por edhe nga dokumentet e kohës.

Viskë Babatasi, me një detyrë të dyfishtë, drejtor i bibliotekës dhe i muzeut pati kenë një personë e diskutueshme në drejtimin e institucioneve. Në vitet që pasun, pra nga viti 1928 kur u thirr nga Zogu për me drejtue bibliotekën filologu beratas Sotir Kolea e deri në vitin 1937, biblioteka dhe muzeu u vendosën në baza të vërteta shkencore të kohës, aq sa sipas shkrimeve biblioteka arriti për të parën herë me botue të përvjetshmet e punëve të saj.

5 Po ai: Po aty

Biblioteka e Komisisë në dritën e dokumentave.

Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës (1916-1918) krahas trajtesave filologjike, një kujdes të veçantë i kushtoi edhe problemeve kulturore, mes të cilave vlen për t'u theksû organizmi i bibliotekës, nismë e Kryekomandës austriake të pushtimit.

Në regjistrin e protokollit të Komisisë Letrare Shqipe, datë e themelimit të kësaj biblioteke âsht 16 prilli i vjetit 1917. Në protokollin e kësaj dite shënjohet: "Morën pjesë në këtë mbledhje: z. Gurakuqi, Mjedja, Logoreci, Mosi, Naraçi. Me 16 të prillit u themelue bibliotheka e Komisis letrare d.m.th bibliotheka e Shqipnis. Kryekomanda i kishte çuem Komisis nji letër me Nr. 1106, me 28.3.1917, qi foli përmbi trajtimin e bibliotekës së Komisis. U vendue: I ngarkohet Z. Mosit me marrë listën e libravet, qi kanë "shtypshkronjat" "Nika" dhe "Zoja e Papërlyeme".[6]

I pâmë me vëmendje, dokumenti nxjerr në pah disa gjâna, që për momentin mendoj se nuk janë trajtu si duhet. Mâ së pari, nëse pohojmë se B. Kombëtare u kriju tûj u bazû në fondet e bibliotekës së Komisisë, atëherë duhet shënjû edhe rolin e Austrisë në themelimin e kësaj krijese. Krahas personave, që morën pjesë në themelim të tërhjekë vëmendjen edhe terminologjia e përdorun në këtë rasë: "Bibliotheka e Shqipnis". Tuj pâ shumicën e pjesëmarrësve mendja na thotë se kjo terminologji mund të këtë karakter lokalist, kjo e lidhun edhe me zonat e pushtimit austriak, por tûj ju bashku mendimit të S. Pecit (publicist, pedagog, dhe autor tekstesh, nga Korça) për këtë çështje, atëhere mundena me pretendue se Bibliotheka e Komisis ka kenë e para bibliotekë publike shqiptare, që në terminologjinë e kohës pëlqehej me u emnue në ngjasim të bibliotekave austriake: "Bibljotheka popullore shqipe të lirë ".

Biblioteka qysh nga themelimi u bë shpesh objekt i diskutimeve dhe vendimeve të rândësishme të Komisisë për mbarëvajtjen e pasunimin e saj . Në mbledhjet e datave 1.5.1917; 25.6.1917; 26.6.1917; kuvendohet mbi çështje administrative dhe të pâsunimi të saj. Për me majtë rregullin e bibliotekës caktohet drejtues Hil Mosi. Librat e grumbulluem në zbatim të urdhnit Nr. 1106, të Kryekomandës, duheshin me u inventarizu. Biblioteka kishte me mbajtë evidencë dhe administrue simbas mënyrës së caktueme prej Komisisë.[7] Kujdes i veçantë ju kushtu edhe shtimit të fondeve të bibliotekës tuj ble libra të rinj, që flasin për Shqipni, "…prej librëtores … Wienë"[8]

6 Osmani, Tomor. Komisia letrare shqipe në Shkodër. 1916-1918. Shkodër: Camaj-Pipa, 2009.f. 187.

7 Po ai:Po a ty. f. 185.

8 Po ai:Po a ty. f. 197.

Dy momente të tjera të rândësishme në veprimtarinë e bibliotekës së Komisis janë: të caktuemit me vendim, për herë të parë në Shqipni i kopjes së detyrúeshme për bibliotekat, si dhe puna për vlerësimin e mbikqyrjen e botimeve të reja.

Në mendimin personal vendimet kanë lidhje me mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe me cilësinë e botimeve. Në procesin e mbledhjes datë 1.5.1917, me pjesëmarrjen zz. L. Gurakuqi, S. Peci, M. Logoreci, H. Mima, H. Mosi, Nd. Paluca dhe K. Naraçi, për organizimin e bibliotekës lexohet: "Vendohet edhe me ju lutun Kryekomandës të çpallë nji urdhen qe seicili auktor a editor të jetë i detyruem me i dhanë bibliotekës nga dy eksemplarë gratis të çfare do botimit", ndërsa në mbledhjen e datës 7. 12. 1917, bibliotekës i caktohet edhe zhvillimi i literaturës shqipe, "tue botuem vepra shkrimtarësh dhe vjershtarësh shqiptarë që së janë shtypë ende"[9]

Komisia Letrare Shqipe u shpërnda më 1918, dhe librat e bibliotekës u tjetërwsuan**.** Nji grup studiuesish shkodranë, tuj na paraqitë për herë të parë në vjetin 1961, nji histori të plotë të bibliotekave të Shkodrës, sa i takon trajtesës së masipërme shkruejshin: "Ish pjestarët e nënpunësit e Komisisë Letrare Shqipe, bibliotekën e saj ja kaluen një shoqnie së re kulturore, të krijueme në vj. 1919 nën emnin "Vëllaznija", nën drejtimin e Hilë Mosit. Përgjegjës biblioteke ishte Kolë Kamsi.[10]

Përfundoj me mendimin tuj ritheksu faktin të dijtun se jo vetëm biblioteka e Komisisë, por edhe biblioteka e shoqnisë "Vëllaznija" e pasunueme tashma ishin pararendëset e Bibliotekës Kombëtare të krijume tashma më 1920.

Epilogu

Shpreha disa mendime personale, që më lindën si refleksion pozitiv i festimeve të 90 dhe 95, vjetorit të këtij institucioni të pakrahasueshëm kulturor të vendit tonë. Personalisht vlerësoj shumë punën e bâme nga drejtuesi i kësaj biblioteke, Prof. dr. Aurel Plasari, ndihmësja i tij e zonja Etleva Domi, drejtoresha e sotme Prof. dr. Persida Asllani, si dhe nga çdo pjesëtar tjetër i stafit të kësaj biblioteke që në vite mbetën përherë për ne, punonjësit e bibliotekave në qarqe, shëmbulli që duhet me u ndjekë në sfidat që bibliotekat kanë në kohët e sotme.

---

9 Osmani, Tomor . Komisia letrare shqipe në Shkodër (1916-1918). Shkodër: Camaj-Pipa, 2009. ff.189

10 Grup autorësh. "*Kontribut për Historinë e Bibliotekave të Shkodrës*". Almanaku Shkodra, 1961, nr.1, f. 105.

Nush GURAKUQI

Mbi krijimin e Bibliotekës Shtetnore
- Tregim gojor nga Nush Gurakuqi -

Tregimi gojor i Nush Gurakuqit, ish - nënpunës i Bashkisë Shkodër, i bâmë në vitin 1972, hedh dritë mbi krijimin e bibliotekës së Bashkisë. Përmes kujtimeve, N. Gurakuqi pasqýron hapat dhe punën e bâme për organizimin dhe funksionimin normal të bibliotekës.

Pjesa mâ e madhe e librave të kësaj biblioteke ruhen në ditët e sotme në fondet e bibliotekës së qytetit, që vijon me kenë në varësi të Bashkisë Shkodër.

N. Gurakuqi me dëshminë e tij, ndihmon në përcaktimin e datës së krijimit dhe të ndërtesës ku u vendos së pari biblioteka.

Pas vitit 1944 biblioteka u njoh me emnin "Biblioteka Shtetnore", ndërsa në vitin 1968, mori emnin "Marin Barleti".

Me dt. 15. 9. 1972

Në vjetin 1929, rreth muajit marc, jam emnu nënpunës në Bashki Shkodër. Në sallën e pritjes së Bashkisë karshi rrugës së Shtëpisë së Kulturës (dikur rruga e spitalit civil të Shkodrës) kur shkova unë nënpunës pata gjetë dy rafta të vegjël xhamash me libra e revista. Shumica e këtyne librave ishin në gjuhën frange e ma pak në italisht dhe thuajse aspak në gjuhën shqipe. U interesova prej kah kishin ardhë këta libra, mbasi, në atë kohë unë kisha pasion të madh për librin. Më thanë, së këta libra ishin bâ dhuratë o prej autorëve, o prej shtëpive botuese. Përmbajtja e këtyne librave (në sasi rreth 500 copë), ishin kryesisht romane. Lexoheshin tek-tuk prej ndonji nënpunësi aty brënda në sallë dhe nuk nxjerreshin jashtë.

Tuj u interesue, se kur mund të ishin grumbullu ata libra, m'u tha, se së bashku me rafta ata gjindeshin në atë sallë rreth 2-3 vjet mâ parë, d.m.th kah viti 1925-1926, dhe nuk janë grumbullue me asnji qëllim, që të përbâjshin ndonji bibliotekë popullore, por ishin si stoli vetëm për Bashkinë.

Në vjetin 1929, sapo shkova unë në Bashki, u interesova për këtë bibliotekë të vogël dhe mbasi i bâna nji sistemim modest, aq sa ma lejojshin kushtet e kësaj biblioteke, botova disa shpallje, me anë të cilave lajmërova qytetarët se "në Bashki kemi themelue një bibliotekë të vogël që âsht lanë

në dispozicion të lexuesve dhe njiheri i ftojshe atá me bâ dhurata për t'a pasunue këtë bibliotekë".

Dhuratat filluen. Kryesisht dhuruen shtypshkronjat e qytetit dhe ndonji privat. Në këtë mënyrë librit të huej që ekzistonte në bibliotekë ju shtû edhe libri shqip, i botimeve shqiptare. Unë propozova me e mbajtë unë ketë bibliotekë dhe me i shërbye lexuesve krahas punës që kisha në Bashki, si nënpunës, tuj shërbýe të shumtën e herës jashtë orarit, veç si e si të lexoheshin librat. Kur pashë gjëndjen se Biblioteka erdhi tuj u rritë dhe raftat e vogjël u mbushën dhe sasia e librit u dýfishu, i propozova kryesis për caktimin e një lokali të përshtatshëm me kriju një bibliotekë popullore, për qytetin. Propozimin e pranoi kryesija e Bashkisë dhe lokali u caktu në një kafe që ekzistonte qysh në kohën e pushtimit turk, në vendin që thirrej "Miletbahçe" (sot lulishtë popullore, karshi kafes "Park"). Lokali ishte i rrumbullakët, e për këte arsye edhe i mbet "rrumbullaku i Miletbahçes".

Kah fillimi i vjetit 1930 i bárta librat nga Bashkia dhe i çova te rrumbullaku i Miletbahçes. Unë, 2-3 muej përpara, kisha marrë masat për pasunimin e lokalit të ri me banakë, rafta dhe banka për lexuesit. Kryesija vendosi të emnonte nji kuadër për bibliotekën, pikërisht Jonuz Shkrelin, që kishte me u pagu si kuadër provizor dhe jo nënpunës definitiv me rrogë mujore. Unë e kisha këtë bibliotekë në mbikqyrje së bashku me kuadrin, megjithëse nuk ishte detyra e jeme, por e bâna ma tepër për me i ardhë në ndihmë Jonuzit, mbasi ishte i ri në një punë të tillë, dhe të merrte kuptimin e një biblioteke qytetare.

Në këtë rasë erdhi në Shkodër, Ministri i financave të Italisë, Thaon De Revel, dhe erdhi për një vizitë në Bashkinë tonë. Mbas bisedave që bâni me Kryesinë afroi ndonjë ndihmë, se në çfarë mund të kontribuonte për Bashkinë e qytetit. Unë i sugjerova kryesis që t'i kërkonte dhuratëEnçiklopedinë e madhe të Treccani-t të përbâme prej 36 volumesh. Kryesija ia kërkoi. Ministri menjëherë pranoi këtë kërkesë dhe premtoi se sapo të kthehej në Itali kishte me na dergue.

Mbas pak koheençiklopedija erdhi në Konculladën italiane dhe më njofuen qe t'a merrsha.Ençiklopedia u muar dhe ishte e para që hyni në Shkodër, mbasi nuk e kishte as biblioteka e françeskajve dhe as e jezuiteve. Shenjoj, se për ketëençiklopedi u bâ një raft i veçantë me xhama dhe, me qëllimin e mirë, që të mos strapacohej te rrumbullaku, u mbajt në zyrën teme dhe kush donte të konsultohej me atë j'a jepsha unë dhe punonte me të në sallën e madhe.

Kur shkoi biblioteka te rrumbullaku në vjetin 1930, mbas shpalljeve

që unë kisha vu nëpër rrugët e qytetit, vijuen të vijshin dhurata libra, dhe u shtuan raftet në një farë mase. Librat lexoheshin prej shumë nxanësve dhe studentave. Librat nuk nxjerreshin jashtë, po lexoheshin aty brënda. Orari ishte paradreke dhe mbasdreke. Mund të silleshin për lexim, në ditë dikund rreth 50 vetë. Jonuzi u porosit që të mbante një lloj statistike për me ditë se sa frekuentues kishte biblioteka. Tuj gjyku përafërsisht sa mund të ishin anëtarët e rregullt të lexuesve gjatë vjetit, delte se ishin rreth 400-500 nxanës dhe studentë dhe mes tyne ma pak nënpunës, që lexojshin rregullisht.

Tuj pâ se u banë deri në 6 rafta me libra (rafta 2 që kishte bashkija dhe 4 që u shtuen si etazher të mëdhaj) me një sasi rreth 1500 libra dhe revista dhe tuj pâ se po shtohen lexuesit dhe lokali ishte tepër i vogël, i propozova përsëri kryesisë për një lokal të ri. Kryesija e aprovoi propozimin tem, por ne nuk gjetëm asnjë lokal të përshtatshëm për të. Kështu erdhi pushtimi i Shqipnisë nga Italia dhe lokali i bibliotekës mbeti njatu ku ishte.

Më kujtohet se librat i kishin nda pak –a shumë me këtë kriter: simbas gjuhëve, simbas gjinive: romanet në vedi, librat historikë në vedi, shkollorë në vedi, politikë në vedi, revistat në vedi etj. Librat janë inventarizu kurse lexuesit kur merrshin librin i shënjohej emni i tyne në pusulla të veçanta.

Mbaj mend se mbas Jonuz Shkrelit, i cili ka ndejë rreth 6-7 vjetë si bibliotekar, ka ardhë mbas tij Pjetër Radoja. Mbas Pjetër Radojës, Shyqyri Haveri, i cili, ka kenë i fundit që dij unë, deri në prak të çlirimit.

Këto kujtime po i jap si kontribut për historikun e themelimit të bibliotekës popullore (sot Biblioteka e Shtetit)

Nush Gurakuqi
Firma

HELIDON SOKOLI

Mozaiku i shek. III-IV, zbuluar në Shkodër dhe ekspozimi i tij

Në historinë e lashtë të artit pamor gjejmë shembuj të përhapjes së hershme të mozaikut. Ai lindi si art i ri me pika takimi me artet e tjera, por edhe me dallime në kuptimin estetik e teknik.

Mozaiku, duke mos u larguar nga natyra e pikturimit me material të gurtë, në përshtatje me kërkesat ideo-estetike të kohës, gjen forma të reja shprehjeje, motive, ngjyra e figura artistike me prirje kryesisht zbukurimi. Ky art i ri përdorej kryesisht në ndërtime me karakter shoqëror ose privat, duke u ekspozuar fuqishëm në harmoni me kërkesat social-ekonomike. Ai vlerësohej si arti më i kushtueshëm për kohën. Mozaiku u shndërrua shumë shpejt në tregues edhe të rangut shoqëror apo politik të individëve që vendosnin të zbukuronin banesat me të tilla objekte.

Mozaiku historikisht përbën lidhjen më të gjallë mes kohës së vjetër dhe asaj të re, si një trashëgimtar i denjë i artit plastik. Tiparet klasike të tij mbyllen në fillim të erës sonë dhe rigjallërohen sërish me fizionomi të re me lindjen e kristianizmit. Në Shqipëri e gjejmë të zhvilluar këtë art që në shek. IV pr. Krishtit. Ai ndikohej kryesisht nga arti grek e më vonë ai romak. Materiali bazë është kryesisht guri natyral (gëlqeror) por shpesh dhe guri me ngjyrë. Periudha romake është ajo që zgjoi interesin në dekoracionet kryesisht gjeometrike dhe floreale siç është dhe mozaiku i zbuluar në Shkodër. Në periudhën e Justinianit kemi një shpërthim të artit paleokristian dhe një shtim të ngjyrave dhe të materialeve si brumë qelqi.[1] Në këtë artikull do të marim në shqyrtim të vetmin mozaik të zbuluar deri më sot në rajonin e Shkodrës.

Gjatë fushatës së gërmimeve të ndërmarra në bregun e majtë të lumit Drin, poshtë kodrës së Kalasë në vitet 1978-79, nga Prof. Skënder Anamali dhe arkeologe Hena Spahiu u zbuluan një sërë strukturash dhe banesash të periudhës së antikitetit.[2] Ky përqëndrim banesash tregonte për një lagje të banuar kryesisht në periudhën romake[3] nga kolonë të rinj (Fig. 1).

---

1 G. Hoxha, *Scodra dhe Praevalis ne Antikitetin e vonë*, Shkodër, 2003.

2 S. Anamali (1979 – 1980) "Antikiteti i vonë dhe mesjeta në kërkimet shqiptare", "Iliria", IX-X, f. 5-21.

3 N. Ceka, M. Zeqo, (1984) "Kërkime nënujore në vijën bregdetare dhe ujrat e brendshme të vendit tonë" "Monumentet" 2, f. 127-140.

Fig. 1 Gërmimet arkeologjike në Shkodër '78-79

Në të njëjtin vend me ato u zbulua dhe mozaiku për të cilin flasim. Zbulimi i tij tregon se aty kemi të bëjmë me një banesë të një rangut të lartë e cila ishte e zbukuruar mjaft mirë edhe jashtë saj (Fig. 2). I tërë mozaiku ka përmasa 8,15 x 6.45 m dhe është i punuar me gurë (tesera) shumë ngjyrëshe si të bardhë, të kuq, blu dhe të verdhë. Ky mozaik për nga ndërtimi i tij ka një përzierje teknikash mes asaj ***Opus tesselatum*** ku zgjidhej kryesisht gurë natyror, me teknikën ***Opus vermikulatum*** ku mbizotërojnë kompozime figurale dhe gurët në sfond ndiqnin forma gjeometrike ose format e një dredhje kërmilli duke u sfumuar nga fundi pa u lidhur me format e tjera ngjitur. Motivet dalluese zbukurimore janë kryesisht gjeometrike dhe vegjetale ndërsa ato humanoide mungojnë. Mozaiku mendohet të jetë punuar para se të kishte filluar interpretimi i subjekteve figurative. Në të shihen rrathë që priten, lule me petale dhe gjysmëhëna. Për ndërtimin e tij është niveluar si fillim trualli i dyshemesë duke e ngjeshur me mbeturina balte të pjekur, copa të imta tulle. Kjo shtresë që njihet si ***rudus*** shërbente si shtrati ku artisti ka vizatuar dekoracionin. Në këtë objekt gjejmë gjurmë të përdorimit të baltës së pjekur në formë pluhuri e përzier me gëlqere, kjo për t'i rritur rezistencën ndaj shtypjeve fizike, por dhe si një teknikë hidroizoluese. Ky mozaik është i vetmi i zbuluar deri më sot në gjithë rajonin e Shkodrës ndaj për datimin e tij autorët e këtyre gërmimeve duke parë dhe ngjashmëritë me mozaikun e zbuluar në Moru të Malit të Zi mendojmë se i përket shek.III-IV mb. Kr.

Fig. 2 Mozaiku i zbuluar gjatë gërmimeve '78-79

Në fund të viteve '80 mozaiku i është nënshtruar fazës së restaurimit në mënyrë që të parandalohej dezintegrimi i sipërfaqes së tij. Mbushja e pjesëve të humbura me granit të përzier me pluhur tulle dhe lidhja e konsolidimi i paneleve të ndara në fillim të procesit të restaurimit, e ruajti atë nga dëmtimi i mëtejshëm nga faktorët klimatikë dhe humanë.

Me ndryshimet e ndollura në fillim të viteve '90 ky objekt me vlera të veçanta thuajse u harrua duke u bërë prehë e dëmtimeve pasi ishte lehtësisht i luajtshëm. Për vite me radhë mozaiku qëndroi i ruajtur në kushte aspak të përshtatshme dhe jo ***in sito***. Në këto kushte ai paraqiste patologji të shumta biologjike, zhvillim të likeneve dhe lakuna në sipërfaqe të tij, por dhe dëmtim të shtratit ku ishin shtruar teserat dhe humbje të tyre duke lenë sot shumë nga format gjeometrike bosh. Në vitin 2006 ky objekt me vlera të ralla kaloi nën administrimin e Parkut Arkeologjik Shkodër dhe qe në krye të herës interesi për konservimin dhe ekspozimin e tij ishte i madh. Problemi qendronte tek vendi ku do të ekspozohej për shkak dhe të madhësisë së tij dhe pamundësisë për t'u vendosur ***in sito***. Ishte gatishmëria e stafit të Muzeut Historik të Shkodrës për të mundësuar ekspozimin e tij në Muzeun e Kështjellës në pavionin e antikitetit, pas rikonstruksionit të plotë të pavioneve duke lënë një hapësirë të mjaftueshme dhe për atë. Për këtë qëllim, në pamundësi të vendosjes së tij në formë të shtrirë pasi kërkonte përshtatje dhe ristrukturim të dyshemesë së Muzeut, si një objekt tipik mesjetar u vendos të ekspozohej vertikal duke marrë parasysh dhe raste të ngjashme të mozaikëve të ekspozuar në Muzeun Kombëtar apo në muzeun arkeologjik të Butrintit. Në këtë hapesirë që u la në dispozicion u ekspozuan përkatësisht 8 panele me numra regjistri 4, 7, 8, 9, 13, 14, 19, 27, panele që ishin në gjendje më të mirë dhe me të plote, ndërsa pjesa tjetër e dëmtuar u dokumentua dhe u magazinua në pritje për ndërhyrje restauruese të mëtejshme. Mozaiku më pas iu nënshtrua dhe një pastrami mekanik paraprak (tampon, ujë të disti-

luar, bisturi) (Fig.3) në sipërfaqen e tij për të eliminuar patologjitë biologjike që paraqiste. Sot vizitorët e shumtë të Kështjelles dhe Muzeut që ndodhet aty, mund të shohin të ekspozuar dhe këtë objekt arkeologjik me vlerë që na vjen si trashëgimi nga antikiteti i qytetit të Shkodrës(Fig. 4).

Mbi çka nënvizuam më sipër ka rëndësi të theksohet se nga vrojtimi tekniko-shkencor e historik i këtij mozaiku por dhe i shembujve të tjerë, të zbuluar në vendin tonë mozaikët janë shprehje social-kulturore e historike në trevat tona, por edhe shprehje e ndërthurjes së kulturave dhe artit të popujve mesdhetarë me ata ballkanas.

Fig. 3 Gjatë pastrimit mekanik të mozaikut

Fig.4 Një nga panelet e ekspozuar në muzeun e Kështjellës sot

Letrat që po botojmë janë një pasqyrim i vështirësive që hasnin jo vetëm Hamdi Bushati por edhe mjaft intelektualë shkodranë, të anatemuem si jo të përshtatshëm për rregjimin komunist, në botimin e studimeve serioze në revistat shkencore të kohës.

Korespondenca nxjerr në dukje jo vetëm vlerësimin për punën studimore të H. Bushatit në fushën e historisë së arsimit shqiptar, por edhe ndihmën dhe përpjekjet e Prof. Kristo Frashërit për botimin e artikullit.

I dashtun Zot. Kristo,

Letrën tuaj të 10-të k.m. e kam marrë. Jam tepër i kënaqun nga përgjegja e juaj shkrue më sinqeritetin më të plotë që mund të shprehet njeriu pranë një shoku.

Ju faleminderit shumë dhe njëherit, t'uroj që t'u jenë largue telashet shëndetsore që kishit pasë në familjen tuaj. Siç e keni kuptue edhe ju vetë nga përmbajtja, me atë artikull kishim qëllim me iu vu në dukje arësimtarve të rinj institucionet e para arësimore që kan fillue sistematikisht në qytetin e Shkodrës pamvarësisht nga gjuha, edukata ose instituti ku asht zhvillue mësimi sidomos për medreset e hapuna nga vezirët Bushatlij për të cilat shumë nuk kanë njohuri prandaj edhe në qoftë se eliminohet ndonjë pjesë unë mendoj se asht e nevojshme të lëhet ajo.

Sa për atë të pjesës nacionale shqiptare, konkretisht ndaj shkollës shqipe, kjo e vërtetë nis me periudhën e xhemjetit të jeutyrqeve por, unë për fat të keq nuk disponoj material të mjaftueshme. Por në qoftëse botohet ky artikulli i parë i jemi, mandej do përpiqem me ia hy një studimi të udhës së grupit të Sadai-miletit.

Ju faleminderit shumë për këtë rast që më premtoni se do të më ndihmoni. Sidoqoftë mbas gjithë këtyne fjalëve unë ju lutem të keni mirësinë e të mirrni mundin ju e ta rregulloni si t'a shihni ju më adapt për situatën e shtypit atje e simbas mundësive qe të ju paraqesin redaksia për t'a shtypë me emnin t'im ose në fund me pseudonimin, kishte për të qenë fillesa e një fitoreje për shtypin shqiptar kombëtar e për mue.

E di se jeni i xanun me punët e juaja por sikur thotë një fjalë e vjetër: pa hjekë nuk bahet nder! Sidoqë t'a shihni ju t'arsyeshme unë jam dakord.

Bashkë me këtë leter po ju dërgoj edhe fatvanë e traskriptueme turqisht me germa latine edhe përkëthimin e saj.

Me këtë po jua këthej përsëri fetvanë origjinale të cilën ndoshta e shtypin me fotokopje siç janë botue disa herë kopje t'atilla në Buletinin e Universitetit.

Perpjekja e juej për të më shtypë artikullin t'im uroj të dalë më suksese edhe kështu të bahët pretekst të hapjes së rrugës për të tjetrë!

Me kaq ju uroj shëndet familiarisht dhe të fala të përzemërta.

Hamdi Bushati
(firma)

I dashtuni Zotni Hamdi,

Letrën tuaj të 20 dhjetorit të kaluar e kam marrë me kohë, por nuk u pergjegja shpejt sepse prita sa u kthye nga leja e gjatë përsoni, me të cilin duhej ta zgjidhnja çështjen e artikullit që ju më dërguat. Para një jave fola me dy përgjegjësat kryesorë të redaksisë dhe vetëm sot po gjej mundësinë t'u shkruaj, mbasi kam patur telashe shëndetësore në familje.

Të dy shokët, pa e lexuar artikullin, më thanë po të njëjtën gjë. Domethënë: e mirëpresin artikullin, janë gadi ta botojnë si këtë si dhe ndonjë artikull tjetër me kusht që përmbajtja të jetë me vlerë gjë që është e kuptueshme po të kihet parasysh se çdo përgjegjës redaksie kërkon të ruajë seriozitetin e organit të vet. Eshtë një kusht që kërkohet për çdo studim. Ata kërkuan që për seriozitetin e artikullit të kenë fjalën pozitive të ndonjë historiani, meqenëse ata nuk janë aq mirë të informuar në lëmin e historisë së arsimit në Shkodër. Sugjerimit që u bëra unë për ta botuar artikullin me emrin e plotë (në lidhje me këtë çështje unë u fola ashtu siç dinja mund që të kem bërë edhe ndonjë gabim, të më falni), iu përgjegjën se ata vetë nuk kishin hezitime veçse do të merrnin edhe pëlqimin, siç është rregulli, i anëtarëve të tjerë të redaksisë, pëlqim të cilin nuk e shihnin të vështirë. Në çdo rast artikulli do të botohet ose me emrin e plotë ose me pseudonimin që ju vetë kini zgjedhur. Ju siguroj se unë nuk do të heq dorë nga përçapjet e mia në këtë drejtim. Mendoj se qielli nuk është aq i vrenjtur dhe retë e pakta do të largohen pa ndonjë vështirësi.

Për pikën e parë, unë u përgjegja se për këtë artikull, recensionin paraprak pozitiv, siç është rregulli në redaksi, po e marr unë vetë persipër dhe u thashë se artikullin do ta dorëzoj pasi t`i sugjeroj autorit për të bërë disa plotësime. E thashë këtë fjalë sepse nuk donja ta dorëzoja artikullin në redaksi pa u njoftuar edhe juve dhe pa ju propozuar që të bëni ndonjë ndryshim që unë mendoj se do ta përmirësonte kualitativisht artikullin. Këtë nuk besoj se do të ma merrni për të keq. Po të doni unë edhe kështu e dorëzoj, veçse ju sigurisht e kuptoni që artikulli i parë që merr një redaksi nga një autor për të i panjohur, duhet të jetë i tillë që të thyejë çdo hezitim

që mund të shfaqet djathtas ose majtas. Kam edhe një arsye tjetër, të cilën për të mos u zgjatur në letër , e lëmë për ta biseduar kur të shihemi ndonjë herë në Tiranë ose në Shkodër.

Artikulli juaj është me interes për historinë e arsimit kombëtar. Materiali bazë i takon një periudhe të caktuar, periudhës së sundimit të xhemietit xhon-turk, politikës famëkeqe të këtij xhemieti ndaj pikës më delikate të çështjes nacionale shqiptare, konkretisht ndaj shkollës shqipe. Dhe ja sugjerimet e mia: për deri sa materiali bazë, i panjohur për ne, sikurse e thoni edhe ju vetë , vërtitet rreth kësaj periudhe dhe rreth kësaj çështje, është e domosdoshme të qëndrohet në këto kufij, si nga ana tematike (që ju e kini bërë) ashtu dhe kronologjike që ju, më duket se i kini kapërcyer, pa qenë nevoja.

Parahistoria që i kini bërë shkollës shqipe në Shkodër qysh nga fillimi i pushtimit turk tingëllon si diçka e panevojshme, edhe për faktin se i ngjet një parakalimi të shpejtë e të përciptë. Më falni se po u flas hapur, por të më besoni se po i flas një miku, për të cilin kam konsideratë, pa menduar se unë jam i pagabuar. Pra mendoj që, pas një hyrjeje shumë të shkurtër mbi gjëndjen arsimore në Shqipëri para hyrjetit, të përqëndrohet në politikën xhon-turke ndaj shkrimit shqip

Me sa di unë, çështja qëndron kështu: propaganda xhon-turke kundër shkronjave latine për shqipen filloi në janar të vitit 1909 nga deputeti i Sinopit Nuri Beu dhe më gjerë u shtrua në Kongresin e Dibrës më 10/23 korrik 1909, por edhe këtu nuk u muar ndonjë vendim për të përdorur domosdo gërmat arabe. Për këtë flet artikulli 3 i proces-verbalit të Kongresit të Dibrës. Ju sigurisht që këtë material e njihni, por të flitet për çështjen e shkrimit shqip në këtë periudhë, pa u përqëndruar në Kongresin e Dibrës, më duket se nuk do t'i sillte dëm por dobi. Më tej, persekutimet e gërmave latine filluan në janar të vitit 1910, nga qeveria e re e Haki Pashës. Me qenë se patriotët shqiptarë e kundërshtuan adoptimin e gërmave arabe (në Kongresin e Elbasanit dhe jashtë Kongresit), puna arriti deri sa qeveria turke filloi të procedonte dalë nga dalë në eleminimin e gërmave latine dhe në mbylljen e shkollave shqipe.

U krijuan me këtë rast edhe klube për gërmat arabe, u botuan gjithashtu edhe tekste shkollore. Por lufta midis shkronjave latine e arabe nuk u ndërpre; ajo vazhdoi duke arritur deri në parlament. Brenda në Shqipëri patriotët bile dogjën edhe abetaret shqipe me gërma arabe, si në Elbasan e në Berat. Nuk është pa vend të flitet edhe për punën e Arif Hiqmetit dhe të disa të tjerëve, të cilët ju i njihni më mirë se unë. Besoj se vetëm në kuadrin

e këtyre ngjarjeve, del e qartë përmbajtja interesante e dokumentit tuaj.

Unë besoj se po të qëndrohet në këto hullij tematikë, e kohësore, punimi juaj do të jetë shumë organik dhe tepër interesant. Do të hyjë pa tjetër në listën e historiografisë serioze mbi shkollën shqipe, bile edhe në listën e historiografisë serioze mbi historinë politike të Shqipërisë të atyre viteve krysiale kur shqiptarët të mbetur vetëm tronditën me luftën e tyre të armatosur dhe jo të armatosur mbarë opinionin publik evropian.

Duke përmbledhur sa më sipër, mendoj që artikulli juaj të lehtësohet nga parahistoria; të fillohet në pragun e hyrjetit; të zhvillohet më gjerësisht lënda që i takon viteve 1908-1912; mbyllja, sidomos trajtimi i grupit të Sadai Miletit, të lihet mundësisht për ndonjë artikull tjetër. Ky artikull do të ishte shumë i dobishëm në qoftë se ju do të kini mundësi të kaloni nëpër duar vetë organin e Shkodrës. Po të jeni dakord me këtë pikë të fundit, unë jam gati t'u ndihmoj me ndonjë material mjaft interesant me origjinë diplomatike që ndodhet këtu në Tiranë, pranë nesh. Këtë material ju mund ta konsultoni vetë.

Bashkëngjitur po ju kthej kopjen e fetvasë, të cilën ju, mendoj, ta transkriptoni në turqisht me germa latine, sipas alfabetit të sotshëm të turqishtes, për ta botuar integralisht, me qenë se me harfet arabisht nuk mund të botohet. Pranë transkriptimit dërgoni edhe përkthimin shqip të plotë, i cili mendoj të botohet gjithashtu pranë origjinalit. Brenda tekstit, mund të përdorni vetëm citate nga dokumenti.

Nuk besoj të më keqkuptoni. Ju siguroj se ju dua të mirën.

Edhe dy fjalë në lidhje me mbishkrimin e varrit të Bushatliut që më dërguat. Faleminderit shumë. Veç gjej rastin t' ju njoftoj se në skedarin tim, gjeta shënimin që kam marrë 11 vjet më parë, drejt për drejt nga guri i varrit, kur mblidhnja mbishkrimet nga disa gurë varresh historikë që ndodhen këtu në Tiranë. Këto ditë do të shoh se ku ndollet tani ky gur varri Kur të vini ndonjëherë në Tiranë, dëshiroj ta shohim bashkërisht. Duke e mbyllur letrën po ju njoftoj se artikullin tuej përveç meje nuk e ka lexuar këtu në Tiranë asnjë njeri.

Pres të më shkruani. Ju përshëndes.

Kristo Frashëri.
(firma)

Arshi PIPA

Si vdiq Vinçenc Prendushi

Dëshmi prekëse e Arshi Pipës bashkëvuajtës në të njëjtën qeli me Imzot Vinçenc Prennushin rreth çasteve të fundit të jetës së tij.

"Ndihem i privilegjuar që kam pasur rastin të rri së bashku me Imzot Vinçenc Prennushin dhe që jam dëshmitar i pjesës së fundit të jetës së tij. Vuante prej shumë sëmundjesh, shumë prej të cilave ishin pasojë e drejtëpërdrejtë e torturave të Sigurimit. Kam qenë dëshmitar i vdekjes së tij, i kam mbyllur sytë"- Arshi Pipa.

Mbrapa burgut të Durësit, brenda telave asht një ndërtesë përdhese. Shërben njikohësisht si mensë dhe si shkollë, aty policët marrin ushqimin e përditshëm, aty marrin edhe mësimet e partisë, Këtë herë shërben edhe si sallë gjyqi.

Nanduer 1947. Hove-hove të burgosunit janë nxjerrë përpara gjyqit ushtarak. Asht vala e terrorit ma të egër. Intelektualë, teknikë, klerikë, por edhe zejtarë, fshatarë, të gjithë ata qi mendohet se janë kundërshtarë, veprues ose jo, të partisë, janë fshi dhe rrasë nëpër burgje. Gjykimi asht sa për sy e faqe; proceset kurdisen ma parë nga Ministria e Mbrendshme, gjyqi vetëm i ven në skenë. I burgosuni merret nji ditë nga Dega e Sigurimit dhe futet mbrenda në nji dhomë. Sheh para vetes, ulun në tryezë, tre oficera madhorë, nji tjetër pak mënjanë brylas, nji nënoficer me një makinë shkrimi. Njeni prej tyne lexon nji fletë, zakonisht filllimin ose fundin e saj: vazhdojnë pyetjet, shoqnue me kërcënime dhe shamje. Kjo vazhdon dhetë deri njizet minuta, simbas rasës. Mandej i burgosuni nxirret jashtë dhe nji tjetër futet në dhomë. Njeriu pandeh se gjindet në nji seancë hetuesie. Mbasi e sjellin në burg, merr vesht se ka qenë para gjyqit ushtarak.

Për disa ditë me radhë gjyqi ushtarak i Garnizonit të Tiranës, i kryesuem prej Major Gjin Banushit ka gjykue ksisoj, me dyer të mbylluna. Tash asht vendimi. Në sallën e vogël qëndrojnë mbi banka rreth gjashtedhjetë të burgosun. E shumta nuk e njofin njëni-tjetrin. Fytyra të nxime, të hjekuna, qi kqyren ndërmjet tyne frikshëm, pabesueshëm.

Hyn trupi gjykues, Prokurori, Kap. I Petrit Hakani, nis pretencën. Ban nji për përmbledhje të shkurtën, të ngutshme, mandej nxjerr nga çanta nji tufë letrash dhe ndanë andej listën e grupit të parë.

Përpara meje asht nji burrë me flokë të bardhë, i mbledhun kruspull, i veshun me nji mantel të zit të dalun boje. Nuk ka lëvizë gjithë kohën. Lëviz tash në thirrje të nji emni: Vinçenc Prendushi!

Ngrihet ngadalë mundshëm dhe ulet mandej pa thane nji fjalë. Prokurori lexon pretencën e të pandehunit. Akuzat janë krejt gjenerike, pa asnji fakt konkret, ato tashma të stereotypuemet: ''armik i popullit'', "bashkëpunëtori i okupatorit'', "fashist''. Theksohet fakti se ka qenë peshkop i Kishës Katolike dhe me këtë rasë shtohen frazat: "klerik reaksionar'', "agjent i Vatikanit'. Në fund kërkimi i dënimit: njizet vjet.

Njizet vjet në ato rrethana, dhe për nji personalitet si Vinçens Prendushi, nuk asht fort keq, kur të mendohet se fill mbrapa prokurori kërkon dënimin me vdekje për famullitarin e tij, Dom Anton Zogajn.

Në fjalën e fundit Imzot Prendushi thotë me za të ramë: "Nuk i kam dashtë kujt të keqen. Jam mundue me ba mirë''. Vendimi i gjyqit asht: njizet vjet privim lirie me punë të detyrueme!

Me Imzot Prendushin u njofta fill mbas gjykimit. Na qëlloi me ndenjë së bashku, në nji dhomë të vogël të burgut, ku vunë edhe Myftiun e Durrësit, Mustafa Varoshin, Prof.Prenk Kaçinarin dhe nji professor tjetër. Disa ditë mbrapa Myftiu, i cili nga torturat e tmerrshme gjatë hetuesisë ishte ba nji kufomë e gjalle, vdiq në spitalin e Durrësit. Prof.Prek Kaqinari, qi vuante nga tuberkulozi, u lirue nga burgu më1949. I mërzitun nga persekutimi i vazhdueshëm ai vrau vedin më 1956.

Pak ditë ma vonë u shbartë mandej në nji dhomë tjetër. Më kujtohet mirë kjo dhomë, e veçueme prej të tjerave, në nji skjaj të oborrit; kishte qenë motit xhebehane (depo armësh) dhe kishte mure të trasha, me tavanin në trajtë kubeje, me vetëm nji dritare të vogël. Te kjo dhomë, e njoftun me emnin "Dhoma nr.8, vendoseshin zakonisht "ma të rrezikshmit". Ishim ngushtë, rreth tridhjetë vetë në nji hapsinë ma pak se nji metër katrore. Megjithkëtë të burgosurit u ngushtuen edhe ma për me i ba Imzotit nji vend ma të gjanë, tue u vu në krye të dhomës. Mue më qëlloi me qenë pranë tij. Nuk vonoi shumë dhe u miqësuem. Kuvendojshim mbi gjana politike, tue komentue gjendjen me za të ulët, qi fjalët mos të ndigjoheshin prej të tjerëve. Torturat komuniste na kishin ba me qenë të matun. Por politika Imzotit nuk i pëlqente dhe ma shpesh kuvendojshim mbi gjana të tjera, mbi letërsi, mbi gjana të së kaluemes, mbi përvoja vetiake të ndryshme. Me të tjerët Imzoti ishte shumë i ndalun dhe qelte gojën për me dhanë ndonji këshillë, edhe atëherë kur ishte i pyetun, ose për me ngushëllue me fjalë të buta zemrat e vuejtuna të njerëzve. Fort rrallë tregonte ndonji ndodhi të jetës së vet, ndonji anekdotë ose nji fakt

historik, dhe gati gjithmonë me qëllim edukativ. Atëherë gjithë dhoma e vështronte në nji heshtje njimend fetare. Flitte thjeshtë, në mënyrë qi me e kuptue edhe fshatarët. Ndante me ma të vorfënt atë pak gjellë qi nji plakë e përshpirtshme ia binte kur kishte.Rrinte, ndonjiherë me orë, në vendin e vet pa folë, me kqyrjen e tretun përtej dritares. Mbas gjase atëherë luej. Ishte i butë me shpirt të paqëm, thellë i devotshëm, i kushtuem kryekput misionit të vet për Atdheun dhe shijet për letërsinë. Buzëqeshun në të folun, zemërgjanë ndër gjykime, i qetë e i sigurtë në besimin e vet të patrandshem, por jo i mbyllun ndaj shekullit,madje fort i kuptueshëm për nevojat dhe të metat e njerëzve. Imzot Prendushi të bante shpejt për vete. Mbasi qemë afrue mjaft, un i lypa leje ta thirrsha Pater Vinçenc: titulli i françeskanit të dikurshëm më tingëllonte ma për zemër në ato kushte të trishtueshme ku dallimet mes njerëzve nuk mund të ishin veçse të rendit moral. Dinjiteti kishtar i Vinçenc Prendushit, i kombinuem me vlerën e tij letrare dhe i kqyrun nën prizmën e atdhetarizmit shqiptar, i jep fytyrës së tij nji randësi madhore në radhët e përfaqësuesve të Kombit.

Nji jetë e panjollë

Jeta e tij është nji jetë e panjollë, e shkrime në shërbim të disave nga idealet eprore njerzore qysh janë: Atdheu, arti, feja. Emni Vinçenc Prendushit asht nji emën i dashun sidomos për shkodranët. Qysh i ri, i veshun me zhgunin e Shën Françeskut, Patër Vinçenci tregoi takt dhe kuptim të rrallë në të zbutunin e fanatizmës fetare në qytetin e Shkodrës, ndër kohnat e turbullta fill mbas krijimit të Shtetit Shqiptar. Qysh atëherë ai shquhej për atdhetarizëm të vet në radhën e urdhëntarëve të Shën Françskut, këtij urdhni fetar, të cilit Shqipnija i detyron nderimin ma të madh për shërbimet e mëdha në lamën e kulturës e përgjithësisht të çashtjes shqiptare. Mbahen mend ligjëratat e bukura dhe të urta atdhetare të meshtarit të ri ndër rase të ndryshme në lidhje me data historike. Në ato mote nis edhe veprimtaria letrare e Patër Vinçencit, i cili në mbledhjen dhe botimin e “Kangëve Popullore Gegënishte’’ i dha nji hov të ri, në nji drejtim ma shkencor, folklores shqipe dhe me lyrikat e veta të para të botueme ndër të përkohshmet ‘’Hylli i Dritës’’ dhe ‘’Zani i Shna Ndout’’ zu t’i gdheni vetes nji emën të denjë në historinë e letërsisë shqipe. Vinçenc Prendushi qe nji nga punëtorët ma të frytshëm të letërsisë sonë; përveç veprës së tij kryesore ‘’Gjeth e lule’’, ku janë të përmenduna Lyrikat e veta, ai përshtati ose përktheu në Shqipen shumë vepra të letërsisë botnore, i udhëhequn gjithmonë në zgjedhjen e vet nga kriteri i pajtimit të artit ndaj

fesë. Për aftësinë e vet si udhëheqës shpirtëror, Patër Vinçenci qe zgjedhë Provinciali i Françeskanëve Shqiptarë dhe, ma vonë, qe emnue prej Selisë Shejte ipeshkëv. Pushtimi Italian e gjeti Imzot Prendushin Argjipeshkëv të Durrësit, njeni nga dy dinjitarët ma të naltë të Kishës Katolike Shqiptare.

Si i këtillë në njënën anë dhe, në tjetrën, si njani nga përfaqësuesit e letërsisë kombëtare, Imzot Prendushi nuk mund ta kishte të gjatë me komunizmin, i cili asht me të njajtën kohë kundër fesë dhe kombësisë. Imzot Prendushi më ka rrfye qysh Enver Hoxha e kishte thirrë, gjoja të këshillohej me të për punët e Kishës Katolike Shqiptare, në të vërtetë për t'i imponue atij pikëpamjet e politikës komuniste ndaj fesë. Nuk kishte mundë ta bindte. Ma vonë, mbasi Imzot Prendushi u burgos, ai u vërsul ashpër kundër tij në njërin prej fjalimeve të veta. Mbasi e burgosën, e torturuen, prej vetë gojës së tij di se e kanë rrahë ma parë me dru, mandej e kanë lidhë për kambësh e për duersh, i kanë kallë mes tyne nji dru me nji çengel në të, mandej e kanë varë drunin me nji gozhdë të madhe në murin e nevojtores, tue e lanë aty deri sa i ka ra të fikët."Si dashin në krraba", shtonte buzëqeshun Imzoti, të cilit nuk i mungonte nji damar shakaje.

Prelati i varun e i munduem

Përfytyroni tash këtë njeri, nji burrë gjashtëdhjetëpesëvjeçar, nji prelat të naltë të Kishës, nji nga fort të rrallët shkrimtarë të Rilindjes, ende të mbetun gjallë, përfytyroni të varun asisoj në nji nevojtore të Degës së Sigurimit. Ky njeri i kqyrun prej shqiptarëve me nderimin ma të madh, i ruajtun në mirënjohjen e tyne si nji relike mbrenda peshtafit të vet, ky symbol i së kaluemes së Shqipnisë për të cilën na mburremi, ky njeri rrëmbehet përdhunë nga shtëpija e pervujtë e nji katundi, ku kalonte ditët e mbrapme të jetës së vet, bashkë me Zotin dhe me librat, dhe ndryhet në burgjet dhe torturohet.

Nji ditë e nxorën me bartë trungje. Burgu i Durrësit asht i vendosun pak në kodër dhe kamionat zhgarkojshin në rrugën poshtë: prej andej i ngarkojshin të burgosurit, tue i ngjitë nalt dhe tue i stivue. Njeni rojesh. Kur po caktonte punëtorët, iu suell Imzotit: "Edhe ti, prift!" Të gjithë u çuditën mbasi deri atë ditë nuk e kishin mërzitë për gjana të këtilla: Ai ishte jo vetëm plak, por kishte, për ma tepër, erni të theksueme të atillë sa memzi ecte, Imzoti nuk tha gja e duel me të tjerët.

Un nuk qeshë at ditë në punë, por shokët më treguen ma vonë gjithçka. I kishin ngarkue në sup trungje që ai nuk mund t' i bante kurrsesi, ishte rrokullisë me ta, nji herë, dy, tri, dhe gjithmonë pabëza. Drejtori i burgut

dhe Komisari i bajshin "sehir" nga shkallët e burgut. Qesheshin. Shokët bajshin çmos për ta ndihmue: i lejshin atij anën ma pak të randë të trungut, kur ky ishte i hollë, ose, kur ishte shumë i trashë dhe i gjatë, ndajshin peshën në supat e tyne në mënyrë qi trungu atij mos t'i peshonte. Por edhe vetëm ngjitja përpjetë ishte për të tepër, tepër e mundshme. Shumë herë ishte rrrëzue lëmuç tue mbetë pa frymë. Rojet e lejshin atëherë disa minuta me pushue dhe prapë e futshin në punë. "Prift", ke bamë ndonjëherë kështu punë!?" e kishte pyet njiherë drejtori i burgut, tue u zgërdhi. Ai, si dhe policët nuk e quejshin ndryshe veç "prift". E shqiptojshin këtë fjalë me nji shtrembënim të buzëve, theksueshëm në mendjen e tyne. Fjala ishte shamje.

Kujdesi i tij kryesor ishte për Dom Anton Zogajn. Dom Antoni ishte dënue me vdekje dhe ndodhej atëherë i mbyllun në njenën nga çelat qi shërbejshin për banjë. Kishte qenë famullitar i Durrësit pra, nën mvarësinë e drejtë të Imzotit. Ishte e rrezikshme me marrë e dhanë me të dënuemin për vdekje, por me anë të shokëve Imzoti ia doli me ditë dëshirat e mbrame të famullitarit. Njena prej këtyne ishte me nxjerrë jashtë burgut komçat e petkut fetar që ai gjithnji mbante. Këtë gja mundem me e ba. Imzoti nuk dinte si me e falenderue për këte. E pata pyet Imzotin nëse kishte lanë te shtëpija ndonji dorëshkrim. M'u gjegj se kishte përpunue përkthimin e Ëeberit "Dreizchnlinden". Kur e pyeta pse kishte përkthye bash vetë këtë vepër dhe jo ndonji tjetër ma të njoftun të letërsisë gjermane mbasi ishte edukue në Austri, ai më tha se kishte zgjedhë atë vepër për arsye se zakonet e malësorëve austriakë kishin shumë gjana të përbashkëta me ata të malësorëve tonë.

Imzoti i smundë

Me imzot Prendushin ndenjëm deri nga vera e vjetit 1948, kur un u dërgova, bashkë, me shokë në kampin e punës së Vloçishtit. Kur u ktheva andej, nga fundi i nandorit, gjeta Imzotin të smundë. Vuente prej zemre dhe rrallë lente dhomën për me dalë në oborr. Gjendja e tij erdh tue u keqësue me të shpejtë. E dërgue në spital. Pak ma vonë shkova edhe unë në spital.

Spitali i burgut ndodhej në atë kohë në nji ndërtesë përdhese, nji aneks i Spitalit të Durrësit, e cila binte mbi një rrugë të ngushtë, jo shumë larg bulevardit "Dalip Tabaku", të ndërtuem prej të bugosunve. Dhoma ishte e vogël, e ulët, e vjetër, me dy dritare, të cilat kqyrnin kah deti. Kishte qenë ma parë dhomë zjarrmi, mbasi kishte votër. Mjekët i kishin gjetë Imzotit nji "asmë zemrës" sëmundje e randë, sidomos për moshën e tij. Asma e ngushtonte ma fort natën. I vinte me hove qi shkojshin tue u përshpejtue deri në gulshim të randë, sa me e lanë pa frymë. Kur i kalonte, mbas disa

orësh, binte si i vdekun e për nji kohë të gjatë nuk mundte me folë. Mjeku i pavionit, Dr. Propopulli, nji njeri me zemërari, të cilit, i dhimbseshin të burgosunit dhe të cilëve u shërbente me shpirt, bani gjithçka për Imzotin. E vizitonte disa herë ditën, jashtëzakonit dhe shpesh i binte barna nga të vetat, mbasi spitali nuk kishte.

Kjo ka qenë në fruer 1948. Flitej atëherë me ngulm se, mbas prishjes me Jugosllavinë, qeveria po pregatitte nji amnisti të madhe, nga e cila do të përfitojshin të gjithë të burgosunit e pafajshëm. Në gjëndjen në të cilën ndodhej Imzoti, shpresa për me dalë nga burgu, me i kalue ditët e mbrame të jetës në shtëpi, nën kujdesin e ndonji njeriu të dashun, ishte një mënyrë me e mbajtë gjallë, dhe un përpiqesha sa ma shumë me ia këndellë atë shpresë. Nuk mendojsha aspak se komunistat do ta lirojshin për hir të së drejtës, por më rrente uzdaja se ndofta logjika e vijës së re politike mund të përparonte sa me shtrëngue qeveritarët qi bajshin çka nuk dëshirojshin. Ndër ato ditë kemi ba me Imzotin shumë kuvendime mbi gjendjen politike, nëpër të cilat un shkojshe tue ia ushqye shpresën e lirimit.

Nji skenë e mallëngjyeshme

Më kujtohet një skenë e mallëngjyeshme. Nji ditë prune ndër ne për pak kohë Dom Jul Bonatin, famullitarin e Vlonës. E bijshin nga burgu i Vlonës për ta strehue në azilin e tëçmendunve të Durrësit.

Dom Jul Bonati e kisha njoftë qysh kur isha qenë student në Firence, ai përpiqej aso kohe me shtypë përkthimi e vet italisht të "Lahutës së Malcis". Nisem kuvend. I kallzova se njeriu që po gulshonte në shtrat ishte Imzot Prendushi. Atëherë Dom Bonati, i cili mezi mbahej në këmbë nga sëmundja dhe pleqnia e shtyme, u ngrejt dhe gati tue u zvarritë iu qas Imzotit: bani me i puthë dorën, por Imzoti, sado qi në ankthin e gulshimit, nuk e la dhe tërhoqi dorën. Atëherë Dom Bonati i kërkoi bekimin dhe Imzoti, me nji përpjekje të fundme i vuni dorën mbikrye. Mandej u plandos mbishtrojë. Nuk vdiq atëherë, por disa ditë ma vonë. Ndër ato ditë hoqi ma shumë se kurrë. Tmerri ishte nata. Deri në mesnatë kishte dritë elektrike, deri atëherë vuajtja ishte ma e durueshme. Por, t'u fikmën drita, në errsinën qi mbytte dhomën, vuejtja e tij rritej, acarohej. Ishte a thue se mungesa e dritës, i mungonte frymën. Gulshimi bahej atëherë i mënershëm, si rënkim i një të plagosuni, i cili, në vend qi të shkonte teu ra, vinte tue u shtue der në ulërimë. I bahej, siç më rrëfente, a thue se çapoj të hekurt ja mbërthejshin krahnorin tue ja shtryll dhe zemrën gjithnji ma keq, tue ia shkye. Në atë kohë njeriu nuk mund të flente ma në dhomë. Ngriheshim me rradhë dhe i

fërkojshim kambët kështu i dukej se diçka lehtësohej. Mbajshim të pafikun zjarmin në votër: kandil nuk kishim dhe drita e flakës ndihmonte shumë me ia fashitë vuejtjen. Prandaj qysh në mbramje kujdeseshin me grumbullue në voter mjaft dru. Ishte dimën, dhoma ngrohej me anë të votrës, prandaj ishte parashikue nji sasi druni për zjarm. Por kjo sasi nuk mjaftonte për me mbajtë zjarmin gjithë natën dhe na duhej, me mënyra të ndryshme, me bindë rojet qi të urdhënojshin shërbyesit e spitalit për me na pru sa ma shumë dru.

Kërkoi drit*ë*

Po ndodhte shpesh qi nuk mund të kishim dru sa duhej. Dhe kur fikeshin xhixhat e fundme dhe errësina peshonte në dhomë, ngriheshim prej shtratit, herë njeni here tjetri, dhe i rrijshim të smundit te kryet, tue i folë (të folunit ja davarite disi travajin), tue i dhanë zemër, tue e gënjye se do të bijshin, dru të tjera ose se nata ishte në të sosun…

Nji natë të këtillë më tha copa-copa:

"Tash po kujtoj fjalët e Goethes "Mehr Licht" (dua dritë).

Ajo dritë së cilës i kishte thirrë në pikë të mortjes. Poeti nuk ishte, sigurisht, drita qi shohin sytë tanë shqisorë. Dhe këtë Imzoti e dinte mirë. Por cili njeri nuk pau në dritën e ambël të qiellit simbolin e jetës? "Me të ba sytë dritë mbi dhe", thotë populli ynë, me nji shprehje egërsisht poetike, për me cilësue jetën. Dhe kur mendja e njeriut u rrek me gjetë nji urë kalimi mes landores dhe palandores u ndal, si nji herë përherë, por te drita. Prej neoplatonizmit, tërthuhet Augustinit, te shkolla Françeskane e Oxford-it përfytyrimi i dritës ndriçoi konceptin e filosofisë tue ndërmjetsue mes poezisë dhe mystikës. Dhe Foscolo pat thanë afër ditëve tona:

"Perche gli occhi dell'uomo cercon morendo il Sole…"

Imzot Prendushi u nda këso jete nji natë të frorit 1949. Atë natë kishte zjarm në votër. Kur ia mbylla sytë e lodhun, e të shterrun, qi aq shumë kishin rektue për dritë, m'u duk se pashë në fytyrën e tij të hajthët, të mos besojë. Ndofta mue më bajshin sytë e përlotun, ndoshta nuk ishte veçse nji refleks i flakrimeve të kuqremta të zjarmit të votrës, ngujue ndër rrudhat e thella të ballit të gjanë ndër zgavrat e faqeve dhe ndër gropëzat e syve. Por ndoshta ishte diçka tjetër. Shpirti që rri në grahmat e dhimbës fizike topitet, tkurret, terrtiset, si kullohet prej saj , kur dhima të prajë , si ujt prej lymit që e pat trazue. Njeriu mund të mos besojë në pavdekësinë e shpirtit.

Por asht e vështirë me pranue se gjithshka mbaron më trupin kur vërejmë qysh njerëzit vdesin për ideale.

Flamuri, 1959, f. 105-108.

GIORGIO AGAMBEN [1*]

Sulla difficoltà di leggere*/ Il fuoco e il racconto.Terza edicione / 2015*

Mbi vështirësitë e leximit

Kisha dëshirë me ju folë jo mbi leximin dhe mbi rreziqet qi ai mundet me sjellë, por mbi një rrezik që qëndron në krye të herës, mbi vështirësitë ose mbi pamundësinë e leximit. Kisha dëshirë me provue me ju folë jo mbi leximin, por mbi palexueshmëninë. Gjithsecili prej jush do të ketë provue nga ato momentet në të cilat kishim me dashtë me lexue, por nuk ja dalim, në të cilat kambëngulim me shfletue faqet e një libri, por ai na rrëshqet prej duersh. Në traktatet mbi jetën e murgjëve, ky ishte në fakt rreziku i rreziqeve, në të cilin një murg binte; pakujdesija, shejtani meridian, tundimi ma i tmerrshëm që kërcënon "homines religiosi", manifestohet para së gjithash në pamundësinë me lexue. Ja përshkrimi që na jep Shën Nilo:

"Kur murgu i pakujdesshëm provon me lexue, ndalon i trazuem dhe, mbâs një minuti, rrëshqet në gjumë; fërkon fytyrën me duer, zgjat gishtat dhe shtŷhet me lexue ndonjë rresht, duke mbllaqitë fundin e çdo fjale që lexon; ndërkohë mendja i bâhet xurxull me kalkulime dembele, numëron faqet që i kanë mbetë dhe fletët e shënimeve, e fillon me urrye shkronjat e të bukurat miniatura që ka përpara sysh derisa, ma në fund, e mbyll librin dhe e përdor si jastëk për kryet e vet, duke ra kështu në një gjumë të shkurtë e të thellë.

Shëndeti i shpirtit përputhet këtu me lexueshmëninë e librit (që asht

1 * Giorgio Agamben âsht një ndër filozofët ma të rândësishëm të kohës sonë.
I lindun në Romë në vitin 1942, diplomohet në drejtësi në 1965 me një tezë mbi Simone Weil. Në 1974 transferohet në Paris ku jep mësim në Universitetin Haute-Bretagne. Në vitet 1986- 1993 ka drejtue Collège international de Philosophie në Paris. Nga vitet 1988 e deri ne 2009 ka dhanë mësim në Universitetet italiane në Macerata, Verona e Venecia.
Ndër publikimet e shumta veçojmë: *"L'uomo senza contenuto"*, Milano, Rizzoli, 1977, *"Infanzia e storia"*, Torino, Einaudi, 1979, *"La comunità che viene"*, Torino: Einaudi, 1990, *"Homo sacer. Il potere sovrano e la nuda vita"*, Torino: Einaudi, 1995, *"Mezzi senza fine. Note sulla politica"*, Torino: Bollati Boringhieri, 1996, *"L'aperto. L'uomo e l'animale"*, Torino: Bollati Boringhieri, 2002, "Che cos'è il contemporaneo?", Roma: Nottetempo, 2008, *"Altissima povertà. Regole monastiche e forma di vita"*, Vicenza: Neri Pozza, 2011, *"Che cos'è la filosofia?"*, Macerata: Quodlibet, 2016.

edhe për Mesjetën, libri i Botës), mëkati përputhet me pamundësinë me lexue, me transformimin e botës në të palexueshme".

Simone Weil fliste, në këtë kuptim, mbi një lexim të botës dhe njëkohësisht mbi një mos lexim, mbi një patejdukshmëni që i rreziston çdo interpretimi e çdo komentimi. Kisha me ju sugjerue që të jeni të vëmendshëm ndaj momenteve tueja të mos leximit e të patejdukshmënisë, kur libri i botës ju rrëshqet prej duersh, mbâsi pamundësia me lexue ju përket po aq sa edhe leximi, dhe asht ndoshta po aq e dobishme sa ky i fundit.

Âsht edhe një tjetër, edhe ma radikale pamundësi me lexue, që deri jo shumë vite ma parë ishte bile mjaft e përhapun. I referohem analfabeteve, këtyne njerëzve shumë shpejt të harruem, që vetëm një shekull ma parë ishin, të paktën në Itali, shumica e popullsisë. Një poet i madh peruvian i shekullit të XX ka shkrue në një poezi të veten: "por el analfabeto a quen escribo". Âsht e randësishme me kuptue domethanien e këtij ''për": jo aq "që analfabeti të më lexojë'', meqë për përkufizim nuk do të mundet me bâ, aq sa ''në vend të tij'', si thoshte Primo Levi që dëshmonte për ato që në zhargonin e Auschëitz-it thirreshin musulmanë, pra ato që nuk mujshin, e nuk do të kishin mujtë me dëshmue, ngaqë, pak mbâs hymjes së tyne në kamp, kishin humbë çdo lloj ndërgjegjësimi e çdo ndjeshmëni.

Do ju sugjeroja të reflektonit mbi statusin special të një libri që âshtë i destinuem për sytë që nuk munden me e lexue dhe âsht shkrue nga një dorë që, në një farë mënyre, nuk din me shkrue. Poetët ose shkrimtarët që shkruejnë për analfabetin….. provojnë me shkrue atë që nuk mund të lexohet, vendosin në letër të palexueshmen. Por âsht pikërisht kjo që e bân shkrimin e tyne ma interesant se atë që âsht shkrue vetëm për ata që dijnë me lexue.

Âsht mandej një tjetër rast i mos leximit për të cilin due me ju folë. I referohem librave që nuk kanë gjetë atë që Benjamin e quente ora e lexueshmënisë, që janë shkrue e publikue, por janë-ndoshta përgjithmonë- në pritje për t'u lexue. Unë njoh, e besoj se secili prej jush mund të permendte libra që meritonin të ishin lexue e nuk janë lexue, apo janë lexue por nga shumë pak lexues. Cili asht statusi i këtyne librave? Unë mendoj që, nëse këto libra janë me të vërtetë të mirë, nuk duhet folë për pritje, por për një nevojë**.** Këto libra nuk presin, por kanë nevojë me u lexue, edhe nëse kjo nuk ka ndodhë apo nuk do të ndodhte kurrë. Nevoja asht nji koncept shumë interesant, që nuk i referohet fushës së fakteve, por një sfere superiore e vendimtare, natyrën e së cilës po jua la ju t'a

prezicioni.

Po atëherë do dëshirojshe me u dhanë një këshillë botuesve dhe atyne që merren me librat: shporruni prej të mbrapshtave, po, po, të mbrapshtave klasifikime të librave ma të shitun e -mendohet për rrjedhojë- ma të lexuem dhe provoni me ndërtue në mendjen tuej një klasifikim të librave që kërkojnë me u lexue. Vetëm editoria e bâzueme mbi këtë klasifikim mental mundet me e bâ me dalë librin prej krizës në të cilin ai gjëndet.

Një poet ka përmbledhë një herë poetikën e tij në formulën: "Me lexue atë që kurrë nuk âsht shkrue". Bâhet fjalë, siç e shihni, për një eksperiencë në një farë mënyre simetrike me atë të poetit që shkrunte për analfabetin, që nuk mundet me e lexue: shkrimit pa lexim, i kundërpërgjigjet këtu një lexim pa shkrim. Veçse me kushtin e saktësimit që edhe kohët janë ndryshue; andej një shkrim që nuk asht i ndjekun prej asnjë leximi, e këndej një lexim që nuk âsht pararendë prej kurrfarë shkrimi.

Por ndoshta në të dyja këto formulime bâhet fjalë për diçka të ngjashme, për diçka që ka lidhje me eksperiencën e shkrimit e të leximit që ve në diskutim paraqitjen që zakonisht i bâjmë këtyne praktikave kaq ngushtësisht të lidhuna me njena-tjetrën, të cilat kundërshtojnë e përcjellin në drejtim të diçkaje të palexueshme dhe të pashkrueshme që i ka pararendë e nuk pushon së ndjekuni hap mbâs hapi.

Besoj e keni kuptue se i referohem oralitetit. Letërsia jonë lind në marrëdhanie intime me oralitetin. Çka bân Dante kur vendos me shkrue atë që nuk âsht lexue kurrë ma parë dhe me lexue atë që kurrë nuk âsht shkrue, pra atë " parlar materno" " të folmen amtare " analfabete, që ekzistonte vetëm në dimensionin oral? Duke tentue me vû në shkrim të folmen amtare, e detyron jo vetëm me e transkriptue, por siç e dini, me shpikë atë gjuhë të poezisë, atë vulgare të ndritun, që nuk ekziston askund tjetër dhe, si një panterë e bestiarëve mesjetare, " shpërndan kudo erën e saj, por nuk bânon në asnjë vend".

Unë besoj që nuk mund të kuptohet në mënyrë korrekte lulëzimi i madh i poezisë italiane në nandëqinden, nëse nuk verehet në të diçka që thërret këtë oralitet të palexueshëm i cili, siç thotë Dante," njeni dhe i vetmi âsht i pari në mendje", nëse nuk kuptohet që ajo âsht e shoqënueme prej po aq të jashtëzakonshmit lulëzim të poezisë në dialekt. Ndoshta letërsia italiane e nandëqindes âsht e tana e përshkrueme nga një kujtesë e pandërgjegjshme, gati nga një përkujtim i mundimshëm i analfalbetizmit. Kush ka pasë ndër duer ndonjë nga këto libra , në të cilët përbâllë faqes së shkrueme – ose ma mirë me thanë të transkriptueme- në dialekt , qëndron

përkthimi në gjuhën zyrtare, nuk ka mujtë mos me ja bâ pyetjen vedit, ndërsa sytë i rrëshqisnin shqetësueshëm nga një faqe në tjetrën, nëse vendi i vërtetë i poezisë nuk ishte në fakt as në njenën faqe e as në tjetrën, por në hapësinën boshe ndërmjet të dyjave.

E do të doja me e mbyllë ketë refleksion të shkurtë mbi vështirësinë e leximit, duke ju pyet nëse ajo që quejmë poezi nuk âsht në të vërtetë diçka që pa pushim bânon, punon dhe e tërheq gjuhën e shkrueme për me ja rikthye asaj palexueshmëninë nga e cila vjen e drejt së cilës e mbân hapin.

Përkthei Adrian Paci

Entela Tabaku Sörman

Përsiatjet e një poeteje mbi konstruktin e munguar në shqipen standard

Gjuha shqipe standard nuk e njeh formën e infinitivit (ndryshe "forma bazë e foljes"). Ne e kemi termin "paskajore" por e perdorim per nje konstrukt joinfinitiv si "per te shkuar". Shqipja standard njeh vetëm pjesoren, që s'është veçse një formë e pashtjelluar me të cilën ndërtohen format e përbëra të foljes. Përkrah saj pastaj radhiten format e tjera të pashtjelluara që mbartin kuptimet e veta të veçanta. Në gramatikë pjesorja njihet si particip, nga vjen edhe përkthimi i termit – pjesë e diçkaje. Por pjesorja nuk është infinitiv, prandaj kur përkthejmë foljet nga gjuhët e tjera, jemi te detyruar të themi avere, (to) have, avoir, (att) ha = kam. Por "kam", ju e dini, do të thotë ho, I have, j'ai, jag har. Po mirë, dihet se përkthimet kështu janë, jo gjithmonë një gjuhë e ka gjegjësin e gjuhës tjetër. Veçse … shqipja e ka infinitivin, formën bazë:

avere, (to) have, avoir, (att) ha = (me) pasë
essere, (to) be, être, (att) vara = (me) qenë
cantare, (to) sing, chanter, (att) sjunga) = (me) këndu
prendere, (to) take, prendre, (att) ta = (me) marrë
aprire, (to) open, ouvrir, (att) öppna = (me) hapë

Mandej, a e shkruajmë me diftong "ue" a pa diftong, a e shkruajmë me "q" a me "k", ky është problem krejt tjetër, që zgjidhet me vendime gjuhëtarësh, ashtu siç u vendos përdorimi i "ua", edhe pse jo gjithë toskët e shqiptojnë. Personalisht mendoj se duhet të zgjedhim ato variante që i afrohen sa më shumë toskërishtes, për hir të njesimit, prandaj s'ka më nevojë për diftongje në fund të foljes. Dhe "q" është krejt e pranueshme. Ne shkodranët vazhdojmë me kenë:D Këto format e mësipërme unë i dëgjoj të përdoren edhe nga toskët. Po pse duhet infinitivi? Pse as paskajorja e standardit, as lidhorja nuk mundet ta zëvendësojnë infinitivin në ndërgjegjen e atij që e ka këtë formë në gjuhën mëmë. Po marr si shembull veten time. Unë e njoh shumë mirë shqipen standard, jam shkolluar gjatë. E njoh shumë mirë shkodranishten në veçanti, por kam lexuar shumë letërsinë gege në përgjithësi. Gjithashtu

i kam studiuar traktatet, manifestet, përpjekjet, shkrimet e paraluftës në kërkim të njesimit të gjuhës sonë, si të një shqipeje standard, ashtu edhe të një gegërishte standard. Mandej i kam studiuar si funksionojne edhe gjuhët standard të vendeve të tjera. Dhe standardi, kuptohet, përjetohet gjithmonë dhe kudo si dhunë e domosdoshme ndaj lirisë së dialekteve për hir të njesimit, por në rastin e një populli kaq të vogël sa tonin, mohimi i një konstrukti kaq të rëndësishëm gjuhësor sa infinitivi, i pranishëm në vetëdijën e së paku 70% të popullsisë, më duket marrëzi, çmenduri, keqdashje. Ja për shembull unë dua të shkruaj strofën e fundit të poezisë time "më vjen një dëshirë".

Shembull:

IV
më vjen kajherë një dëshirë
e marrë
me t'u futë në krye
e me t'i mendu mendimet
si i mendon ti
me të hy në zemër
e me ta pulsu gjakun
si e pulson ti
me t'u përveshë në gishta
e me e prekë botën
si e prek ti
më vjen kajherë një dëshirë
një poezi
më vjen me u mbytë në të
krejt
e mos me dalë ma

Tashti mua do të më pëlqente të shkruaj në standard, largësia m'i ka shtuar ndjenjat kombëtare. Studimet gjuhësore ma kanë shtuar vetëdijën e rëndësisë së gjuhës standard. Dhe nuk kam ndonjë urrejtje politike, gjuhësore, fetare, krahinore, gjinore, etj, që më pengon të dua të shkruaj në standard. Para se të jem shkodrane, jam shqiptare. Dhe jam poete dhe dua të më lexojnë të gjithë. Mund të zgjedh dy variante në standard, ose do të përdor paskajoren e standardit, ose formën lidhore të foljes.

Shembull:

IV
më vjen nganjëherë një dëshirë
e marrë
për të t'u futur në kokë
(të të futem në kokë)
e për të t'i menduar mendimet
(të t'i mendoj mendimet)
si i mendon ti
për të të hyrë në zemër
(të të hyj në zemër)
e për të ta pulsuar gjakun
(të ta pulsoj gjakun)
si e pulson ti
për të t'u shpërvjelur në gishta
(të të shpërvilem në gishta)
e për ta prekur botën
(ta prek botën)
si e prek ti
më vjen nganjëherë një dëshirë
një poezi
më vjen për t'u mbytur në të
(të mbytem në të)
krejt
për të mos dalë më (e të mos dal më)

Është e vështirë për mua ta përjetoj poezinë si e përjeton një toskë, por për mua sidomos paskajorja me "per te", por edhe lidhorja i japin kuptime shtesë poezisë, i japin një qëllim, një synim realizimi, një forcë më të madhe dëshirore nga ajo dëshirë që dua të shpreh unë me infinitivin tim. Ndoshta për një toskë është e njëjta gjë pse nuk e ka konstruktin, por për mua "Kam dëshirë me prekë botën" nuk është e njëjta gjë si "Kam dëshirë ta prek botën", pse forma e lidhores ka një dëshirë dhe synim në vetvete, që infinitivi nuk e ka. Infinitivi është neutral, asnjanës. Kur përdor infinitivin jam unë poetja që vendos, lidhorja më lidh. Për të mos folur për paskajoren me "për të", që është fuqi më vete shprehëse. Unë dua të vendos përmbi gjuhën, pse ky është misioni im. Unë jam poete, prapa më vjen gjuha:)

ARBEN PRENDI

"Premtimi i përmbushun" me autor Gjon Sinishtën, pasqyrë e kalvarit të popullit shqiptar nën diktaturën komuniste

Libri "Premtimi i përmbushun" me autor Gjon Sinishtën, (i përkthyem në gjuhën shqipe, Fiorentia, Shkodër 2016, nën kujdesin e shoqatës Drejtsi e Paqe) hapë edhe një herë pamjen mbi skenën e tmerrshme, që sot duket e largme, por libri na e sjell afër, skenën e krimeve e mizorive që komunistët shqiptarë banen mbi popullin e tyne, mbi bashkëatdhetarët e tyne, mbas Luftës së Dytë Botnore. Me sa dëshmon ky libër, lufta e mnershme në mesin e popullit shqiptar filloi në fakt kur mbaroi Lufta, që solli në pushtet regjimin ma gjakatar që kishin njoftë historia jonë. Disa popuj të Evropës e përfunduen luftën me Luftën e Dytë, ne hapëm një luftë edhe ma të neveritshme: luftën e klasave.

Kur sheh listën e të vramëve, të burgosunve, të internuemve të klerit katolik, mundesh me vra mendjen se cila Luftë asht ba këto vite në Shqipni. Lufta ma e çuditshme ku regjimi ishte i armatosun deri në dhambë dhe frikësohej prej popullit të vet dhe sidomos prej klerit katolik. Sa shume frikësohej prej njerëzve që s'kishin tjetër armë veç idealit dhe besimit, tregojnë sot listat e gjata plot dhimbje e trishtim. Lista me të cilat, për ironi të fatit i takoi, regjimit të sotëm, me u krenue para Papës Françesku, sa të gjata ishin, dhe sa kishin *punue* parardhësit e tyne, tue i varë edhe një herë për së dyti në Bulevardin kryesor në kryeqytet, në sytë e popullit të shastisun.

Ky libër asht vetëm një pjesë e kalvarit të popullit shqiptar nën diktaturën komuniste shqiptare. Nuk ka shpjegim kjo masakër që kulmoi me eleminimin e plejadës së figurave ma të randësishme të kombit, klerikë, intelektualë, njerëz të ndershëm që besonin te Zoti dhe Atdheu i tyne. Po si mund të torturoheshin e të vriteshin e nëpër burgje këta vigaj të besimit, mendimit e të kulturës shqiptare nga monstra që nuk e meritonin emrin njeri, por që ishin bashkëatdhetarë të tyne. Këtë e shpjegon profesor Zef Valentini S.J. kur shprehet se: *Patriotizmi i katolikëve shqiptarë deri në momentin kur komunistët morën pushtetin më 1944, ishte i pamohueshëm. Megjithatë, katolikët shqiptarë në përgjithësi dhe veçanërisht kleri, jo gjithmonë janë parë me sy të mirë në kontekstin e shoqërisë shqiptare.*

Kjo pjesërisht për shkak të frymës së tyre pro perendimore dhe anëve filozofike, teologjike e juridike të mentalitetit të tyre, që e bënte këtë grup sa konservator por aq edhe përparimtar në kërkim të së resë. Ngaqë kleri katolik shqiptar ka qenë një ndër grupimet më të përparuara për sa i takon arsimimit dhe kulturës, pa dashur ata kanë ngjallur xhelozinë e disa të tjerëve. Regjimi komunist, për shembull shihte te kleri katolik një kundërshtar të vendosur, filozofia e të cilit nuk përputhej askund me konceptet e tyre nga bota Lindore që u reflektua në aleancën me sllavët e më vonë me kinezët"[1]

Teksti ka veçori të tekstit eseistik, ku të dhanat faktike dhe historike harmonizohen me elemente subjektive dhe emocionale. Sigurisht qëllimi i autorit nuk asht krijimi letrar por fjalia e fraza e shkrimit rrjedhin përmes një narrative të zhdërvjelltë ku janë në ekuilibër informacioni, dëshmia, interpretimi dhe përjetimi emocional. Dëshmitë e përshkrueme në këtë libër-dëshmi, ua kalojnë edhe veprave letrare sidomos mbi përshkrimet e intrigave të sajuara me qëllim që kleri katolik të demaskohej si armik, bashkëpunëtor i fashizmit, nazizmit, apo i agjenturave të huaja; për torturat çnjerëzore, poshtërimet, dhunimet jo vetëm të gjallëve por edhe të vdekunve. Siç tregojnë këto dëshmi Shqipnia socialiste e viteve 1945-1967 por edhe ajo e mavonshmja, ia kalon Ferrit të Dantes: me kampet e përqendrimit ku njerëzit vdesin nga uria, nga torturat nga puna e stërmundimshme, me figurat e hetuesve vampira që i kafshojnë me dhambë viktimat e tyne në hetuesi, ju thejnë gjymtyrët, u nxjerrin sytë, i lidhin me tela me gjemba dhe i lanë me kryeteposhtë natë e ditë.

Qe si përshkruhen në ditarin e Jak Gardinit disa prej torturave që u bahen të burgosunve klerikë: "Shumicën i godisnin me shkopinj në tabanin e këmbës, pjesa e tultë e kofshës dhe vithet u çaheshin me thikë, u fusnin kripë në plagë, e i qepnin përsëri, disave u fusnin këmbët në ujë të valuar, derisa mishi i shkëputej, e pastaj i fërkonin me kripë, penjëzat ia shponin me tel të skuqur. Disa i varnin për krahësh e i linin ashtu për tri ditë pa ushqim; i fusnin në ujë të akullt deri sa pothuajse ngrinin, u vinin telat e korrentit në veshë, hundë, gojë, gjenitale etj; u fusnin kunja të ndezur pishe nën thonj; i bënin me zor të gëlltisnin një kilogram kripë e i linin pa ujë për 24 orë, u vinin vezë të ziera nënsqetull; u shkulnin dhëmbët pa qetësues, i lidhnin pas kamionëve e i hiqnin zvarrë; i linin në izolim pa bukë e ujë deri sa fikeshin; i detyronin të pinin urinën ose të hanin jashtëqitjen e tyre,

1 Po aty, f. 212.

i zhysnin deri në grykë në pirgje jashtëqitjeje, i shtrinin në një sipërfaqe me gozhda, e i mbulonin me pesha të rënda, i fusnin në kafaze që rrotulloheshin me shpejtësi rreth një boshti; një murgeshe i futën një mace e një mi nën rrobë; disa motra të tjera i nxorën në rrugë të zhveshura”[2].

Këto tortura ua kalojnë edhe atyne të kampeve të përqendrimit të Mathauzenit të nazizmit. Asht e vështirë me analizue tipin psikologjik të këtyne sadistave që gjejnë kënaqësi te shfrimi i torturës kanibaleske, por motivimi i tyne ishte “pushteti i proletariatit” që mbasi i përdorte veglat e veta deri në çnjerëzim i kthente edhe ata në viktima. Mekanizmi brutal i diktaturës që hante edhe bijtë vetë tregon sekretin e mbijetesës së saj: mashtrimi e joshja e shoqnisë me përralla utopike ideologjike, përdorja e saj në rolin e xhelatit mandej kthimin e xhelatit në viktimë. Siç tregohet në këtë libër për rastin e një oficeri të sigurimit të shtetit, i cili mbasi kishte marrë pjesë në montimin e të dhënave për gjyqin kundër klerikëve në ngjarjen e futjes së armëve në kishë në vitin 1947, një vit ma vonë i vjen rradha për tu dënue si bashkëpuntor me klerin katolik, por që i penduem për ato që kishte ba deklaron hapun në gjyq: Ju jeni njerëzit më të fëlliqur mbi tokë. Unë kam marrë urdhra nga ju për të torturuar njerëz e për të trilluar në dëm të Kishës Katolike. Unë, instrumenti juaj i verbër, po aq burracak e kriminel sa ju, kam bërë çdo gjë që kisha në dorë për të zbatuar urdhrat tuaj. Ju më urdhëruat që të shkoja natën e të fshihja armë nëpër kisha e manastire në një mënyre të tillë që ju të kishit pretekst për të eleminuar klerikët dhe për të shkatërruar Kishën Katolike. Pranoj faqe popullit shqiptar që i kam përmbushur këto porosi me zell të madh e në fshehtësi të plotë. Meqë ju më shpërfillni, unë kërkoj që këto fakte t’i bëhen të njohura popullit shqiptar. Më vjen keq jo se po mbulohem me turp, por sepse kam qenë një instrument i lig në duart tuaja dhe se kam tradhtuar gjakun e kaq e kaq anëtarëve të pafajshëm të klerit katolik. Gjyqi i toger Kçirës ishte publik dhe transmetohej në Radio Shkodra. Deklarata e sipërpërmendur nuk u dëgjua deri në fund, sepse transmetimi i ndërpre”[3]. Në gjyq, dënimi nga burg iu kthye dënim me vdekje dhe trupi i tij u flak në të njëjtin vend ku ai kishte groposur trupat e shumë priftërinjve të pafajshëm.

Libri na tregon se çfarë mekanizmash të egër përdor diktatura për me mposhtë njerëzimin. Shumica e njerëzve kanë qenë aktorë ose spektatorë të këtyne mizorive por tue qenë të kontrolluem ose ishin të pafuqishëm me reague kolektivisht ose një pjesë e shoqnisë ishte joshë nga ideologjia

2 Sinishta, Gjon. Premtimi i përmbushun, Fiorentia, Shkodër 2016, f. 178.
3 Sinishta, Gjon. Premtimi i përmbushun, Fiorentia, Shkodër 2016, f. 74.

e ndritun e një socializmi utopik, pa Zot, ku njeriu ta ndjente veten zot i fateve të tij, lojë fjalësh në të cilën shteti komunist shplante trush shoqninë e kohës. Ose një pjesë e njerëzve të etun për pushtet ishin verbue kaq shumë nga ideologjia aq sa nuk dojshin me i pa tmerret. Asht i nevojshëm në çdo kohë një reflektim social mbi të kaluemen e tmerrshme, që ajo të mos përsëritet ma. Dami që i asht ba kombit shqiptar prej vetë shqiptarëve asht i pallogaritshëm. Duhen dhjetëra e qindra vite të tjera me e riparue këtë dam në qoftë se nuk biem në ndonjë diktaturë të re ose nën ndonjë pushtim të ri.

Asht i dukshëm sulmi që dëshmohet në këtë libër; i regjimit komunist ndaj shkrimtarëve që ishin edhe klerikë katolikë si Ndoc Nikaj, Vinçens Prenushi, Lazër Shantoja, Anton Harapi, Ndre Zadeja, Benardin Palaj, Gjon Shllaku, Donat Kurti e sa e sa të tjerë. U ndalue me porosi vepra e Fishtës, të cilit iu zhvarrosen edhe eshtnat dhe vepra letrare iu hoq nga qarkullimi. Vepra letrare e tyre u varros bashkë me autorët gja e cila do të sillte një goditje ndaj vetë letërsisë shqiptare e cila sipas kritikës së realizmit socialist duhet të fillonte me këngët partizane.

Tue e shfletue këtë libër më shqetëson sot një pyetje për gjendjen e sotme të shoqnisë sonë: A thue kishin me ndodhë edhe një herë situata të ngjashme me këto që kaluen nën socializëm? Dikush mund të thotë: jo kjo s'ndodhë ma! Dikush tjetër: Po, edhe mundet! Fatkeqësisht dëshmia e këtyne dyshimeve gjendet në realitetin e ri të 25 vjetëve të fundit ku rrymat politike e kanë lanë vendin në udhëkryq dhe shoqnia asht e pafuqishme, e paaftë me u ngritë në nivelin që e kërkon zhvillimi dhe integrimi në rrjedhën e qytetërimit evropian perëndimor. Në kushtet kur shumë prej veglave të shtetit komunist kanë vazhdue me krye funksione të randësishme edhe në shtetin demokratik a thue se asgja s'kishte ndodhë, tue u fshehë mbas justifikimit: kena ba detyrën, e detyra e tyne ishte denimi, torturimi, vrasja, poshtënimi i klerit katolik e mysliman, intelektualëve shqiptarë me prirje e shkollim perëndimor. Një pjesë e tyne, nëse janë në pension marrin edhe pensione të veçanta dhe dekorata nderimi për punën e bame me pashpirtësi e shpesh edhe kundra ligjeve të kohës. Biles disa janë edhe ma çnjerëzorë kur vazhdojnë me ngulë kambë se kleri katolik ishte kolaboracionist me fashizmin apo nazizmin apo me agjenturat e huaja, pa pasë asnjë provë që do të përbante vepër penale, në kohën e diktaturës. Nuk bahet fjalë që shteti apo institucionet e mëvonshme demokratike me kërkue ndjesë ndaj klerit dhe komunitetit katolik apo me gjetë forma të pranueshme damshpërblimi për to.

Libri “Premtimi i përmbushun” me autor Gjon Sinishtën dëshmon edhe një herë se gjaku i martirëve të popullit shqiptar ma së paku duhet të na shërbejë që të punojmë që të mos përsëritet e kaluemja e përgjakshme dhe të punojmë për përparimin e të shoqnisë tue ndjekë modelin që ata e krijuen me jetën e veprën e tyne. Bashkë me libra të tjerë si *Rrno për me tregue* të At Zef Pllumit, *Martirët* të Pjetër Arbnorit, Sami Repishti, “*Nën hijen e Rozafës-narrativë e jetueme*” e të tjerë meritojnë me u përfshi në listën e librave jashtëshkollor për lexim të detyrueshëm, të paktën disa pjesë të tyne, që e kaluemja të mos harrohet, që ajo të mos përsëritet në forma të tjera në kohën tonë, që brezat e rinj ta njohin kalvarin e popullit tonë nën diktaturën komuniste.